

1 E martë, 25 shkurt 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.02

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi disa
6 çështje për të shqyrtuar përpara se të fillojmë me
7 dëshmitarin.

8 Së pari -- ju kërkoj ndjesë së pari paraqisni lëndën,
9 Sekretar.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëmë
15 Konferencën për Ecurinë e Çështjes përpara një jave dhe kam
16 përshtypjen që z. Misetic bëri pyetjen dhe kërkesën dhe na tha
17 ne, na kërkoi që të tregonim synimin tonë në qoftë se do
18 kërkojmë dëshmi të tjera shtesë ose në qoftë se do kërkojmë
19 dëshmitarë shtesë. Mund t'ju themi aktualisht që nuk
20 dëshirojmë ose që nuk synojmë që të thërrasim ndonjë dëshmitar
21 apo të kërkojmë dëshmi të tjera shtesë. Gjithmonë e mundur që
22 në qoftë se ndodhë diçka në procesverbal ne mund ta
23 justifikojmë thirrjen e ndonjë dëshmitari ose provave shtesë,
24 megjithatë për momentin ne nuk planifikojmë të bëjmë diçka të
25 tillë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
2 Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të akuzuarit
4 janë të gjithë në sallën e gjyqit për procesverbal.

5 Kemi dy urdhra me gojë. Së pari, Trupi Gjykses do të
6 nxjerrë një urdhër për kërkesën urgjente të përbashkët të
7 Mbrojtjeve për të paralajmëruar ZPS-në dhe kërkesa të lidhura
8 me to.

9 Më 17 shkurt 2025, Mbrojtja i kërkoi Trupit Gjykses që të
10 paralajmërojë ZPS-në që të respektojë detyrimet e saj sipas
11 paragrafit 98 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit dhe që kanë
12 nxjerrë apo kanë nënvijëzuar nënkuptime negative lidhur me
13 besueshmërinë e Dëshmitarit 04491 nga një parregullsi
14 procedurale që pretendohet që të jetë shfaqur dhe manifestuar
15 dhe gjatë seancës përgatitore të dëshmitarit. Në veçanti,
16 Mbrojtja argumenton se prania e dëshmitarit dhe pasja e një
17 këshilltari juridik, si dhe kërkesa e dëshmitarit për të dhënë
18 dëshmi lidhur me saktësinë e dëshmimeve çon në orientim ose
19 sugjestionim të dëshmitarit dhe një gjë e tillë nuk duhet të
20 pranohet pasi ndikon mbi themelin dhe mbi përmbajtjen e
21 dëshmisë së dëshmitarit.

22 Më 18 shkurt 2025, sikurse është udhëzuar prej Trupit
23 Gjykses, ZPS-ja iu përgjigj me gojë Mbrojtjes dhe tha që
24 Mbrojtja nuk ka përcaktuar ndonjë shkelje ose paragjykim që
25 ngrihet nga sjellja e ZPS-së nga seanca përgatitore e

1 dëshmitarit dhe nuk ka ofruar asnjë bazë juridike për kërkesën
2 e saj për Trupin Gjykses për të konstatuar apo për nxjerrë
3 nënkuptime negative sa i takon vlerësimit të besueshmërisë së
4 dëshmitarit. ZPS-ja më tej argumenton që Mbrojtja do të ketë
5 mundësi që të bëjë pyetje për këtë dëshmitar sa i takon
6 informacionit konkret për të cilin bëhet fjalë.

7 Të njëjtën ditë, Mbrojtja u kundërpërgjigj me gojë lidhur
8 me informacionin e nxjerrë nga këshilltari ligjor dhe që i
9 është prezantuar Dëshmitarit 04491 dhe ka ushtruar ndikim mbi
10 të sa i takon dhënies së dëshmisë së tij dhe që këshilltari
11 është bërë dëshmitar në proces gjyqësor.

12 Të njëjtën ditë, Mbrojtja e Viktimave ka parashtruar me
13 gojë parashtrimet e tij që mbështet parashtrimet e ZPS-së.

14 Pasi ka shqyrtuar parashtrimet e palëve dhe të
15 pjesëmarrësve, Trupi Gjykses është i mendimit që kërkesa nuk
16 ka bazueshmëri, pra, nuk ka themelësi. Trupi Gjykses vëren
17 gjithashtu që gjatë seancës përgatitore këshilltari juridik
18 thjesht sa ka përshkruar proceset e brendshme që kanë
19 përfshirë Dëshmitarin 04491 dhe më pas ka nënvijëzuar që
20 dëshmitari i ka thënë atij, i ka treguar atij lidhur me
21 proceset gjyqësore të ndodhura në nivel lokal. Gjatë leximit,
22 Dëshmitari 04491 ka konfirmuar që ai është këshilluar dhe kjo
23 është pasqyruar saktësisht në shënimin përgatitor. Nuk ka
24 asgjë që sugjeron që ZPS-ja është përpjekur që të ndikojë mbi
25 dëshminë e këtij dëshmitari. Trupi Gjykses konstaton që ZPS-ja

1 ka vepruar në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykses për
2 Zhvillimin e Procesit Gjyqësor, kështu që nuk ka asnjë arsye
3 të vlefshme për të paralajmëruar ZPS-në.

4 Trupi Gjykses më tej konstaton që nuk ka bazë për Trupin
5 Gjykses që të nxjerrë ndonjë mendim negativ sa i takon
6 besueshmërisë së dëshmitarit mbështetur në materialet e
7 regjistruara në shënimin përgatitor. Çdo përcaktim sa i takon
8 besueshmërisë së Dëshmitarit 04491, ashtu si dhe në rastin e
9 dëshmitarëve të tjerë, do të bëhet prej Trupit Gjykses
10 mbështetur në faktet dhe rrethanat që janë të vlefshme dhe që
11 janë të hedhura në procesverbal të këtij procesi gjyqësor dhe
12 janë relevante për vlerësimin e Trupit Gjykses lidhur me
13 besueshmërinë e dëshmitarit.

14 Për këto arsye, Trupi Gjykses kundërshton kërkesën e
15 Mbrojtjes dhe urdhëron Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin ose
16 të parashtrojë versionin e paredaktuar publik të parashtrimit
17 F02938 deri të premtën, 7 mars 2025.

18 Ky përfundon urdhrin e parë me gojë.

19 Më 16 prill 2024, Trupi Gjykses ka miratuar kërkesën e
20 ZPS-së për pranim të dëshmisë së Dëshmitarit 02677 sipas
21 rregullës 154.

22 Më 21 shkurt 2025, ZPS-ja ka informuar Trupin Gjykses dhe
23 palët të arrijnë një marrëveshje për të pranuar dëshminë e
24 këtij dëshmitari sipas rregullës 153 dhe rregullës 154.

25 Trupi Gjykses ka informuar gjithashtu -- është informuar

1 gjithashtu dhe për marrëveshjen e palëve lidhur me Shtojcën 3
2 të kërkesës së ZPS-së që ka pranuar dëshminë e Dëshmitarit
3 02677 sipas rregullës 154. Dje, Trupi Gjykses ka urdhëruar
4 nxjerrjen e kërkesës së 02677 nga ZPS-ja sipas rregullës 153.

5 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në që të
6 dorëzojë kërkesën sipas rregullës 153 në lidhje me Dëshmitarin
7 02677 deri të martën, 4 mars 2025. Trupi Gjykses e kupton që
8 Mbrojtja nuk ka kundërshtim sa i takon kësaj kërkesë.
9 Pavarësisht kësaj, në qoftë se palët dëshirojnë që t'i
10 përgjigjen ose të kundërpërgjigjen lidhur me këtë kërkesë
11 duhet ta bëjnë këtë duke respektuar afatet standarde sipas
12 rregullës 76.

13 Ky përfundon urdhrin e dytë me gojë të Trupit Gjykses.

14 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04745.

15 Trupi Gjykses kujton që gjatë seancës së djeshme
16 dëshmitari kërkoi që t'i caktohet një avokat kujdestar atij.
17 Trupi Gjykses vëren që Zyra Administrative ka vijuar me
18 caktimin e Avokatit Kujdestar për 04745.

19 Tani do vazhdojmë me dëshmitarin i cili do të hyjë në
20 sallë së bashku me avokatin përkatës.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 DËSHMITARI: ISMET TARA [Vijon]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
24 Avokat Kujdestar. Ju lutem prezantohuni për procesverbal.

25 Z. VAN STRAALLEN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

1 Gjykatës. Unë jam z. Van Straalen, jam avokati i caktuar për
2 z. Ismet Tara.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besojmë që
4 keni pasur kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar me z. Tara.

5 Z. VAN STRAALLEN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Kemi
6 pasur kohë. Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
8 z. Tara. Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që
9 t'i përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk
10 e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkonit avokatit
11 përkatës që ta përsërisë ose ta sqarojë më tej pyetjen. Po
12 ashtu përpiquni që të na thoni se cila është baza e njohurive
13 dhe fakteve dhe rrethanave lidhur me pyetjet që do t'ju bëhen.

14 Ende jeni nën detyrimin që të tregoni të vërtetën ashtu
15 siç e keni thënë dhe në betimin solemn.

16 Po ashtu mos harroni që duhet të flisni pranë mikrofonit
17 dhe duhet të bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara sesa
18 t'i përgjigjeni pyetjeve. Po ashtu flisni ngadalë për t'ju
19 kapur përkthyesit.

20 Ndërkohë që jepni dëshmi përpara Trupit Gjykues nuk
21 lejohet që të diskutoni me askënd jashtë sallës lidhur me
22 përmbajtjen e dëshmisë tuaj. Në qoftë se ka persona jashtë
23 sallës së gjyqit që ju pyesin lidhur me dëshminë përpara
24 Trupit Gjykues, na e bëni me dije këtë gjë.

25 Nëse ju kërkoj që të mos flisni më, duhet të ndërprisni

1 së foluri dhe në qoftë se më shikoni që po e ngre dorën duhet
2 që të ndërprisni së foluri. Sepse kjo do të thotë që duhet
3 t'ju jap udhëzime.

4 Nëse e ndjeni të nevojshme të bëni ndonjë pushim na e
5 bëni me dije këtë gjë dhe ne do të vazhdojmë me organizimet
6 përkatëse.

7 Do të vazhdojmë me pyetjet e Ekipeve të Mbrojtjes,
8 ndërkohë që Prokuroria në përfundim të pyetjeve tuaja dje ka
9 kërkuar dokumentet përkatëse për regjistrim në prova
10 gjyqësore.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
12 Në emër të katër Ekipeve të Mbrojtjes, dëshirojmë që të bëjmë
13 një parashtrim që kundërshtojmë dokumentet që janë kërkuar që
14 të pranohen në prova gjyqësore nga Prokuroria, së pari. Pra,
15 kërkojmë që të bëjmë kundërshtimin tonë së pari dhe pastaj të
16 vazhdojmë me pyetjet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
18 atëherë. I takon që do ta nxjerrim dëshmitarin nga salla
19 ndërkohë që ju bëni parashtrimet tuaja.

20 Dëshmitar, ju kërkojmë ndjesë se nuk e dinim që kishte
21 kundërshtim Avokati. Kështu që do ju kërkoj që të dilni nga
22 salla derisa të përfundojë Mbrojtja dhe pastaj do ju kërkojmë
23 përsëri që të vini në sallë.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 Është një parashtrim i mbështetur në atë çfarë ka thënë
2 dëshmitari dje në fund të dëshmisë së vet, që ai nuk ishte i
3 përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë proces
4 gjyqësor dhe tha që nuk do që t'i përgjigjet pyetjeve qoftë të
5 Prokurorisë ose të ekipeve të Mbrojtjes. Nuk kemi ndonjë
6 informacion që ky qëndrim i dëshmitarit ka ndryshuar. Dhe kjo
7 është baza e parashtrimeve tona, që dëshmitari nuk është i
8 përgatitur për t'ju përgjigjur pyetjeve të tjera.

9 Dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të zgjidhim
10 çështjen e pranimit të dokumenteve të Prokurorisë. Dhe në emër
11 të katër Ekipeve të Mbrojtjes, ne ju kërkojmë që vendimi juaj
12 për pranimin e dokumenteve të kërkuara nga Prokuroria të bëhet
13 mbi këtë bazë sepse edhe në qoftë se ne mund të pyesim
14 dëshmitarin, do na duhet që të pyesim shumë. Për shembull, na
15 duhet të pyesim lidhur me një dokument të UNMIK-ut që nuk
16 është pranuar ose, për shembull, në qoftë se do të duhet t'i
17 referohemi Shënimit Përgatitor numër 2 që është më 26 faqe,
18 përsëri, pra, do të kemi shumë çështje për të sqaruar.

19 Po ashtu, të nderuar Gjykatës, kemi një ndryshim të
20 menjëhershëm, në kuptimin që dëshmitarit i është caktuar një
21 avokat kujdestar dhe në qoftë se dëshmitari do i përgjigjet
22 pyetjeve, i takon që i gjithë procesi do të duhet të fillojë
23 nga fillimi. Në kuptimin që do të duhej që Prokuroria të
24 vazhdojë që t'i përgjigjet pyetjeve të Prokurorisë njëherë
25 përderisa tani situata ka ndryshuar, pra, ka avokat dhe pastaj

1 të na jepet neve fjala për të bërë pyetjet tona.

2 Parashtrimet tona kanë lidhje me kërkimin e tri
3 dokumenteve që janë kërkuar për t'u pranuar në prova gjyqësore
4 të cilat duhet të rrëzohen prej jush, të nderuar Gjykatës dhe
5 duhet që vendimi të merret prej jush përpara sesa të vijojmë
6 ne me pyetjet. Parashtrimi mbështetet në tekstin e
7 rregullores, që e thotë shprehimisht, në veçanti në rregullën
8 143 dhe sikurse mund ta keni vënë re, të nderuar Gjykatës,
9 ZPS-ja nuk u përpoq fare që të kalonte specifikisht në
10 rregullore dhe thoshte se cila pjesë e dokumenteve të tyre
11 lidhet me cilin parashikim në rregullore, me cilën rregull të
12 rregullores.

13 Pra, ne parashtrojmë këtu që për aq sa kohë sa dëshmitari
14 nuk po jep dëshmi në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kuptimin nuk
15 po jep dëshmi pa praninë e avokatit mbrojtës, ne mendojmë që
16 rregullat përkatëse janë rregulla 153 deri në 155. Ndërkohë që
17 Prokuroria e di që nuk ekziston baza për ta bërë këtë gjë dhe
18 nuk na ka dhënë fare hollësi lidhur me bazën e kërkesave të
19 tyre.

20 Sikurse mund ta dini, të nderuar Gjykatës, këto rregulla
21 trajtohen në nën seksionin ose nën pjesën 2 me titullin
22 "Dëshmia, deklaratat dhe prova të tjera", në nënpikën 2 të
23 Rregullores. Ajo çfarë është e qartë, por gjithsesi dua ta
24 theksoj përsëri, është që në rregullën 143 titulli i këtij
25 rregulli është "Marrja në pyetje e dëshmitarit". Dhe nuk ka

1 asgjë të bëjë me pranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit. Në
2 fakt kjo çështje për të cilën ne jemi të interesuar
3 parashikohen në rregullën 153 deri në 155, pra, 153, 154 dhe
4 155 që ka titullin "Pranimi i transkripteve të dëshmisë së
5 dëshmitarit". Kështu që ka një dallim të qartë në rregullore
6 dhe parashtrimi ynë është që hartuesit e rregullores nuk kanë
7 synuar asnjëherë që rregulla 143 të aplikohet në këtë mënyrë
8 që pretendon Prokuroria, sepse kjo është një mënyrë shumë e
9 pazakontë që të përdoret kjo bazë ligjore për pranimin e
10 dokumenteve të Prokurorisë.

11 Rregulla 143 ka një qëllim shumë të ngushtë dhe që është
12 jo në përputhje me deklaratën, siç parashikohet në paragrafin
13 2(c) e deklaratës dhe ne parashtrojmë që kjo nuk është baza e
14 duhur ligjore.

15 Pra, çështja nuk është zgjidhur plotësisht sepse
16 dëshmitari nuk është pyetur asnjëherë sa i takon dokumentit.
17 Nuk është sqaruar natyra e dokumentit. Po ashtu nuk janë dhënë
18 sqarimet e nevojshme në shënimin përgatitor.

19 Po ashtu, ne mendojmë që duhet të ishin marrë masa të
20 tjera për ta detyruar dëshmitarin për t'ju përgjigjur. Është
21 sugjestionuese, spekulative të thuhet që ai nuk e ka ndryshuar
22 mendimin e vet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A po thoni që
24 ne kemi detyrim për të vazhduar më tej?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Ajo çka po themi neve --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sepse po them
2 që në statut, pra, formulimi është "mund" nuk është detyrues,
3 nuk thuhet "duhet" por "mund".

4 Z. DIXON: [Përkthim] Parashtrim ynë është që ne nuk e
5 dimë se çfarë do bënte dëshmitari. Domethënë, në qoftë se ai
6 do urdhërohej dhe në qoftë se do thuhej, domethënë, do
7 detyrohej dhe do i thuhej që do gjobitej dhe do dërgohej në
8 burg dhe nuk e dimë në qoftë se ai në këtë rast do përgjigjej
9 apo jo. Ne parashtrojmë dhe themi që kjo gjë, ky hap ose kjo
10 masë nuk është marrë.

11 Kështu që duhet dhe ne mendojmë që nuk duhet të shohim
12 një mënyrë të pazakontë për të zbatuar rregullën, rregulloret
13 thjesht për të gjetur një zgjidhje që i volitet njëra pale. Ne
14 parashtrojmë se duhet të jemi shumë herë më tepër sistematik
15 dhe shumë herë më tepër rigoroz sa i takon zbatimit të
16 rregullave të rregullores në mënyrë sistematike në varësi të
17 situatës.

18 Në këtë aspekt, sa i takon transkriptit, së pari, nuk ka
19 papajtueshmëri. ZPS-ja nuk ka identifikuar ndonjë
20 papajtueshmëri. Ata duhet që të mbështeten tek (b) që është
21 dëshmia e dëshmitarit. Dhe duhet të që të bëhet një përpjekje
22 e vërtetë e qenësishme për të për të dhënë dëshmi.

23 Ne nuk jemi në një situatë të tillë ku kemi të bëjmë me
24 një papërputhshmëri. Dhe, në çdo rast, rregulla 143(2)(b) nuk
25 ju lejon ju, të nderuar Gjykatës, që të prezantoni

1 transkripte. Sipas këtij rregulli, ju këtë gjë mund ta bëni
2 vetëm përmes rregullës 153 deri në 155, një kërkesë e cila nuk
3 ju është bërë nga Prokuroria.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky argument
5 është paraqitur në Gjykatën e Apelit në të shkuarën dhe
6 Gjykata e Apelit ka vendosur për rrëzimin e tij.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Po e kuptojmë këtë gjë, të nderuar
8 Gjykatës.

9 Ne mbështetemi në veçanti tek pika që nuk jemi në situatë
10 që dëshmitari nuk do të japë dëshmi se dëshmitari ka thënë që
11 do të japë dëshmi.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga e dini ju
13 këtë gjë?

14 Z. DIXON: [Përkthim] E ka thënë vetë dëshmitari. Ai thotë
15 që "Në qoftë se zgjidhet kjo çështja e dokumentit, jam i
16 gatshëm që të jap dëshmi".

17 Prokuroria e ka ngatërruar më tepër situatën.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Situata nuk
19 është krijuar, nuk është stisur nga Prokuroria.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk e thashë asnjëherë këtë gjë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sapo e thatë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Ajo çfarë po them unë është që kjo
23 është shkaktuar nga pyetjet që janë bërë dhe nuk është
24 zgjidhur nga Prokuroria. Prokuroria ka detyrën fundore për të
25 zgjidhur këtë situatë dhe ne nuk mund të jemi në një situatë

1 të tillë ku dëshmitari pasi ka thënë shpesh herë që "Në qoftë
2 se më tregoni këtë dokument, unë mund të vazhdojë me
3 dëshminë". Ne nuk e dimë fare për ç'a dokumenti bëhet fjalë?
4 Pse nuk është pyetur dëshmitari për çfarë dokumenti bëhet
5 fjalë?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 përfundoni.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është shumë e
9 rëndësishme që të mbahet parasysh se çfarë do të thotë të mos
10 përpiqesh në mënyrë të njëmend që të japësh dëshmi. Pra, që
11 dëshmitari të mos i krijohet mundësia për të dhënë dëshmi.

12 Këtë e themi edhe sa i takon deklaratës së UNMIK-ut, këtu
13 duket sikur pika (2)(c) zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë
14 sepse ka një deklaratë të mëparshme jopërputhëse. Megjithatë,
15 në rregullën 144 nuk parashikohet që nuk duhet të bëhen pyetje
16 sa i takon kësaj deklarate.

17 Vendimi i mëparshëm që keni marrë ju, të nderuar anëtarë
18 të Trupit Gjykses, në rastin e Dëshmitarit 3780, që paraqitet
19 në vendimin F02580 tuajin, të nderuar Gjykatës, në atë rast ka
20 pasur pyetje të zgjeruara të shumta prej Prokurorisë sa i
21 takon dokumenteve në fjalë. Dhe në të njëjtën mënyrë janë bërë
22 pyetje të shumta edhe prej Ekipeve të Mbrojtjes lidhur me këtë
23 temë, me këtë aspekt. Kështu që mbi këtë bazë ju, të nderuar
24 anëtarë të Trupit Gjykses, keni vendosur që të pranohet
25 deklarata.

1 Situata në rastin e këtij dëshmitari është tërësisht e
2 ndryshme nga situata e dëshmitarit që kemi sot. Të nderuar
3 Gjykatës, shumë sinqerisht, nuk është bërë ndonjë shqyrtim i
4 dokumentit në shumë hollësi. Thjesht është i vendosur në
5 kontekstin e mundimit të gjetjes të një zgjidhjeje në qoftë se
6 ky është dokumenti për të cilin po fliste dëshmitari apo jo.
7 Po ndërkohë nuk është bërë ndonjë përpjekje shumë e madhe nga
8 Prokuroria për të gjetur këtë dokument.

9 Kështu që ju ftojme, të nderuar Gjykatës, që ta shihni
10 këtë vendim nga afër. Dhe mendojmë që do ishte shumë
11 paragjyquese për neve në qoftë se ne nuk na lejohet që të
12 bëjmë pyetje lidhur me këtë dokument. Dhe nga ana tjetër dhe
13 në aspektet e garancive dhe garancitë janë shumë të
14 rëndësishme ndërkohë që në rregullën 143 nuk parashikohet
15 asnjë garanci.

16 Së fundi, më lejoni të them dy gjëra lidhur me shënimet
17 përgatitore që janë pika shumë të rëndësishme, aspekte shumë
18 të rëndësishme. Ky është një kombinim i shënimit përgatitor në
19 të dy korigjimet e transkriptit dhe dëshmi të re. Të nderuar
20 Gjykatës, ju asnjëherë nuk keni përgatitur shënim -- nuk keni
21 pranuar Shënimin Përgatitor 2 si dëshmi të re. Ju në mënyrë të
22 vazhdueshme, të nderuar Gjykatës, keni thënë që dëshmia duhet
23 që të udhëzohet prej dëshmisë *live* të dëshmitarit sepse nuk ka
24 dëshmi të re. Është një përmbledhje e Prokurorisë lidhur me
25 atë se çfarë ka ndodhur. Dhe në qoftë se vendosni ndryshe

1 kësaj radhe, ne mendojmë që ju nuk duhet ta bëni këtë gjë
2 sepse nuk ka asnjë bazë lidhur me këtë.

3 Së dyti, në rastin e Shënimit Përgatitor numër 1 sa i
4 takon korrigjimeve edhe Shënimit Përgatitor numër 2, në fakt,
5 dëshmitari nuk ka konfirmuar asnjëherë që ai i ka bërë këto
6 komente.

7 Pra, këtu jemi në një situatë ku ky shënim përgatitor nuk
8 duhet të pranohet. Për arsye se ka ndikim dhe mbi dokumente të
9 tjera sepse korrigjon transkriptin. Sepse nuk ka logjik që të
10 pranohet një dokument i cili korrigjon transkriptin. Se nuk
11 mund të korrigjohet transkripti?

12 Jo vetëm kaq, por së dyti, po ashtu ai jep një kontekst
13 më të plotë dokumentit të UNMIK-ut. Dhe si rezultat edhe
14 dokumenti i UNMIK-ut nuk mund të pranohet. Aq më tepër në
15 qoftë se sot nuk do kemi mundësi që t'i bëjmë pyetje këtij
16 dëshmitari, në kuptimin që dëshmitari nuk do pranojë që t'i
17 përgjigjet pyetjeve tona.

18 Kështu që dhe një herë të nderuar anëtarë të Trupit
19 Gjykses, ju kërkohet që të zbatoni rregulloren në mënyrë
20 rigorozë, së pari, shënimin përgatitor dhe, si rezultat, ne
21 mendojmë që në qoftë se ju pranoni këtë shënim përgatitor do
22 ketë një efekt domino mbi dokumente të tjera të cilat as ato
23 nuk mund të pranohen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
25 palë tjetër që dëshiron që të shtojë diçka?

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
2 që të paraqes pozicionin tonë sa i takon kundërshtimit të
3 mëparshëm të z. Misetic për çështje të ngjashme. Në veçanti,
4 lidhur me pozicionin e z. Thaçi, e Mbrojtjes së z. Thaçi dhe
5 Trupit Gjykues.

6 Ne parashtrojmë që Trupi Gjykues duhet të kundërshtojë
7 përpjekjet nga dëshmitarët për të penguar procesin gjyqësor,
8 si në rastin e këtij dëshmitari dhe duhet që të marrë të
9 gjitha masat e nevojshme të cilat në mënyrë të arsyeshme e
10 detyrojnë dëshmitarin që t'i përgjigjet pyetjeve si nga ZPS-ja
11 ashtu edhe nga Mbrojtja.

12 Ndërkohë që Trupi Gjykues pranon dëshminë e mëparshme të
13 dëshmitarëve të cilët kanë refuzuar të dëshmojnë dhe kanë
14 refuzuar të pranojë pyetjet e Mbrojtjes nga të akuzuarit pa --
15 së pari, detyrimin e Trupit Gjykues dhe ofrimin e opsioneve të
16 tjera, ne mendojmë që qëndrimi i Trupit Gjykues shkel të
17 drejtat për gjykim të drejtë të të akuzuarve.

18 E kuptoj, të nderuar Gjykatës, që kjo është pjesë e
19 diskrecionit dhe vendimit tuaj. Megjithatë, shkurtimisht, dua
20 që t'ju tërheq vëmendjen, siç e kam kuptuar, siç është edhe
21 parashtruar dhe më përpara nga z. Misetic dhe dua t'ju referoj
22 këtu paragrafin 35 të aktgjykimit që Dhomave të Apelit në
23 çështjen kundër Haradinajt në korrik të vitit 2010.

24 Dhe duam që t'ju referoj tek ajo çka keni vendosur më
25 përpara që një dëshmitari e keni paralajmëruar atë sa i takon

1 masave dhe ju keni vendosur lidhur me këtë aspekt.

2 Dhe Mbrojtja parashtron që do ishte me vlerë për neve do
3 të na vinte në ndihmë që të kuptojmë se cilat janë arsyet që
4 ju keni refuzuar ushtrimin e diskrecionit tuaj në një situatë
5 të tillë kur ka një orvatje të qartë të këtij dëshmitari për
6 të penguar procedurat e kësaj Gjykate.

7 Dhe, ne, në përfundim, parashtrojmë të nderuar Gjykatës
8 që ju nuk mund të pranoni deklarata të mëparshme të këtij
9 dëshmitari pa shteruar të gjitha hapat që duhet të merrni.

10 Një pikë tjetër që dua të ngre është që, në shënimin
11 përgatitor, në paragrafin 6, dëshmitari pyetet në qoftë se ka
12 rishikuar deklaratat e mëparshme, ai përgjigjet që "po". Ka
13 thënë që thjesht ka bërë disa sqarime dhe korrigjime në
14 deklaratën e vet. Edhe më pas thotë që:

15 "Gjithsesi ka disa fjali në deklaratë të cilat nuk i ka
16 kuptuar plotësisht dhe nuk i ka shënuar gjatë përgatitjes së
17 tij."

18 Dhe ka thënë që:

19 "Nuk i ka korrigjuar këto pjesë sepse nuk ishin të
20 rëndësishme."

21 Dhe sipas tij:

22 "Nuk kishin nevojë për sqarime përkatëse."

23 Pra, në kundërshtim me parashtrimet e Prokurorisë së bëra
24 dhe, mendoj që nuk jemi në situatën që ky dëshmitar i ka
25 pranuar në tërësinë e vet dëshmitë e mëparshme deri në masën

1 që në paragrafin 6 bëhet e qartë që ka pasur ca paqartësi
2 lidhur me këtë aspekt. Dhe ne parashtrojmë që kjo është një
3 arsye tjetër që shkon në favor të mospranimit.

4 Në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës, nuk e pranoni
5 qëndrimin tonë dhe në qoftë se vazhdoni më tej me pranimin e
6 dokumenteve, ne ramë dakord me kolegen time, me Prokuroren,
7 dje, që nuk do të pranojmë tre dokumente që është: dokumenti
8 që ka të bëjë me takimin e Sylejman Selimit, me Driton Lajçin
9 dhe gjithashtu edhe bisedën me ambasadoren. Po ashtu
10 Prokuroria na ka kërkuar, na ka dhënë neve listën e
11 dokumenteve që kërkohet që të pranohet në prova gjyqësore.

12 Po ashtu Mbrojtja e Thaçit parashtron që, gjithashtu, ne
13 duhet që të diskutojmë me kolegët sa i takon mënyrës se si do
14 të vazhdojmë dhe sa i takon dokumenteve për të cilat ne
15 mendojmë që ju nuk duhet t'i pranoni. Faleminderit.

16 Z. MAIR: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
17 Pajtohem edhe unë me kolegët e mi të nderuar. Sa u takon
18 pranimin të këtyre dokumenteve për të cilën nuk ka asnjë bazë
19 për t'i pranuar.

20 Gjithashtu kam një kundërshtim tjetër sa i takon
21 dokumentit të UNMIK-ut, kundërshtimi është lidhur me vetë
22 fjalët që ka përdorur ZPS-ja gjatë intervistës me këtë
23 dëshmitarin. Ju lutem shihni pikën 10 të intervistës -- Pjesën
24 10 - më falni - të intervistës, faqja 28, rreshtat 2 deri në
25 14. Po ua lexoj unë me zë. Këto kanë qenë fjalët që ka

1 përdorur ndihmësprokurori:

2 "Z. Tara, që ta dini, ne e dimë disa nga gjërat në
3 dokument nuk janë të sakta. Dimë që disa gjëra në këtë
4 dokument nuk janë të sakta. Ju keni qenë i interesuar për
5 dokumentet që lidhen me ju. Po është detyra jonë t'ju bëjmë
6 pyetje për këtë dokument dhe të zbulojmë cilat pjesë janë të
7 vërteta dhe cilat pjesë nuk janë të vërteta. Dua ta lexojmë
8 bashkë dokumentin dhe na tregoni çfarë është e vërtetë, çfarë
9 nuk është e vërtetë në dokument. Por sikurse ua thashë, ju
10 keni të drejtën dhe të mos flisni fare, por uroj të mos e bëni
11 këtë. Por duhet të kalojmë të gjithë tekstin e dokumentit. E
12 kuptojmë që disa gjëra në dokument janë të pavërteta. Prej
13 jush duam të zbulojmë çfarë është e vërtetë dhe çfarë është
14 jo."

15 Pra, i nderuar Gjykatës, vetë Prokuroria e di që
16 dokumenti ka gjëra të pavërteta nga mënyra si i kanë formuluar
17 pyetjet. Dhe, sidoqoftë, kanë kërkuar që të pranohet dokumenti
18 pa e bërë dallimin e asaj që është e vërtetë dhe jo në
19 dokument dhe e kanë bërë këtë përmes të vetmit dëshmitar që
20 mund të flasë për dokumentin në fjalë.

21 Unë mendoj që ZPS-ja, për mënyrën sesi e ka komentuar me
22 këtë dëshmitar, nuk mund të kërkoj pranimin e këtij dokumenti.
23 Nuk është çështje peshe. Nuk ka asnjë vlerë provuese për ne ky
24 dokument aspak në këto rrethana. Por do ju luteshim që ta
25 refuzoni pranimin e dokumenteve edhe ju lutem të merrni një

1 vendim menjëherë sa i takon pranueshmërisë së dokumenteve
2 përpara se të vazhdojmë ne me pyetjet tona.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem dhe ne me parashtrimet e
4 kolegëve. Sidoqoftë unë kam disa parashtrime të mëtutjeshme që
5 dëshiroj t'i shpreh shkurtimisht sa i takon deklaratës së
6 2001-shit të UNMIK-ut.

7 Së pari, ne nuk e pranojmë këtë si një deklaratë të një
8 dëshmitari. Nuk mendojmë se është konfirmuar kjo gjë. Ju më
9 përpara e keni përkufizuar deklaratën si një zbardhje të asaj
10 që ka thënë dëshmitari. Konkretisht këtë e keni thënë në
11 dokumentin 2580.

12 Çfarë e dallon këtë rast, është që kemi një dëshmitar që
13 po i thotë qartë Trupit Gjykses që nuk e kam thënë këtë gjë.
14 Ai e ka thënë dje këtë në transkript, kjo është e zbardhur në
15 faqen 25519, rreshti 8, 9 dhe ka thënë:

16 "Jo, e ka thënë dikush tjetër këtë gjë."

17 Të njëjtën gjë e ka thënë në intervistën e 2019,
18 konkretisht këtë mund ta shihni në Pjesën 10, disa herë ai e
19 ka shprehur këtë në faqen 23, rreshti 25, ka thënë:

20 "Nuk më ka intervistuar askush lidhur me këtë. Kjo është
21 imagjinata e Anna Vannozzi dhe të tjerëve."

22 Dhe shiheni Pjesën 10 sepse do të shihni komentet që ka
23 bërë lidhur me këtë disa herë. Ne mendojmë që dëshmitari në
24 mënyrë të vazhdueshme e ka refuzuar këtë deklaratë si
25 deklaratën e tij. Nuk keni asnjë provë për ta verifikuar, për

1 të parë nëse është verifikuar ky informacion, për shembull, a
2 është kontaktuar Anna Vannozzi apo personat e tjerë të cilët
3 kanë emrat në këtë dokument.

4 Në këto kushte, ne gjykojmë që nuk përmbushë standardin
5 për t'u pranuar si deklaratë apo për t'u konsideruar si
6 deklaratë në vetvete.

7 Gjithashtu, flasim për autenticitetin. Shkurtimisht. Nuk
8 është nënshkruar nga dëshmitari. Është një dokument që thotë
9 është i fabrikuar. Nuk ka ndonjë incizim të një takimi të
10 tillë, nuk ka asnjë provë në shqip, nuk asnjë zbardhje fjalë
11 për fjalë të pyetjeve-përgjigjeve, nuk ka ndonjë dokument që
12 verifikon që është kryer ky takim. Thuhet vetëm që takimi
13 është mbajtur në një restorant, ne nuk e dimë sa ka zgjatur ky
14 takim e kështu me radhë.

15 Nëse ju mendoni se ka vlerë provuese ky, ne mendojmë që
16 vlera provuese në këtë rast është tejet e ulët për të gjitha
17 ato arsytet që u cekën nga z. Mair tashmë.

18 Së dyti, ne gjykojmë që ka gabime të pastra apo të qarta
19 në dokument. Dëshmitari i ka shpjeguar disa prej këtyre
20 gabimeve në Pjesën 10 të intervistës me ZPS-në. Një syresh,
21 për shembull, është që ai thotë që ka qenë komandant brigade
22 nga fundi i majit 1998 deri në fund të luftës në qershor të
23 1999. Por sidoqoftë Prokuroria kërkon pranimin e intervistave
24 të ZPS-së ku dëshmitari ka thënë që, në fakt, në UÇK është
25 kyçur drejt fundit të majit të 1998 dhe ka qenë shef i

1 logjistikës dhe financës në njësitin Arti dhe nuk ka qenë
2 komandant brigade. Dhe u bë komandant brigade vetëm nga fundi
3 i qershorit 1999.

4 Pra, vetëm tani lexova tre gabime të shkurtra, ka dhe
5 gabime të tjera që mund t'i gjeni në dokument dhe që janë të
6 qarta gjata intervistës.

7 Pra, ne gjykojmë që ka një vlerë provuese tejet të vogël
8 dhe sigurisht që ka efektet cenuese për Ekipet e Mbrojtjes
9 nëse pranohen deklaratat e një dëshmitari të cilat ai refuzon
10 t'i kryer sepse kjo prek në thelb akuzat për NKP-në, ajo që po
11 pranohet për këto deklarata, për politikën e ndjekur, është
12 shumë e mjegullt, nuk është konkrete. Nuk ka asnjë hollësi
13 kush, qysh, si e tek, nuk ka asnjë lloj njohurie.

14 Pra, t'i bashkojmë të gjitha këto parashtrime, ne
15 gjykojmë, po t'i bashkojmë, gjykojmë që këto dokumente nuk
16 duhen pranuar.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis dhe Z. Mair, ju
18 thatë që pajtoheni me parashtrimet e mëparshme. Cilat
19 parashtrime? Z. Dixon thotë që dëshmitari është i gatshëm të
20 japë dëshmi, znj. Tavakoli thotë që dëshmitari ka penguar
21 procesin.

22 Cilën prej këtyre parashtrimeve po ndiqni ju, cilën vijë,
23 cilën pistë?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë i bashkohem
25 veçanërisht parashtrimeve për pranueshmërinë që e ngriti z.

1 Dixon.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po nuk po diskutoni
3 lidhur me faktin a është i gatshëm të japë dëshmi dëshmitari
4 apo ka penguar procesin, cili është qëndrimi juaj?

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të sqaroj dhe unë diçka ju
6 lutem? Se mund të kem qenë pak e paqartë në parashtrimet e
7 mia. Unë pajtohem me z. Dixon kur thotë që në qoftë se atij i
8 jepet ky dokument, ai do të japë dëshmi. Po atij s'i është
9 dhënë dokumenti, kështu që ai po pengon procesin. Pra, dhe unë
10 pajtohem me z. Dixon sepse ai ka thënë që në qoftë se jepet
11 dokumenti ai do të japë dëshmi.

12 Kështu që qëndrimi është pak më i nuancuar, seç u duk.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe unë pajtohem me të njëjtën gjë.

14 Z. MAIR: [Përkthim] Edhe pajtohem me Ekipet e Mbrojtjes.
15 Të katër Ekipet e Mbrojtjes janë në të njëjtën linjë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria
17 dëshiron të kundërpërgjigjet?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

19 Pikësëpari, të sqarojmë fillimisht dy pika. Dëshmitarit i
20 është dhënë urdhër t'i përgjigjet pyetjeve. Dëshmitarit i
21 është dhënë dokumenti që ka kërkuar. Janë ndërmarrë, pra, të
22 gjitha hapat që kishim mundësi të ndërmerrim, aq sa mund të
23 bënim ne për të siguruar që dëshmitarit t'i tregohej
24 dokumenti. Ia treguam atë çfarë kishte thënë dokument. Ai u
25 pajtua gjatë seancës përgatitore që për këtë dokument bëhej

1 fjalë dhe se komentet ishin në lidhje me dokumentin. Ia
2 treguam dje. I dhamë numrin e referencës së këtij dokumenti.
3 Ia treguam dhe ai prapë e refuzoi, tha ky nuk është dokumenti.
4 Edhe kjo atëherë pjesë e rregullës 143 ku thuhet se dëshmitari
5 nuk po përpiqet që të japë dëshmi, nuk po bën përpjekje të
6 çiltra për t'u përgjigjur.

7 Ne ia treguam dokumentin dëshmitarit. Ai ka vendosur që
8 ta refuzojë këtë dokument dhe të thotë që unë s'e njoh këtë
9 dokument.

10 Më tej dëshmitari po ashtu ka thënë gjatë natës në një
11 postim në *Facebook* se ka për synim t'u përgjigjet të gjitha
12 pyetjeve që do t'i bëjnë ekipet e Mbrojtjes. Që do të thotë,
13 pyetjet që nuk donte t'u përgjigjej ai, ishin pyetjet e
14 Prokurorisë, jo të Mbrojtjes.

15 Gjithashtu, lidhur me dallimin mes Shënimit Përgatitor
16 numër 1 dhe 2. Këto dallime nuk ekzistojnë aktualisht. Është
17 një shënim përgatitor që i është lexuar tërësisht dëshmitarit.
18 Dhe mund ta shihni që në shumë pjesë ai -- ia kemi lexuar
19 specifikisht sepse kishte thënë që nuk i ka, pra, që ka pasur
20 pjesë që i ka pas të paqarta, ia lexuam, madje e lexuam së
21 bashku transkriptin edhe e pyetëm a pajtohej me këto apo
22 kishte korrigjime, këto janë të gjitha të hedhura në shënimin
23 përgatitor gjithçka që u diskutua.

24 Sa i takon deklaratës së UNMIK-ut dhe parashtimeve që
25 bënë kolegët e mi lidhur me këtë, këto parashtime lidhen me

1 peshën e dokumentit. Dhe nuk lidhen me pranueshmërinë e këtij
2 dokumenti. Deklarata e UNMIK-ut është një deklaratë që është
3 marrë në kontekstin e një procesi penal. Ka të gjitha
4 treguesit e një dokumenti të besueshëm që përmbushin kriteret
5 për pranueshmërinë. Gjithashtu, ju paraqitë kjo deklaratë dje
6 dëshmitarit dhe pretendimet që ngre ai tani lidhur me vrasjet
7 - më fal - pretendimet që ka ndritur me vrasjet ia paraqitëm
8 dje në sallën e gjyqit dhe ai tha se nuk është deklaratë e
9 tij. Kjo është një deklaratë atëherë e mëparshme
10 mospërputhëse.

11 Sa i takon refuzimit të dëshmitarit për të dhënë
12 përgjigje. Rregulla 143(2)(c) duhet lexuar e kombinuar me
13 rregullën 143(2)(b), pra, kur një dëshmitar nuk përpiqet në
14 mënyrë të çiltër të japë dëshmi për aspektet që dyshohet se ka
15 njohuri dhe ka dhënë një deklaratë të mëparshme lidhur me këtë
16 aspekt, atëherë ky dokument është i pranueshëm për vërtetësinë
17 e përmbajtjes së vet. Dhe, gjithashtu, dëshmitari ka dhënë
18 deklaratë në shkuarën dhe kjo është zbardhur dje në transkript
19 dhe ai i qëndron kësaj deklarate lidhur me këto aspekte që
20 lidhen me këtë lëndë gjyqësore dhe tani pozicioni i tij është
21 i papajtueshëm se ai po u refuzon t'u përgjigjet pyetjeve.

22 Pra, deklarata është e pranueshme sepse përmbush kriteret
23 e pranueshmërisë që paraqiten në rregullën 138 sa i takon
24 relevancës, autenticitetit dhe vlerës provuese.

25 Kjo është po ashtu në përputhje me paragrafin 107 të

1 Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor, i cili merr
2 parasysh rregullën 143(2)(a) dhe (c) të marra së bashku. Kjo
3 është në përputhje me kompetencën e Trupit Gjykues sipas
4 rregullës 40 dhe rregullës 137 dhe 138 të Rregullores.

5 Më tej, dëshmitarit i është ofruar disa herë mundësia që
6 t'u përgjigjet pyetjeve. Ai refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve
7 bazë sa u takonte rolit që ka pasur ai, detyrat që ka pasur
8 ai. Pra, duhen zbatuar këto rregulla rast pas rasti dhe nuk
9 kemi pse të çojmë dem kohën e Gjykatës e të vazhdojmë t'i
10 bëjmë pyetje një dëshmitari i cili qartazi shprehet që nuk do
11 t'u përgjigjet pyetjeve. Ai tha bilës: "Më vrisni po të doni
12 dhe unë s'përgjigjem".

13 Pra, rregullorja është në përputhje me vendimin e Trupit
14 Gjykues F01821, paragrafi 49, në të Trupi Gjykues është
15 shprehur se:

16 "Pranimi i qëndrimit të Mbrojtjes kur bëhet fjalë për një
17 deklaratë të mëparshme të një dëshmitari i cili nuk përgjigjet
18 në sallën e gjyqit si të papranueshme. Kjo do të thotë mos
19 kryerjen e detyrës civile, që ndërhyr në të drejtat e
20 viktimave të cilët kanë të drejtë për drejtësi dhe cenon
21 përgjegjësinë e Trupit Gjykues për të kontribuar në zbardhjen
22 e të vërtetës."

23 Dhe sipas nesh, saktësisht kjo është situata ku
24 qëndrojmë, ku jemi aktualisht.

25 Sa i takon cenimit të pretenduar edhe sikur dëshmitari të

1 mos u përgjigjet pyetjeve të Mbrojtjes, por që në fakt ai
2 gjatë natës e ka ndryshuar mendjen, Mbrojtja mund të paraqesë
3 prova dhe të bëjë parashtrime sa i takon besueshmërisë së
4 këtij dëshmitari dhe deklaratave të mëparshme. Pra, Ekipet e
5 Mbrojtjes mund të dorëzojnë çfarëdo dokumenti që kishin për
6 synim t'ia paraqesin dëshmitarit gjatë pyetjeve të veta dhe të
7 thërrasin çdo dëshmitar që dëshirojnë kur të kenë radhën e vet
8 të dëshmitarëve.

9 Gjithashtu, dëshiroj të bëj një pikë të fundit. Dua t'i
10 tërheq vëmendjen Trupit Gjykses lidhur me parashtrimin 01821
11 në paragrafin 30, ku thuhet që Trupi Gjykses thotë që
12 "paaftësia e Mbrojtjes a pamundësia e Mbrojtjes për t'i bërë
13 kundërpjetje dëshmitarit, nuk e bën një deklaratë të mëparshme
14 të papranueshme."

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje të
16 shkurtër, znj. Iodice, lidhur me një parashtrim të Mbrojtjes
17 Selimi. Çfarë mund të na thoni lidhur me sugjerimin që ju vetë
18 e keni pranuar që ka pas pavërtetësi në deklaratën e tij? Si
19 duhet ta marrim në këtë parasysh në kur të marrim vendim për
20 të pranuar apo jo?

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Këto mospërputhje janë
22 diskutuar në një nga dokumentet e ZPS-së që kërkojmë që të
23 pranohet dhe janë kryesisht të lidhura me datën, periudhën e
24 rolit që ka pasur z. Tara në Brigadën 124. Dhe sipas nesh nuk
25 ka qenë në maj të 1998. Edhe sa i takon mungesës së hierarkisë

1 në UÇK. Këto ishin pjesët që besojmë që kanë qenë të pasakta
2 në deklaratë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
5 kishit diçka për të thënë?

6 Z. DIXON: [Përkthim] Në postimin në *Facebook*. Më falni,
7 po ne jemi në Gjykatë, nuk jemi në *Facebook* këtu. Ne duhet të
8 bazohemi në atë që ka thënë dëshmitari dje në sallën e gjyqit
9 jo çfarë thotë në *Facebook*. Atë çfarë bën dëshmitari në
10 *Facebook* në juridiksionet e tjera do konsiderohej mosbindje
11 ndaj Gjykatës. Pra, dëshmitari po bën çfarë dëshiron. Hyn në
12 rrjete sociale, shpreh ndjenjat e veta. Jemi në territore
13 shumë të rrezikshme aktualisht se po mbështetemi tani në
14 postimet e një dëshmitari në mediat sociale dhe jo në atë që
15 ka thënë në sallën e gjyqit.

16 Unë parashtrimet i kam bazuar në atë që është thënë dje
17 në sallën e gjyqit. Kur tha që nuk do jap dëshmi në rast se
18 nuk më jepni dokumentin. Po askush nuk e ka pyetur këtë
19 dëshmitar për çfarë dokumenti e ke fjalën. Na e thuaj që mbase
20 e gjejmë që ta sqarojmë këtë dokument.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Ne, në fakt, e kishim për qëllim që ta merrnim vendimin
23 në lidhje me këtë në fund të pyetjeve tuaja. Por meqë të
24 gjithë ju po kërkonit së bashku që ne të marrim një vendim,
25 atëherë ne do vendosim për pranimin e këtyre dokumenteve për

1 pranimin sipas rregullës 143(2)(b) dhe (c), 138 dhe Urdhrit
2 për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor.

3 Më vonë do t'ju japim dhe arsyet pse vendosëm për
4 pranimin e tyre. Nuk mund ta bëjmë këtë gjë tani.

5 Tani sillni dëshmitarin në sallë.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ka dhe një rresht tjetër që duhet
7 ta redaktoja. Është një rresht që duhet të redaktoja u
8 propozua nga kolegët e mi, Mbrojtja e z. Thaçi dhe u pajtuam
9 së bashku që ta redaktojmë këtë rresht.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
11 identifikoni ju lutem, mund ta përmendni për procesverbal?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Ramë dakord që të redaktojmë
13 në Pjesën 4, faqja 14, rreshtat 17 dhe 18, një fjali është,
14 një fjali.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk ju dëgjova.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
17 [Përkthim] Kështu është?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, po. Po, për këtë bëhet
19 fjalë. Ramë dakord me Prokurorinë që të ta redaktonin. Në fakt
20 ne nuk ishim dakord fillimisht.

21 Dhe i kërkuam Prokurorisë që të hiqte gjithashtu faqen
22 22, rreshtin 23, deri në faqen 23, rreshti 2. Prokurori nuk
23 pranoi, Prokuroria nuk pranoi ta bënte këtë. Lidhet me numrat
24 e telefonit të z. Thaçi, Kadri Veseli dhe z. Haradinaj. Thamë
25 që këto lidhen qartazi me bisedën me Driton Lajçin, në këtë

1 kontekst kërkuam që të fshihej kjo pjesë nëse ky dëshmitar ka
2 komunikuar apo është përpjekur të komunikojë me z. Thaçi
3 përmes z. Lajçi. Dhe për ne kjo është pjesë përbërëse e
4 komunikimeve me z. Lajçi. Edhe ne gjykojmë që Prokuroria duhet
5 ta fshijë dhe këtë pjesë.

6 Mes kuptova unë, Prokuroria thotë që kjo lidhet me
7 mundësinë e këtij dëshmitari për t'i kontaktuar këta persona
8 në 1999, që mund të jetë kështu, por nuk është bërë pyetja në
9 këtë kontekst, kështu që për mua nuk ka kuptim që fjalia të
10 mbetet.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Kjo fjali lidhet me rolet që
13 ka pasur ai në 1999 dhe më kë kas pasur mundësi ai të
14 komunikonte në 1999.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk e
16 keni gjetur një zgjidhje, atëherë është e pranuar. Unë e
17 pranova tashmë. Do vazhdojmë tani.

18 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

19 Si do vazhdojmë Ekipet e Mbrojtjes? Z. Dixon i pari?

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkojmë
22 ndjesë z. Tara për këtë vonesë dhe Avokatit tuaj. Përfundam
23 parashtrimet tona. Tani do të fillojmë me pyetjet. Do të
24 fillojmë me pyetjet e z. Dixon.

25 Ju lutem uleni dorën. Z. Dixon do t'ju bëjë disa pyetje.

1 DËSHMITARI: Avokati im ka një kërkesë për mua.

2 Z. VAN STRAALLEN: [Përkthim] Nëse më lejoni. Unë e di që
3 po e përsëris disa herë kërkesën se është diskutuar dhe dje
4 dhe i është rrëzuar. Po klienti më kërkon sërish që unë ta
5 përsëris kërkesën që t'i jepni mundësinë klientit tim të flasë
6 dhjetë minuta për të folur lidhur me një dokument që i është
7 paraqitur dëshmitarit gjatë përgatitjes nga Zyra e Prokurorit
8 të Specializuar. Ai gjykon se është e nevojshme për të që të
9 flasë për këtë dokument sepse lidhen me sigurinë e tij përpara
10 se të fillojmë me dhënien e dëshmisë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk lidhet me
12 diskutimin që patëm ne sot. E kuptoj kërkesën tuaj. E vlerësoj
13 kërkesën tuaj. Nuk do t'ia miratojmë për momentin këtë
14 kërkesë. Do vazhdojmë me pyetjet e z. Dixon.

15 Z. Dixon, fjala është për ju.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

18 Z. DIXON: [Përkthim]

19 PY. Z. Tara, unë quhem Rodney Dixon. Dhe jam avokat i z.
20 Kadri Veseli.

21 Fillimisht dua që t'ju pyes lidhur me një temë. Dje i the
22 Gjykatës, Trupit Gjykses, se nuk je i përgatitur t'u
23 përgjigjesh pyetjeve Mbrojtjes, kështu the dje, nuk u
24 përgjigjem as pyetjeve të Mbrojtjes?

25 PË. Nuk jam përgjigjur për shkak të dyshimit tim lidhur me

1 një dokument i cili më ka përshkruar mua në intervistimet e
2 mia gjatë vitit 2019 të dëshmimeve të mia të dhëna, të
3 intervistave të mia të dhëna për 32 orë. Dhe ai dokument kurrë
4 nuk është paraqitur atëherë. Dhe është paraqitur për herë të
5 parë tash në përgatitjen me Prokuroren time me stafin e saj.
6 Dhe ai dokument është shumë shqetësues për mua.

7 Por e njoftoj Gjykatësin që sot dhe pse nuk ma latë këtë
8 mundësi ta shprehi kaq shqetësimin tim para palës mbrojtëse të
9 avokatëve, unë do t'i përgjigjem pyetjeve të atyre të gjitha.
10 PY. Që ta kuptoj --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ki
12 parasysh që do t'ju bëjë prapë pyetje Prokuroria dhe ke prapë,
13 do kesh detyrimin që t'u përgjigjesh në qoftë se do i
14 përgjigjesh Mbrojtjes e për detyrim t'i përgjigjesh dhe
15 Prokurorisë pastaj. E kupton këtë?

16 DËSHMITARI: Unë do t'i përgjigjem vetëm Mbrojtjes, palës
17 mbrojtëse.

18 Z. DIXON: [Përkthim]

19 PY. Që ta kuptoj, z. Dëshmitar, ju po thoni që nuk do t'i
20 përgjigjeni ekipeve të Mbrojtjes derisa të zgjidhet shqetësimi
21 juaj, domethënë, a do u përgjigjesh pyetjeve të Mbrojtjes, po
22 apo jo, Dëshmitar?

23 PË. A pyetjeve të Mbrojtjes, po, por të Prokurores time e
24 cila ka mçefur dokumentin tim, jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Avokat, a

1 ia keni shpjeguar detyrimin klientit tuaj që ai këtu është si
2 dëshmitar?

3 Z. VAN STRAALEN: [Përkthim] E kam shpjeguar.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A i kupton
5 rreziqet dëshmitari?

6 Z. VAN STRAALEN: [Përkthim] Nëse më lejoni. Mund të bëj
7 një pushim tjetër të shkurtër që të bisedojë me të, t'ia
8 shpjegoj dhe një herë këtë gjë?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
10 [Përkthim] Ka dalë tani si situatë.

11 Z. VAN STRAALEN: [Përkthim] Atëherë, do të flas edhe një
12 herë me klientin tani ose pasi të mbarojë Mbrojtja me pyetjet
13 e veta. Mund ta diskutojë dhe atëherë.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, ju
16 lutem, dilni nga salla dhe shpjegojani klientit -- një çast,
17 ju lutem. Vendosni dëgjueset. Po.

18 [Mikrofoni çaktivizuar]. Ju lutem shpjegojani qartë
19 klientit tuaj detyrimin që ka që ai duhet t'u përgjigjet
20 pyetjeve të Prokurorisë në qoftë se i përgjigjet Mbrojtjes.
21 Është detyrim. Është detyrim.

22 Z. VAN STRAALEN: [Përkthim] E kuptoj këtë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhjetë minuta
24 pushim.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Mos është dhe momenti që të bëjmë

1 pushimin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt ky
3 është pushimi. Bëjmë dhjetë minuta pushim. Bëjmë dhjetë minuta
4 pushim.

5 Largohuni nga salla.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
8 minuta pushim.

9 --- Seanca ndërpritet në orën 9.55

10 --- Seanca rifillon në orën 10.06

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
12 sillni dëshmitarin në sallë.

13 Më në fund, erdhi momenti që të vazhdojmë me pyetjet
14 tuaja.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Mund të vazhdoni, z.
17 Dixon.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
19 PY. Z. Tara, a mund të sqaroni se çfarë qëndrimi keni tani
20 mbasi u konsultuat me Avokatin? A po thoni që jeni i
21 përgatitur t'i përgjigjeni pyetjeve dhe në qoftë se përgjigjja
22 është "po", pyetjeve të kujt do i përgjigjeni?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] U bë kjo pyetje dhe e mori
24 përgjigjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 kundërshtimi.

2 Ju lutem, përgjigjuni, Dëshmitar.

3 DËSHMITARI: Unë, tash u konsultova me avokatin tim, se të
4 njëjtat pyetje që do t'i bëjë pala mbrojtëse të njëjta pyetje
5 për të njëjtën çështje do të pyeten edhe nga Prokuroria. Për
6 t'i ndihmuar palët mbrojtëse unë do t'i përgjigjem edhe
7 Prokurores time të dyshuar nga unë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 vazhdoni, z. Dixon.

10 Z. DIXON: [Përkthim]

11 PY. Për të qenë i qartë, 100 për qind, do i përgjigjeni edhe
12 pyetjes së Prokurorisë, këtë po thoni, Dëshmitar?

13 PË. Do i përgjigjem mbasi do të jenë pyetjet për të njëjtën
14 që ju do të më pyesni.

15 PY. Z. Tara, nuk i përcaktoni ju rregullat në këtë Gjykatë.
16 Po ju bëj një pyetje të drejtpërdrejtë. A do i përgjigjeni
17 pyetjeve që do ju bëjë Prokuroria, po apo jo?

18 PË. Në qoftë se do të jenë pyetje shtesë në lidhje me këto
19 pyetje që do t'i parashtroni ju, unë do t'i përgjigjem edhe
20 asaj, por në qoftë se del jashtë pyetjeve tuaja, nuk do t'u
21 përgjigjem.

22 PY. Z. Tara, besoj që do e kuptoni që ky është vendim që
23 duhet ta marrin Gjykatësit, jo juve.

24 A mund t'ju pyes, se pse, ose cila ka qenë arsyeja që dje
25 ju nuk keni pranuar t'i përgjigjeni pyetjes së Prokurorisë?

1 Keni thënë disa herë dje që ishte një dokument që dëshironit
2 që ta shihnit. A mund të na thoni, na shpjegoni, z. Tara,
3 çfarë është ky dokumenti?

4 PË. Ky dokument që është zhdukur prej Prokurores time, është
5 dokument i cili është përshkruar më 2019 nga të gjithë ata
6 hetues dhe Prokuratorë të mi që unë kam dhanë intervista për 32
7 orë. Por ai dokument nuk është përshkruar në prezencën time,
8 nuk më është treguar kurrë mua, as për t'u lexuar, as nuk e
9 kam nënshkruar dhe nuk kam pasur njohuri për atë dokument që
10 pesë vite me radhë vetëm se më datën 19 të mërkurën në
11 përgatitjen time me stafin e Prokurores, më është treguar ai
12 dokument për herë të parë.

13 Ai dokument përshkruan Tarën simbas përshkrimit të ish-
14 intervistuesve të mi, hetuesve, prokuratorëve të mi, sikurse
15 Ismet Tara të kish thënë se Ismet Tara i din shumë krime që
16 kanë ndodhur, që kanë bërë krime UÇK-ja, që kanë vrarë civilë,
17 që kanë ndezur shtëpitë, që kanë bërë krime jo njerëzore
18 simbas atyne përshkrimeve të atyre. Janë dy fletë, dy fletë të
19 cilat nuk i kam nënshkruar unë kurrë, nuk më janë paraqitur
20 kurrë, nuk i kam parë kurrë dhe nuk më janë dhënë kurrë. Për
21 herë të parë më janë zbuluar nga Prokurorja e cila e ka
22 zhdukur këtë dokument.

23 Aty janë edhe dy të cilët kanë qenë dy përfaqësues,
24 ndihmës të saj, ndihmësit e saj, të cilët edhe ata kanë qenë
25 prezentë. Ka qenë prezent edhe përkthyesja shqiptare. Dhe të

1 katërt janë të njoftuar me atë dokument dhe ai dokument sot
2 nuk është.

3 PY. Që ta kuptojmë qartë, ky dokumenti është hartuar, është
4 përgatitur nga Prokuroria që e keni parë për herë të parë në
5 seancën përgatitore? Këtë po thoni? Që ta kuptojmë plotësisht,
6 Dëshmitar.

7 PË. Jo, jo, zotëri Avokat, z. Mbrojtës, jo. Ai dokument është
8 përgatitur, mu më është thënë që është dokument, nga
9 Prokurorja më është thënë se dokumenti është i stafit tim
10 intervistues, për 32 orë në vitin 2019. Por kurrë atë
11 dokument, as nuk e kam parë, as nuk e kanë shkruar para meje,
12 as nuk e kanë diskutuar me mua dhe as më është dhënë të parë
13 dhe as nuk është i nënshkruar prej meje. Por është përshkrimi
14 gjeneral, më është thënë se është përshkrimi gjeneral se qysh
15 ata e kanë cilësuar intervistimin tim, po -- [Mikrofoni
16 çaktivizuar].

17 PY. [Nuk ka përkthim].

18 PË. [Flet anglisht].

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

20 Z. DIXON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më duket sikur
21 po thotë të njëjtën gjë, por do e sqaroj me dëshmitarin.

22 PY. Tara, z. Dëshmitar, juve po thoni për një shënim që është
23 bërë lidhur me dëshminë tuaj, pra ju po flisni për një shënim
24 të brendshëm, me një dokument të brendshëm që e keni pa për
25 herë të parë. Na e sqaroni pak më tepër, Dëshmitar.

1 PË. Avokat, nuk e di si t'ju spjegoj. Më është thënë nga
2 Prokurorja ime se ky dokument është i përshkruar prej
3 intervistimit tim të 2019, dhe është dokument që ti nuk e ke
4 nënshkruar, dhe më ka pyetur, a ke parë, a ke nënshkruar a
5 keni diskutuar për këtë dokument. Dhe unë kur kam filluar ta
6 lexoj këtë dokument, kam filluar të qaj, të shaj, të bërtas,
7 z. Avokat. Dhe një fletë e kam lexuar unë kur e kam parë se si
8 më kanë përshkruar ata mua. Unë jam trishtuar, e kam humbur
9 veten dhe më kanë hyrë frika se ende edhe sot e kësaj dite jam
10 i rrezikuar në lidhje me atë dokument në qoftë se nuk bëhet i
11 hapur dhe nuk paraqitet ai dokument që të shqyrtohet tërësisht
12 dhe të bëhet i njoftuar, se ai përshkrim është përshkrimi i
13 egër i dëshirave të tyre. Dhe, edhe një njoftim, për juve, z.
14 Avokat. Dhe menjëherë pas leximit të përkthyeses time --
15 PY. Në rregull, Dëshmitar. Faleminderit. Tani, na dhatë një
16 përshkrim të dokumentit. Ne do bëjmë pyetje lidhur me këtë
17 dokument dhe mund të ndodhë që më pas t'ju bëjmë pyetje lidhur
18 me të. Ndërkohë që tani aktualisht do t'ju bëj disa pyetje të
19 tjera. A e kuptoni këtë, Dëshmitar?

20 PË. Po, vetëm urdhnoni.

21 PY. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me njësitë ku keni marrë
22 pjesë ju personalisht, së pari. I keni thënë Prokurorisë se
23 keni qenë pjesë e njësitit Arti. Më pas keni punuar në zonën e
24 Pashtrikut, pra në nivel të zonës të Pashtrikut dhe më pas
25 keni shkuar në Brigadën 124. Domethënë, kjo është një

1 përmbledhje e njësiveve në të cilat ju keni qenë i përfshirë.

2 A është përshkrim i saktë ky, Dëshmitar?

3 PË. Zotëri Avokat, unë në fillim kam shkuar me ndihmat e
4 mia --

5 PY. Dëshmitar, nuk është e nevojshme që të jepni një
6 përshkrim shumë të gjatë. Thjesht përgjigjuni pyetjes që po ju
7 bëj unë. A është përshkrim i qartë i njësiveve të ndryshme në
8 të cilat ke qenë i përfshirë? Në qoftë se keni marrë në ndonjë
9 njësi tjetër, ma thoni këtë gjë, por nuk është e rëndësishme
10 që të më japësh një përshkrim të hollësishëm se ku ke marrë
11 pjesë.

12 PË. Po. Në këto tre pika kam qenë. Po, dhe plus kësaj unë kam
13 ndihmuar edhe shtabin e Likovcit. Atje me ndihmat e mia, me
14 ndihmat e mia të popullatës time me të gjitha ndihmat e
15 mundshme, me ushqim, me barna, me të gjitha të mundshme çka i
16 kanë dasht për ushqime në Likovc, Rezallë, edhe Plluzhinë.
17 Pastaj të njëjtën punë e kam bërë edhe në Drenovc.

18 Por, për herë të parë, unë si ushtar jam regjistruar në
19 shtabin Arti të Rahovecit. Pastaj është e saktë ajo që kam
20 kaluar në komandën e zonës dhe pas përfundimit të luftës, 15
21 ose 20 ditë pas përfundimit të luftës, e kam marrë detyrën
22 time zyrtare si komandant i brigadës pas përfundimit të
23 luftës. Brigadës 124 të qytetit të Rahovecit, të zonës së
24 Pashtrikut.

25 PY. Po. Faleminderit, Dëshmitar. Keni bërë ekzaktësisht atë

1 çfarë ju thashë që nuk duhet ta bënit, domethënë, dhatë një
2 përshkrim të plotë. Do ju kërkoja që përgjigjet të jenë të
3 kufizuara tek pyetjet, domethënë, t'i përgjigjeni vetëm
4 pyetjeve që do t'ju bëj unë. Për shembull, në qoftë se do të
5 doja më shumë hollësi, për shembull, për Brigadën 124, do jua
6 kërkoj vetë këtë gjë. Por, dua t'ju pyes, a e kuptoni këtë që
7 po ju them, domethënë, thjesht përgjigjuni pyetjes, në qoftë
8 se kam nevojë për informacione shtesë, do t'jua bëj vetë
9 pyetjet pasuese.

10 PË. Atëherë, do t'ju përgjigjem ma thjesht.

11 PY. Faleminderit. Në intervistën që i keni dhënë Prokurorisë
12 në vitin 2019, keni thënë si më poshtë. Do citoj atë çfarë
13 keni thënë. Ju lutem, ndiqeni përmes përkthimit dhe pastaj më
14 thoni në qoftë se e konfirmoni apo jo këtë, dhe më pas do ju
15 bëj pyetje lidhur me këtë çfarë keni thënë.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Për palët që na ndjekin, bëhet fjalë
17 për dokumentin 083217, pjesa 2, faqja 3.

18 PY. Në lidhje me UÇK-në ju keni thënë që:

19 "... ne ishim të gjithë luftëtarë vullnetarë për të
20 mbrojtur popullatën dhe për çlirimin e Kosovës. Ne nuk kemi
21 pasur asnjëherë një ushtri të rregullt. Nuk kemi pasur as
22 atëherë dhe as sot. Kryesisht përbëhej prej qytetarëve të
23 cilët ishin shumë të zemëruar me qeverinë serbe. Persona të
24 cilët kishin vështirësi me autoritetet serbe, të cilët në një
25 mënyrë ose një mënyrë tjetër ishin të keqtrajtuar prej

1 autoriteteve serbe. Në veçanti ushtarët e thjeshtë i përkisnin
2 kësaj kategorie njerëzve.”

3 Pyetja e parë është kjo: A ju kujtohet ta keni thënë këtë
4 gjë, Dëshmitar, dhe a është e saktë kjo?

5 PË. E kam thanë, dhe plotësisht e saktë.

6 PY. Faleminderit. Më tej keni thënë, dhe për palët që na
7 ndjekin e keni thënë në faqen 15 të të njëjtës, në faqen 15 të
8 të njëjtës pjese të dëshmisë tuaj, “kishte fjalë, qarkullonin
9 fjalë ose shpërndareshin fjalë ndërmjet njerëzve që ne donim
10 që të jepnim përshtypjen që kishim një ushtri të vërtetë, por
11 sikurse e thashë, ne nuk kemi pas asnjëherë një ushtri reale
12 apo të vërtetë.”

13 A e keni thënë këtë, ju kujtohet ta keni thënë këtë,
14 Dëshmitar, apo jo?

15 PË. Nuk më kujtohet që kam thënë, por dhe në qoftë se kam
16 thënë, në atë kuptim ndoshta po. Por nuk më kujtohet që e kam
17 thënë. Dhe duhet të vërtetohet dhe njëherë, të merret edhe
18 përkthimi me anglisht, sepse unë kam hasur në shumë gabime të
19 përkthimit shqip gjatë përgatitjes time me Prokurorët. Dua ta
20 përkthesh prej anglishtes në shqip, në qoftë se -- a është
21 prej anglishtes kjo?

22 PY. Do ju bëj këtë pyetje, Dëshmitar, dhe prandaj ju pyeta,
23 ju thashë a është e saktë apo jo. A është e vërtetë që
24 qarkullonin fjalë ndërmjet njerëzve, popullsisë, për të dhënë
25 përshtypjen që ju kishit një ushtri të rregullt?

1 PË. Me siguri që po, kanë qarkulluar fjalë.

2 PY. Këto fjalë që qarkullonin, a kishin të bënin me faktin që
3 ju kishit shumë trupa që ishin të trajnuar e të stërvitur
4 mirë, dhe që ishin në gjendje që të kundërshtonin dhe të
5 luftonin, të mundnin forcat serbe? Domethënë, kështu lloj
6 fjalësh qarkullonin, Dëshmitar?

7 PË. Kurrë, kurrë, kurrë jo. Nuk kemi pasur një ushtri të
8 rregullt.

9 PY. Po, dëgjoni pyetjen, Dëshmitar, dhe përgjigjuni pyetjes.
10 Cilat ishin fjalët që qarkullonin? Në qoftë se e dini.

11 PË. Fjalët që qarkullonin, që po u grumbullohen ushtarët e
12 UÇK-së për t'i dalë ndihmë Kosovës, për çlirimin e saj.

13 PY. Faleminderit. E keni thënë gjithashtu, dhe për
14 procesverbal këtë e keni thënë në faqen 15, pak më poshtë në
15 faqe, në të njëjtën pjesë të intervistës tuaj, se kur keni
16 qenë duke formuar brigadat, dhe kjo është thënë në kontekstin
17 e periudhës pas ofensivës serbe në verë, që:

18 " ... ata nuk kanë pasur më shumë se sa 150 apo 160
19 vetë ... në to."

20 Pra, flitet për "njësitë për brigadat", ju thoni, dhe:

21 "Ishte politike", thoni, "ishte një përpjekje politike që
22 publiku të krijonte përshtypjen që ju kishit një ushtri në
23 Kosovë."

24 Kjo që keni thënë te kjo pjesë e intervistës, a është e
25 vërtetë, Dëshmitar?

1 PË. Unë kam thënë në këtë intervistë se deri në kthimin tim
2 prej Shqipërisë pas 20 shtatorit, kurrë nuk kam dëgjuar
3 asnjëherë që ekzistojnë brigadat e UÇK-së. Për mua, deri në
4 atë kohë, as dëgjuar, as folët që ekzistojnë brigadat. Mirëpo,
5 vetëm shtabet lokale të qyteteve dhe të rretheve, të katundeve
6 nëpër Kosovë.

7 PY. Po ashtu është e drejtë, apo jo, Dëshmitar, që edhe
8 përpara se sa të shkonit në Shqipëri, dhe pasi u kthyet nga
9 Shqipëria, kishte mungesë hierarkie në UÇK. Domethënë, me
10 fjalë të tjera, kishte një mungesë të zinxhirit të komandës
11 nga njësitet dhe më sipër në hierarki. A është një vlerësim,
12 një përshkrim i saktë ky?

13 PË. Pas 20 shtatorit, është folur që duhet të organizohemi në
14 brigada. Mirëpo, brigadat deri në fund të luftës, kurrë nuk
15 kanë numëruar më shumë se 400, 500 ushtarë. Por, vetëm është
16 folur, vetëm është folur për organizimin e brigadave. Kjo pas
17 daljes së shtabit të zonës së Pashtrikut.

18 PY. Pra, qarkullonin fjalë sa i takon organizimit të UÇK-së.
19 Këtë na e thatë. A ishte përshtypja gjithashtu që ekzistonte
20 dëshira për të krijuar këtë idenë që ekzistonte një hierarki,
21 ndërkohë që hierarkia realisht nuk ekzistonte siç duhet.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Dixon, a mund të sqaroni
23 pak periudhën kohore?

24 Po ashtu, z. Dëshmitar, kur flisni për 20 shtatorin, a
25 mund të na sqaroni për cilin vit e keni fjalën?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Po, Faleminderit, i nderuar
2 Gjykatës.
3 PY. Ne po flisnim, besoj unë për 20 shtatorin e 1998? A është
4 kështu, Dëshmitar?
5 PË. Po. Mbas 20 shtatorit të 1998, kur në Kosovë nuk kanë
6 mbetur ndoshta as 300-400 ushtarë të krejt UÇK-së. Kur jemi
7 kthyer na.
8 PY. Për këtë periudhë kohe po të pyesja në fund. Pra, gjatë
9 kësaj periudhe, ju po qarkullonit fjalë se me kinse ekzistonte
10 një armatë, një ushtri e rregullt që kishte një hierarki të
11 përcaktuar. Megjithatë, besoj që kjo nuk ishte situata reale
12 në atë kohë, apo jo? Ishin thjesht fjalë që qarkullonin, apo
13 jo?
14 PË. Jo. Aty është folur për këtë vetëm se për t'i dhënë
15 vullnet ushtarëve të rinj të kyçen, sepse mbas ofensivës së
16 shtatorit, UÇK-ja gati e tëra është shpërbërë nga forcat
17 serbe.
18 PY. Për këtë arsye po të pyes lidhur me këtë periudhë kohe.
19 Pra, në qoftë se e kuptova siç duhet përgjigjen që na dhatë.
20 Gjatë asaj periudhe qarkullonin shumë fjalë ose kishte shumë
21 biseda për një strukturë që në fakt nuk ekzistonte. Sepse ju
22 ishit dëmtuar shumë nga ofensiva serbe. A është e saktë kjo?
23 PË. As ushtarët nuk kanë ekzistuar, jo brigada, kur jemi
24 kthyer na. Por është filluar, është filluar një përgatitje që
25 të vijjnë ushtarët e rinj dhe të kthehen ushtarët e vjetër të

1 cilët kanë, janë larguar në Shqipëri që të përmbushet numri
2 sadopak i ushtarëve.

3 Ka filluar organizimin e brigadave pa ushtarë. Pa ushtarë
4 as për njësite më të vogla, jo për brigada.

5 PY. Kur thoni, organizimi i kësaj ka filluar, a mund të na
6 ndihmoni dhe mund të na shpjegoni se çfarë hapash keni marrë
7 juve lidhur me këtë?

8 PË. Unë edhe në atë kohë kam qenë ende financiar i shtabit
9 Arti, zonën, të shtabit të Artit të Rahovecit, dhe ende si
10 anëtar i logjistikës të shtabit Arti të Rahovecit, të
11 komandantëve të mi, Xhelal Hajda, Toni, dhe Seladin Mullabazi,
12 Mici. Ende atë detyrë pas kthimit të 21 shtatorit në Krushën e
13 Madhe.

14 Dhe në Krushën e Madhe ne jemi kthyer prej 170 ushtarë
15 vetëm 7 ose 8 ushtarë. Të gjithë të tjerët kanë mbetur në
16 Shqipëri, në pamundësi të vijnë të depërtojnë duke ditur se
17 rreziku ka qenë shumë i madh, edhe të gjithë të vdesin gjatë
18 kthimit në Kosovë.

19 PY. Po, e kuptojmë. Tani të kthehemi pas një çast në
20 periudhën përpara se sa u larguat për në Shqipëri. Në atë
21 periudhë nuk ka pasur strukturë hierarkike të UÇK-së, apo jo
22 Dëshmitar?

23 PË. Jo, jo. Asnjëherë.

24 PY. Sa i takon njësiteve të ndryshme që ju i keni përshkruar,
25 në këtë periudhë, se për periudhat e tjera do vazhdojmë të

1 diskutojmë pak më vonë. Në atë periudhë, a keni pasur mundësi
2 ju të dini gjatë gjithë kohës se kush ishte pjesë e njësimit
3 tuaj, apo ndodhte rëndom që dikush të vinte dhe dikush të ikte
4 prej njësimit?

5 PË. Ka ndodhur ajo, mirëpo regjistrimin e të gjithë ushtarëve
6 të cilët janë regjistruar në shtabin Arti e ka bërë profesor
7 Dr. Sabaudin Cena, dhe profesori im, në një mënyrë të
8 rregullt, të plotë. Me përshkrimin me datat e kyçjes, me
9 moshën, me ditën e kyçjes, me të gjitha. Është një përshkrim
10 shumë, shumë i rregullt. Edhe pse unë nuk i kam njoftur kurrë
11 të gjithë ushtarët, sepse unë kam qenë financier dhe shef i
12 logjistikës, shef i financave të shtabit Arti, dhe shef i
13 logjistikës. Se unë nuk kam pas të bëj asgjë me ushtarët.

14 PY. Me sa dini ju, në njësinë tuaj, njësitet e tjera po
15 ashtu, njerëzit ndonjëherë, edhe bashkoheshin në njësitate pa e
16 ditur, ose ndoshta edhe asocioheshin ose lidheshin me njësitin
17 tuaj pa pasur njohuri juve. A ka ndodhur kështu, apo jo?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] U bë pyetja, e mori përgjigjen.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
20 kundërshtimi i Prokurorisë.

21 Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitar. Përgjigjuni, ju lutem.

22 DËSHMITARI: Mund të ketë ndodh, por unë nuk kam qenë i
23 njoftuar. Unë ju thashë se në ato kohë unë kam qenë shefi i
24 financave dhe shef i logjistikës. Nuk kam pas të bëj asgjë
25 lidhje me ushtarët. Kjo, këto janë njohjet e mia vetëm që i

1 flas ashtu, sepse unë nuk kam njohuri rreth ushtarëve nëpër
2 pika. As në pikën time Arti ku edhe unë jam bashkëthemelues me
3 bashkë tre komandantët e mi.

4 Z. DIXON: [Përkthim]

5 PY. Pra, është e drejtë të thuhet që në atë kohë ju nuk e
6 dini se çfarë ndodhte përtej njësitit tuaj, apo çfarë ndodhte
7 në zonat e tjera?

8 PË. Jo.

9 PY. Të kalojmë tani tek periudha kur ktheheni nga Shqipëria,
10 e kam fjalën për shtatorin edhe në vijim, roli juaj në atë
11 periudhë sikurse e thatë, ka qenë brendapërbrenda zonës. A
12 është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Jo, roli jonë, roli jonë është përbrenda, për zonën është
14 mbas vrasjes së komandant Tonit edhe Micit. Rolin ne e kemi
15 kryer deri në, deri në vrasjen edhe pas vrasjes të Tonit,
16 Micit, më 6 nëntor 1998. Atëherë, atëherë kemi filluar. Ka
17 qenë roli im për t'i grumbulluar ushtarët, të cilët kanë
18 mbetur nëpër katunde, ndoshta dhe ndonjë ushtar i yni që nuk
19 ka dalë në Shqipëri, ose duke pritur dikënd që të vijë prapë
20 të na bashkohet, si shtabit Arti. Jo si brigadës, jo si
21 batalionit, jo si njësisë, jo të emëruar nji, sikurse që kemi
22 qenë shtabi Arti, deri pas vdekjes së Tonit edhe Micit në 6
23 nëntor, nuk ka qenë organizimi i ushtrisë UÇK-së nëpër brigada
24 ose zona.

25 PY. Pra, në këtë fazë, ju jeni caktuar nga komandant Drini

1 për të punuar me zonën e Pashtrikut, domethënë për të qenë
2 pjesë e strukturës së zonës së Pashtrikut. A është e saktë
3 kjo, Dëshmitar?

4 PË. Kjo është mbas vitit të ri 1998. Domethënë, në vitin
5 1999, më 1 janar, unë kam shkuar në komandën e Drinit, të
6 zonës së Pashtrikut.

7 PY. Komandant Drini në fillim të 1999, po thoni ju, apo jo,
8 ka qenë personi që ju ka caktuar në atë pozicion, pra që të
9 punonit me financat dhe logjistikën në nivel zone. Ka qenë
10 komandant Drini apo jo?

11 PË. Komandant Drini ka qenë, por jo tash, jo dhe i
12 logjistikës, por unë kam qenë vetëm financier i zonës së
13 Pashtrikut, jo tash i logjistikës. Në zonën e Pashtrikut si
14 anëtar i komandës së zonës së Pashtrikut, unë kam qenë vetëm
15 financier i zonës.

16 PY. Kjo detyrë juve ju është dhënë nga komandant Drini, apo
17 jo?

18 PË. Po. Po.

19 PY. Ju nuk jeni caktuar në atë post nga Shtabi i Përgjithshëm
20 i UÇK-së, nuk ka qenë fare i përfshirë Shtabi i Përgjithshëm i
21 UÇK-së lidhur me këtë, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Kurrë, jo. As takuar me mu, jo. As diskutuar me mu kush,
23 jo. Mirëpo, vetë komandant Drini ka ardh për Vit të Ri e kemi
24 vizituar Vitin e Ri në Retijë, ku jemi qëndruar me të gjithë
25 ushtarët, dhe mbas Vitit të Ri më 1 janar 1999, së bashku me

1 Drinin, kemi udhëtuar në shtabin e zonës së Pashtrikut. Së
2 bashku me Drinin.
3 PY. Vazhdojmë më tej, në mënyrë të tillë që të kemi të gjithë
4 situatën parasysh. Ju jeni caktuar në fund të qershorit të
5 vitit 1999 si komandant i Brigadës 124, a është e saktë kjo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Unë e kam përcaktuar, po prapë saktësisht nuk jam, në
8 datat nuk jam i saktë. Sepse në ato kohë kur jam kthyer unë në
9 qytet, jam kthyer si anëtar i zonës, si financier i zonës së
10 Pashtrikut, domethënë, si përgjegjës ndaj komandant Drinit.

11 Mirëpo, më 25 mars -- më 24 mars bombardimet e para të
12 NATO-s, unë jam larguar nga Drini dhe i jam bashkangjitur
13 ushtarëve tash të brigadës që e kam krijuar mbas 6 nëntorit,
14 vrasjes së Tonit e Micit, Brigadës 124, Gani Paqarizit, që e
15 kanë emëru. Jam kthyer, jam bashkuar me atë pjesë të ushtarëve
16 që kanë qenë diku 200 ushtarë, dhe deri në përfundim të
17 luftës, deri në ardhjen time në Rahovec, më 12 natën, më 13
18 kemi zbritur në qytet në shkollën sot që quhet Xhelal Hajda,
19 Toni. Më 13 qershor. Dhe unë pas nja dy jave, pas kësaj, ma së
20 pakti dy javëve, jam caktuar si komandant --

21 PY. Në rregull, Dëshmitar. E kuptoj, më falni që ju
22 ndërpreva, por doja thjesht të konfirmoja që je caktuar rreth
23 kësaj periudhe kohore. Nuk është nevoja për shumë detaje.

24 PË. Po, për afërsisht.

25 PY. Fokusohu tek pyetja, të lutem. Ti në shënimin përgatitor,

1 në paragrafin 97, ke thënë që je caktuar në këtë pozitë nga

2 Sylejman Selimi.

3 PË. Po.

4 PY. Të kujtohet?

5 PË. Me vendim, me vendim të lëshuar nga Sylejman Selimi.

6 PY. Ke thënë që ky vendim është nxjerrë me shkrim?

7 PË. Po.

8 PY. E ke më këtë dokument?

9 PË. Jo. Jo, zotëri.

10 PY. Në atë kohë, e dije ti që Sylejman Selimi nuk ishte më në

11 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së? Ishte larguar, ishte larguar

12 në fund të qershorit të 1999, Sylejman Selimi.

13 PË. Nuk e dija, nuk e dija, por unë e kam marrë emërimin tim

14 nga Sylejman Selimi, komandant i Brigadës 124 pas ardhjes në

15 qytetin tim, në Rahovec. Dokumenti është çuar në emër të

16 komandant Sylejman Selimit. Tash, unë prapë po i them, nuk jam

17 i saktë me datat, por e di që një pjesë mbas ardhjes time në

18 Rahovec, sepse në atë kohë komandant zyrtar i Brigadës 124 ka

19 qenë Skënder Hoxha.

20 PY. Po, po, e dimë që e ke zëvendësuar. Por po përpiqem të

21 sqaroj këtë, ky zëvendësim nuk u bë nga komandanti i zonës në

22 atë kohë? Domethënë, nuk e bëri komandanti i zonës së

23 Pashtrikut zëvendësimin?

24 PË. Jo. Vendimin për komandant të Brigadës 124 e kam marrë me

25 emërimin e Sylejman Selimit.

1 PY. Por a ke folur ti atëherë me komandantin e zonës për këtë
2 emërim?

3 PË. Jo, nuk kam folur me komandantin e zonës fare. Ende pa u
4 takuar me komandantin e zonës. Ende pa u takuar me komandantin
5 e zonës, jam emëruar komandant i brigadës nga Sylejman Selimi.

6 PY. Kush ka qenë komandant i zonës që ke takuar ti atëherë?
7 Komandant Drini apo z. Sinani?

8 PË. Thashë, unë nuk e di kur janë bërë zëvendësimet, me Tahir
9 Sinanin, me komandant Drinin. Por unë i kam taku, unë e kam
10 takuar pas kësaj, pas emërimit tim kur kam bërë, kur kemi bërë
11 edhe takimet javore me komandën e zonës në Prizren. Jam
12 njoftuar që komandant Drini është ndërruar nga Tahir Sinani.
13 Në cilën kohë, nuk e di. Unë nuk kam qenë prezent, domethënë,
14 prej 24 marsit, bombardimit të natës së parë në Kosovë e deri
15 pas çlirimit të Rahovecit, pas emërimit tim nuk jam takuar me
16 komandant Drinin.

17 PY. Po. Janë dhënë dëshmi në këtë sallë gjyqi nga Bislim
18 Zyrapi dhe të tjerë, se personat në nivel brigade emëroheshin
19 nga komandantët e zonave, jo nga nivele më të larta. Ja ta
20 përfundoj pyetjen. A ka mundësi që ta kesh gabim? Sepse në
21 fakt ty të ka emëruar komandanti i zonës, dhe ka marrë më pas
22 miratimin prej Selimit? A mund të ketë ndodhur kështu?

23 PË. Ndoshta në qoftë se komandanti i zonës, ia ka paraqitur
24 kërkesën Sylejman Selimit, unë atë nuk e di. Por unë e kam
25 marrë emërimin tim nga Sylejman Selimi. Por në qoftë se ia ka

1 paraqitur kërkesën komandanti i zonës atij, unë nuk e di.

2 PY. Domethënë, ti nuk e di se çfarë procesi është ndjekur për
3 emërimin tuaj, apo jo?

4 PË. Jo. Jo.

5 PY. Në këtë periudhë kohore, flasim për qershorin e 1999, dhe
6 pas qershorit, a është e vërtetë që në atë kohë ti nuk i ke
7 njohur të gjithë ushtarët në brigadën tënde? Njihje disa, por
8 shumë prej tyre dhe nuk i njihje, kështu?

9 PË. Kohës, nëntorit 1999? Mbas vdekjes ose para vdekjes së
10 Tonit?

11 PY. Jo, jo. Qershor. Qershor, korrik, të 1999, kur more rolin
12 e komandantit, pra. Kur more rolin e komandantit --

13 PË. Pas luftës?

14 PY. -- qershor, korrik të 1999. A është e vërtetë që nuk e ke
15 ditur, nuk i ke njohur shumë prej ushtarëve në brigadën tënde?
16 Qershor, korrik, këtu fokusohu, të lutem.

17 PË. Pas marrjes së detyrës time si komandant brigade? Jo që
18 nuk e kam njohur, as nuk e kam njohur asnjë të shtatën, tetën
19 pjesë të ushtarëve nuk e kam njohur, se kanë ardhur përmbi një
20 mijë, më shumë ushtarë të cilët kanë marrë pjesë në luftërat e
21 Pashtrikut dhe luftërave të tjera që kanë qenë zhvilluar nga
22 Shqipëri për të depërtuar nga Shqipëria në Kosovë.

23 PY. Po. Domethënë, shumë ushtarë erdhën nga Shqipëria, shumë
24 persona të armatosur që ti nuk i njihje, u kyçën në brigadën
25 tënde pa e ditur ti kush ishin këta persona, a është e saktë?

1 PË. Po, pa e ditur dhe pa i njohur, vetëm se më një dëftesë,
2 me një nënshkrim, me një nënshkrim të komandantëve të tyre që
3 kanë luftuar në ato pjesë të tjera prej Shqipërisë duke u
4 futur për Kosovë, me një dëshmi në qoftë se kam takuar vendeve
5 të Brigadës 124 të Rahovecit, të gjitha fshatrave dhe të
6 qytetit të Rahovecit, janë regjistruar në komandën time si
7 ushtarë të komandës time, pa i njohur fare.

8 PY. A është e vërtetë po ashtu që shumë persona vinin dhe nuk
9 ishin pjesë e asnjë brigade, ishin thjesht persona me armë,
10 luftëtarë, që vepronin në zonën tuaj?

11 PË. Jo, nuk ka pasur të tillë, sepse nuk janë regjistruar
12 asnjë ushtar jashtë territorit të Rahovecit, komunës së
13 Rahovecit, nuk ka pasur mundësi të regjistrohet nga Ismet
14 Tara, ose nga komandanti i 124, por është dërguar zonës ose
15 brigadës cilit fshat ose cilit qytet i ka takuar ai ushtar.

16 PY. Nuk po flas për regjistrimin, po them shumë, kishte shumë
17 luftëtarë të parregullt që ishin kthyer dhe që vepronin në atë
18 kohë, të cilët nuk i kontrolloje në atë kohë?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është bërë pyetja, ka marrë
20 përgjigje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I qëndroj
22 Prokurorisë, pranohet kundërshtimi.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk e pyeta për komandimin e disa
24 ushtarëve, unë po e pyes për ushtarët që s'i kontrollonte dot.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta

1 riformulosh pyetjen.

2 Z. DIXON: [Përkthim]

3 PY. Z. Tara, unë dua t'ju pyes për këtë. A ka pasur persona
4 të armatosur në zonën tënde të cilët nuk i kontrolloje ti, nuk
5 mund t'i kontrolloje. Me të cilët s'kishe asnjë kontroll?

6 PË. Mbas kthimit të popullatës shqiptare, mbas çlirimit, nga
7 Shqipëria, ata edhe kur janë kthyer në Kosovë të gjithë janë,
8 kanë qenë të fiksuar dhe të frustruar dhe nuk kanë ditur se ku
9 po kthehen, nuk kanë qenë të sigurt se a janë pjesët e tyre të
10 çliruar. Jo vetëm njerëz të tillë, por shumica edhe banorëve,
11 edhe familjarët të familjeve të cilët kanë me ta, kanë të
12 armatosur dhe kanë ardh edhe me armë në Kosovë. Jo vetëm si
13 njerëz, por unë e di që edhe shumë qytetarë, të cilët janë
14 kthyer nga Shqipëria kanë ardh me armë personale të atyre,
15 sepse kanë menduar që nuk kanë qenë të sigurt se ende
16 ekzistojnë forcat serbe në Kosovë. Por me ta unë nuk kam pas
17 punë asgjë dhe nuk di detajisht me ju tregu asgjë. Ama që ka
18 pas, ka pas.

19 PY. Faleminderit. A është e vërtetë që shumë prej këtyre
20 personave ishin të inatosur, të zemëruar, kur panë
21 shkatërrimet kur u kthyen. Shkatërrimet që kishin shkaktuar
22 forcat serbe. Dhe shumë prej tyre deshën të merrnin hak, të
23 kujtohet të ketë qenë kështu?

24 PË. Me siguri që ata kur janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre
25 nuk kanë ekzistuar kur janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre,

1 familjet e tyre janë zhdukur, janë vrarë, janë masakruar, janë
2 djegur. Dhe ajo është normale që ata të jenë të frustruar. Dhe
3 kanë mund të bëjnë gjithçka.

4 PY. Po. Dhe ka pasur raste kur personat e kanë marrë vetë
5 ligjin në duar, dhe kanë marrë hak për atë që kishte ndodhur.

6 Të kujtohet?

7 PË. Jo. Nga unë e ditur jo.

8 PY. Po, do shohim disa raste kur të vijë momenti, se mbase ju
9 ndihmon me kujtesën. Po a pajtoheni me këtë që them unë që në
10 këtë kohë, në atë kohë, ka qenë një periudhë krejt kaotike,
11 kishte shumë persona të armatosur në territor, dhe ka qenë e
12 vështirë ta kontrolloje situatën, pra që ta mbaje në kontroll
13 situatën. A është një përshkrim i drejtë ky?

14 PË. Të kuptohemi, z. Avokat. Në atë kohë, prej ardhjes time
15 si komandant, në qytetin e Rahovecit, unë nuk kam qenë
16 përgjegjës për sigurinë të askujt, sepse përgjegjësinë e ka
17 marrë KFOR-i dhe UNMIK-u. Unë kam qenë në bashkëpunim duke i
18 ndihmuar KFOR-it edhe UNMIK-ut për të gjitha problemet që kanë
19 mund të ndodhur, sepse unë nuk kam qenë as i obliguar, as nga
20 komanda ime, as nga komandantët ma të lartë e ma të poshtë,
21 nga askush dhe nuk kam mundur unë të bëj atë punë. Sepse unë
22 jam njoftuar menjëherë mbas marrjes së detyrës time si
23 komandant i brigadës, jam takuar me komandant Ton Van Loon jam
24 takuar me përfaqësuesit e UNMIK-ut, jam takuar me
25 përfaqësuesit e OSBE-së, dhe mu më është bërë e ditur që unë

1 atë punë nuk mund ta kryej.

2 Unë nuk kam mundur të dij as ushtarët e mi ku janë. Edhe
3 ata që janë kthyer, të mitë, nja 200-250 janë kanë të brigadës
4 krejt. Sepse unë, nuk kemi pasur kazerma t'i sistemojmë ata.
5 Unë në komandën e policisë, në stacionin e policisë kur jam
6 vendosur për herë të parë unë kam mundur 50, 60, 70, maksimum
7 me u fut aty, me ndejt, jo me fjet. Aty nuk ka pas vend as për
8 fjetje. Ne nuk kemi pas kazerma që t'i shtimë ata ushtarë edhe
9 ata të jenë të kazermuar. Janë kthyer nëpër shtëpitë e veta,
10 ndoshta dhe nuk janë parë gjatë tërë kohës sa kam qenë
11 komandant në atë asnjëherë.

12 Nuk e kam pas atë obligim unë.

13 PY. Z. Tara, e kuptoj këtë, që ju po përpiqeshit të bënit të
14 pamundurën me aq pak sa kishit. Por, ka qenë një situatë që e
15 ka evidentuar edhe KFOR-i edhe UNMIK-u, që situata në atë kohë
16 ka qenë kaotike, ka qenë shumë e vështirë, kishte shumë
17 persona të armatosur dhe të zemëruar në zonën.

18 PË. Po, ajo është -- po. Por, komandant Tara nuk ka pas as
19 detyrë as mundësi se nuk më është lejuar as nga KFOR-i, as nga
20 UNMIK-u, as nga OSBE-ja, unë të ndërhyj. Unë kam pas punë
21 vetëm me ushtarët e mi dhe kurrgjë ma tepër. Derisa jemi
22 çarmatosur në shtator, derisa jemi kthyer në TMK, kur jemi
23 kthyer në TMK. Ne nuk kemi pasur detyra të caktume. Ne nuk
24 kemi pas as urdhra çka të bëjmë, vetëm të qëndrojmë qashtu.
25 Neve mbas nji kohe të shkurt na janë marrë armatimet prej

1 KFOR-it, ne kemi mbetur në komandë në tre, katër, pesë revole
2 që kemi nxjerrë leje, na u ka dasht edhe leje të KFOR-it të
3 marrim për ato revole. Nuk e di a jeni njoftuar lidhur me
4 procesin, se unë kam qëndruar deri në shndërrimin e, deri në
5 shndërrimin e UÇK-së në TMK. Nji kohë njimujore, ose nji muaj
6 pak ma tepër, ne na ka lejuar KFOR-i të qëndrojmë. Pastaj ka
7 ardh demobilizimi i UÇK-së. Dhe ne jemi demobilizu dhe armatim
8 vetëm pesë, gjashtë veta ushtarë kemi pas komandantë ose
9 njerëz kryesorë të komandës.

10 PY. Po, z. Tara. Iu përgjigje pyetjes. Në fillim e dhe
11 pyetjen -- e dhe përgjigjen shkurt, por pastaj na dhe hollësi
12 të panevojshme. Të lutem, mundohu t'i përgjigjesh vetëm
13 pyetjes, e theksoj këtë.

14 Ti the se merreshe dhe me KFOR-in dhe me UNMIK-un. A
15 është e vërtetë që në atë kohë, dhe në vitin pasardhës, pra
16 viti 2000 madje dhe 2001, ke pasur shumë takime me UNMIK-un
17 pikërisht për këto temat që sapo diskutove, a është e vërtetë?
18 PË. Jo, nuk është e vërtetë. Nuk është e vërtetë. Mbas daljes
19 time, mbas daljes time, para Vitit të Ri 1999, unë nuk kam
20 bërë takime më me, për problemet e mia që kanë ndodhur, mund
21 të tregoj çka, çka kam pas. Ama unë për njoftime, për bisedime
22 me ta, unë nuk kam pas, asnjëherë mbas largimit nga detyra
23 ime. Mbasi që kam dhënë dorëheqje, jo që jam zëvendësuar, por
24 unë kam dhënë dorëheqjen time, mbas procesit të përfundimit të
25 procesit të largimit të forcave ruse nga Rahoveci, mbas

1 protestave tremuajshe, unë kam dhënë dorëheqje dhe ma nuk jam
2 interesuar më për UÇK-në dhe as për ndërkombëtarët, por që
3 kanë marrë kohë mbas kohe televizionet e ndryshme ndonjë
4 informatë që kam dhanë, është mundësia. Por që jam vizituar,
5 edhe mbas kësaj nga dikush, jam vizituar. Por unë nuk kam pas
6 më takime të rregullt me askënd.

7 PY. Do flasim edhe për televizionet dhe gazetarët, por dua të
8 sqaroj këtë. Deri në cilën periudhë ke pas komunikime me
9 UNMIK-un, deri në cilën datë?

10 PË. Me UNMIK-un dhe me KFOR-in zyrtarisht, rregullisht jemi
11 takuar për çdo ditë. Me UNMIK-un, OSBE-në, edhe KFOR-in,
12 rregullisht derisa kam qenë unë komandant i brigadës. Ato kanë
13 qenë takime përçdoditore, ndoshta dhe dy-tri herë në ditë në
14 qoftë se ka qenë dashtë t'i ndihmoj në zgjidhjen e ndonjë
15 problemi. A pastaj, pastaj Ismet Tara nuk është komandant më.

16 PY. [Nuk ka përkthim].

17 PË. Nuk kam qenë i obliguar, edhe në qoftë se kam pranuar
18 dikënd, e kam zgjedhur a ta pranoj apo jo. Nuk kam qenë i
19 obliguar unë të kem takim me këta.

20 PY. Po përpigëm të kuptoj periudhën kohore. Pra, ka qenë deri
21 në momentin, domethënë, gjatë kohës që ke qenë komandant --

22 PË. Po.

23 PY. -- ke pas takime të rregullta me UNMIK-un dhe KFOR-in,
24 pastaj nuk pate më?

25 PË. Jo, të rregullta më, jo.

1 PY. Pastaj nuk ke pasur takime të rregullta?

2 PË. Jo.

3 PY. Z. Tara, se duhet ta kuptoj mirë. Po thua që ke pasur
4 kontakte të rregullta me UNMIK-un dhe me KFOR-in deri në
5 momentin që u largove si komandant i Brigadës 124, kështu?

6 PË. Po. E kam pas detyrë, detyrë e kam pas, ata më kanë thanë
7 që duhet patjetër dhe unë kam qenë, iu kam ofruar atyne për
8 çdo problem të zgjidhet në, sepse është qyteti im, çdo problem
9 që ka ndodhur në qytetin tim ose që ka qenë dasht me u zgjidh,
10 unë kam qenë i interesuar të zgjidhet, dhe kam qenë i obliguar
11 si komandant, mbas largimit të Ismet Tarës si komandant, Ismet
12 Tara nuk ka kurrfarë detyre pastaj. Pse të kërkojnë, pse të
13 kërkojnë prej Ismet Tarës një takim të tillë?

14 Në qoftë se unë kam dëshiruar të takohem me dikënd që e
15 kam njoft gjatë asaj periudhës, ndoshta jam takuar, ama takime
16 zyrtare për informata për kësi sende, Ismet Tara s'ka dhanë ma
17 kurrë. Mbas përfundimit të detyrës time si komandant, se nuk
18 kam pas të drejtë as të jap asnjë, unë ma nuk jam më
19 komandant, unë jam larguar. Nuk jam ai që as përgjigjem për
20 ato, as që jap përgjegjësi dhe as asgjë.

21 PY. Po, e kam të qartë tani. Faleminderit. Gjatë kohës që ke
22 qenë komandant i Brigadës 124, a është e vërtetë që shumë
23 persona vinin të kontaktonin, të pyesnin ku janë personat që
24 janë zhdukur, ku janë kushërinjtë, të afërmit tanë që janë
25 zhdukur?

1 PË. Jo shumë, jo shumë. Jo shumë. Ata që kanë pas probleme që
2 janë të lidhur me mu, kanë qenë. Jo shumë që kanë ardhur
3 persona te unë me më pyetur. Janë do probleme që unë i di që
4 janë të lidhura me mu, ata kanë ardh shpeshherë. A shumë
5 persona që kanë ardhur, Ismet Tara nuk ka qenë aty, Ismet Tara
6 ka qenë, Ismet Tara gjatë luftës ka qenë në Retijë, ka qenë në
7 Pashtrik, dhe nuk di për ngjarjet që kanë ndodhur në Rahovec.

8 PY. Po. Shohim disa nga personat që të kanë kontaktuar.
9 Thashë që kam disa shembuj. Në shënimin përgatitor, në faqen
10 19, paragrafi 106 e më tej, ti flet për familjen Dedic. Ju
11 kërkojmë ndjesë për shqiptimin. Ju kujtohet kjo?

12 PË. Po.

13 PY. Pasi është zhdukur Boban Dedic [Sipas përkthimit], ke
14 takuar prindërit e tij, katër a pesë herë dhe në stacionin e
15 policisë, dhe në rrugë, deri në takimin me KFOR-in, saktë?

16 PË. Kjo është përgjegjësi ime, z. Avokat. Dhe unë duhet të
17 filloj me ngjarjen sepse është përgjegjësia vetëm e imja dhe e
18 Ismet Tarës, a po kupton?

19 PY. Jo, po të pyes --

20 PË. Jo. Unë --

21 PY. Po të pyes a të kujtohet ky rast?

22 PË. Po, qysh nuk po më kujtohet, se rasti ka ndodh me mu.

23 Është përgjegjësi e ime në qoftë se unë jam inkriminuar aty
24 diçka. E imja dhe vetëm e mija, dhe e askujt tjetër, dhe asnjë
25 ushtari të, as timit dhe askujt. Sepse ngjarja ndodhi me mu,

1 z. Avokat. Dhe unë atë ngjarje ia kam përshkruar edhe atëherë
2 në intervistat e mia plotësisht dhe saktësisht dhe i kam
3 informuar çka ka ndodh, si ka ndodh. Dhe këtë ngjarje tash unë
4 po të flas me të gjitha të vërtetat, me 1001 për qind, jo me
5 100 për qind. Po të flas sepse ka ndodh me mu.

6 PY. Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
8 përpiqu t'i përgjigjesh pyetjes që po të bën z. Dixon, nëse ka
9 nevojë për informacione shtesë, të pyet vetë ai.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Por tani është momenti i
11 përshtatshëm që të bëjmë pushimin.

12 DËSHMITARI: Okej.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Do
14 bëjmë gjysmë ore pushim tani, Dëshmitar. Z. Avokat, që ta keni
15 dhe ju parasysht, bëjmë gjithmonë një pushim në orën 11.00 deri
16 në 11.30.

17 Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
20 deri në orën 11.30.

21 --- Pauza fillon në orën 11.00

22 --- Seanca rifillon në orën 11.31

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
24 silleni dëshmitarin në sallë.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më

1 lejoni mund të them diçka ndërkohë që sillet dëshmitari në
2 sallë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
4 vazhdoni.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Dëshiroj që të njoftoj ZPS-në që ne
6 do kërkojmë dokumentin që përmendi dëshmitari në procesverbal.
7 Sepse ai dha një përshkrim të hollësishëm të dokumentit dhe
8 tha që është dokument i brendshëm i ZPS-së dhe që ai e ka parë
9 për herë të parë gjatë seancës përgatitore. Kështu që thjesht
10 dua të njoftoj Prokurorinë që do i bëj kërkesë ZPS-së që të na
11 e japë këtë kopje të këtij dokumenti sa më shpejt të jetë e
12 mundur.

13 Në qoftë se është një dokument i brendshëm që nuk mund të
14 na e japin, duhet të na japin arsye për këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ndoshta
16 nuk ka një dokument të tillë.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po dëshmitari na tha ndryshe.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.
19 E kuptoj këtë. Po ka shumë përgjigje kjo pyetje që i bëtë.
20 Këtë dua të them.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Ne duam që ZPS-ja të na e vërë në
22 dispozicion këtë dokument sa më shpejt të jetë e mundur.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
24 kërkesa apo do bëni një kërkesë tjetër?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Do kërkojmë, do dërgojmë kërkesën

1 përmes postës elektronike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta në
3 qoftë se e bëni pyetjen, mund t'ju përgjigjet Prokuroria tani
4 menjëherë.

5 Nuk është e nevojshme të na jepni përgjigjen, por në
6 qoftë se doni, mund ta jepni, Prokurore.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk ka një dokument të tillë.
8 Dokumenti për të cilin e ka fjalën dëshmitari është deklarata
9 e UNMIK-ut e vitit 2001.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Ai tha që nuk është ajo deklaratë.
11 Është dokument tjetër.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po
13 debatojmë këtu se çfarë tha dëshmitari. Thjesht po diskutojmë
14 në qoftë se ekziston ky dokument apo jo.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Do ta bëjmë këtë kërkesë gjithsesi.
16 Besoj që do jetë një prej përmbledhjeve që është bërë ose
17 ndoshta një lloj vlerësimi që ka bërë Prokuroria.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Bëni kërkesën ashtu siç thatë. Do ju sugjeroja që ta bëni me
20 kërkesë zyrtare me parashtrim të protokolluar jo përmes postës
21 elektronike. Do ishte më mirë kështu. Megjithatë vlerësojeni
22 vetë. Është kërkesa juaj bëjeni sipas mënyrës që e vlerësoni
23 ju më të përshtatshme.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Do bëhet një kërkesë
25 normale dhe ne kërkojmë që t'i kërkohet Prokurorisë në qoftë

1 se ekziston ky dokument apo jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po
3 argumentoj, nuk po debatoj pyetjen që dhatë juve. Por thjesht
4 po them që mund të ketë më shumë sesa një përgjigje pyetja që
5 ju sapo parashtuat. Këtë po them për momentin.

6 Mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, më
10 dëgjoni?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 Z. Dixon do vazhdojë me pyetjet e tjera për ju.

14 Z. Dixon, mund të vazhdoni.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 PY. Z. Tara, unë po ju pyesja lidhur me z. Dedic përpara sesa
17 të bënim pushimin. Në paragrafin 110 të shënimit përgatitor me
18 Prokurorinë ju keni thënë si më poshtë. Do t'jua lexoj dhe
19 pasi ta dëgjoni më thoni ju lutem në qoftë se është e saktë
20 kjo apo jo. Keni thënë se:

21 "... e keni paralajmëruar familjen Dedic që të mos
22 largohet nga lagja serbe dhe më vonë, Dzana dhe Pedi pranoi që
23 djali i saj kishte shkuar në qytet".

24 Më parashtrojmë ju vazhdoni dhe thoni që:

25 "Ju i keni shoqëruar familjen dhe i keni paralajmëruar

1 ata që të mos largoheshin nga lagja serbe. Dhe ndërkohë që
2 Boban kishte shkuar në qytet ishte e pamundur procesverbal
3 juve për të ndihmuar, pasi nuk kishit mundësi që të
4 kontrollonit gjysmën e popullsisë edhe të gjitha fshatrat
5 përreth.”

6 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë ZPS-së dhe a është e
7 saktë kjo që sapo ju lexova, Dëshmitar?

8 PË. Po, z. Avokat.

9 PY. Dëshmitar, kur ju thatë që e kishit të pamundur që të
10 kontrollonit gjysmën e popullatës dhe të gjitha fshatrat, a e
11 kishit fjalët që për ju ishte e pamundur që të kontrollohej
12 çdo gjë që po ndodhte në zonën tuaj? Nuk është kritikë për ju,
13 po thjesht po ju pyes për arsye fakti. Domethënë, çfarë kishit
14 mundësi dhe çfarë nuk kishit për të bërë gjatë asaj kohe?

15 PY. Unë as nuk e kam pas obligim, as detyrë, po as mundësi ta
16 kontrolloj popullsinë që ka qenë banore e qytetit tim gati që
17 dhe gjysma e fshatrave në Rahovec. Po as ka qenë përgjegjësi
18 unë ta kontrolloj. Përgjegjësia nuk ka qenë e imja që unë të
19 kontrolloj as qytetin, as kërrkënd, po unë nuk kam pas
20 mundësi.

21 PY. Po, e kuptoj. Z. Tara, tani do t'ju pyes lidhur me një
22 person tjetër që quhet Marko Jelic. Prokuroria ju ka pyetur
23 edhe lidhur me këtë person gjatë intervistës me të. Është e
24 saktë, apo jo, Dëshmitar, se nëna e tij ka raportuar
25 arrestimin e pretenduar të djalit të saj, të Markos?

1 Domethënë, që ajo ka ardhur te ju për t'ju thënë që djalin e
2 kishin arrestuar, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Jo që ajo ka ardhur. Ka ardhur një zyrtar, i kujt ka
4 qenë, unë edhe sot e kësaj dite nuk e di. Ai ka pyetur pesë,
5 gjashtë herë, sa kam qenë komandant për këtë person, Markon.

6 PY. Ju keni pyetur lidhur me këtë çështje dhe jeni përpjekur
7 që ta ndihmoni familjen, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Po. Po, z. Avokat.

9 PY. Dua t'ju pyes lidhur me këtë aspektin, problemin e z.
10 Dedic dhe të z. Jelic më pas. Këto raste a i keni përmendur më
11 pas ju? Domethënë, a i keni diskutuar në vitin 2000 apo në
12 vitin 2001, domethënë, pasi u larguat si komandant brigade në
13 fund të vitit 1999.?

14 PË. Kurrë.

15 PY. Këto incidente apo këto raste ai keni përmendur më pas?

16 PË. Kurrë. Kurrë jo.

17 PY. A mund të ketë ndodhur që mbase njerëz ju kanë pyetur
18 lidhur me këto dy raste më vonë, për shembull, gazetarë dhe a
19 mund të ketë ndodhur që mbasi keni diskutuar sesi jeni
20 përpjekur që t'ju ndihmonit ata ju?

21 PË. Jo.

22 PY. Në rregull.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretarit që të
24 paraqesë në ekran një dokument. Dokumenti është SPOE00144632.
25 Do i kërkoja Sekretarit që versionit në anglisht ta paraqesë

1 në të djathtë të ekranit. Ndërkohë që në majtë kërkoj që të
2 paraqitet dokumenti në shqip, që ka numrin e identifikimit
3 083094 deri në 083196, ndërkohë faqja e parë që i kërkoj
4 Sekretarit të paraqesë në ekran është 083110. Domethënë, kjo
5 faqja e fundit do të duhet që të paraqitet në të majtë të
6 ekranit.

7 PY. Përpara sesa të shohim këtë dokumentin në ekran, për
8 kontekst, më lejoni t'ju them z. Tara që ky është një dokument
9 që pretendohet që të jetë përgatitur nga UNMIK-u, është në
10 anglisht dhe është dokument i vitit 2001. Dhe përveç këtij
11 dokumenti është edhe dokumenti në shqip, domethënë, që është
12 në të majtë të ekranit dhe ka disa kryqe. Do ju pyes lidhur me
13 këto dy dokumentet në momentin që këto të paraqiten në ekran.
14 Ju lutem, shikojini.

15 PË. Çoje dokumentin deri në fund.

16 PY. Po. Z. Tara, do kemi mundësi që t'i shohim të gjitha këto
17 dokumente, domethënë, mos kini problem. Do e ngremë sipërfaqen
18 e do i ulim deri në fund. Megjithatë më dëgjoni me vëmendje
19 pyetjen, le të kalojmë hap pas hapi.

20 Së pari, dokumenti në të majtën tuaj. Ky është një
21 dokument që ua kanë treguar në intervistën me ZPS-në më 2019,
22 a është e saktë që ju i keni vendosur këto kryqet në tekst për
23 të treguar që këto pjesë të dokumentit që keni përpara janë
24 pjesë me të cilat ju nuk pajtoheni, a është e saktë kjo? Mund
25 t'i kalojmë të gjitha faqet njëra pas tjetrës. Është disa faqe

1 dokumenti në total.

2 PË. Ki dokument nuk është fare i imi që unë jam takuar me
3 këtë Anna Vannozzi asnjëherë. Asnjëherë.

4 PY. Z. Tara, e kuptoj dëshminë tuaj lidhur me këtë.

5 Megjithatë, më duhet t'ju bëj disa pyetje, kështu që do bëj
6 dhe disa pyetje të tjera lidhur me këtë tekst. Ju lutem
7 dëgjoni pyetjet. Pyetja e parë që dua të sqaroj me ju është
8 kjo: Dokumenti në të majtë është dokumenti që ua ka treguar
9 Prokuroria dhe këto kryqet i keni vendosur ju, apo jo? Dhe
10 këto kryqe i keni vendosë për të treguar që këto pjesë të
11 dokumentit nuk janë të sakta dhe nuk janë të thëna prej jush,
12 a është kështu, Dëshmitar?

13 PË. Nuk janë të sakta fare. Hiç. Po unë po ju tregoj që ky
14 dokument është përshkruar nga dikush i panjohur, pa u takuar
15 kurrë me mua. Kurrë me mua. Se përndryshe kish pas nënshkrimin
16 tim. Unë nuk lëshoj dokumente pa nënshkrim. Edhe nuk jam unë
17 Ismet Tara në këtë kohë që ajo të drejtohet te Ismet Tara për
18 këtë, për këtë problem. Po kupton? Ky është trillim njësoj
19 sikurse dokumenti që ka humbur Prokurorja. Një dokument i
20 atillë.

21 Po unë për këtë dokument kam qenë i njoftuar në 2019. Dhe
22 unë e kam hudhur poshtë si mundësi që ajo kur më është
23 treguar, Anna Vannozzi, kam thënë kurrë, kurrë, kurrë. Dhe nuk
24 kam çka të diskutoj edhe sepse ky është dokument i përshkruar
25 si mbas dëshirës së kësaj Anna Vannozzi. Dhe nuk kam, nuk kam

1 unë kurrfarë njohurie. Unë e kam kontestuar fare këtë
2 dokument. Nuk është i vlefshëm për mu. Dhe ky dokument për mu
3 nuk paraqet kurrgjë. Ky është dokument trillimi. Kush e ka
4 bërë nuk e di.

5 PY. Z. Tara, ia u kam thënë disa herë gjatë ditës sot që do
6 ju kërkoja, ju lutem, t'i përgjigjeni pyetjes që ju bëj unë. E
7 kuptojmë të gjithë shumë qartë lidhur me atë çfarë thoni ju
8 lidhur me këtë dokument. Megjithatë, ajo çfarë dua që të
9 sqaroni është që dokumenti që shikoni në të majtë të ekranit
10 ju është treguar nga Prokurori.

11 PË. Po.

12 PY. Dhe se këto kryqet i keni shënuar ju, nuk po them që
13 është dokumenti i jot, po them që ky dokument ju është treguar
14 nga Prokuroria dhe këto kryqet i keni vendosë ju. Këtë po ju
15 pyes?

16 PË. Ata një qind herë kanë tentuar që unë ta pranoj këtë
17 dokument. "A është e mundshme kjo, a është e mundshme kjo?"
18 Unë i kam thënë që "Nuk është e mundshme asgjë" dhe vetë ia
19 kam fut vizë, X, X, X. Nuk vlen ky dokument për mu, z. Avokat.
20 Se nuk është i imi. Nuk kam çka të përgjigjem. Nuk di asgjë
21 rreth saj. Të gjitha që do të pyetni unë nuk di. Ky është një
22 dokument i përshkruar njëjtë, njësoj sikurse dokumentin që ma
23 ka humbur Prokurorja.

24 Unë nuk di lidhje me kët dhe nuk kam dhënë unë asnjë
25 dëshmi atëherë në lidhje me këtë Anna Vannozzi. Unë nuk çka

1 mund të përgjigjem rreth saj? Nuk kam -- unë e kam kontestuar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që e
3 morët përgjigjen z. Dixon?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Ndërmjet fjalësh është përgjigja
5 aty.

6 PY. Z. Tara, thjesht doja të konfirmoja që ju i keni vendosë
7 këto X ose kryqet, i keni vendosë vetë aty.

8 PË. Po.

9 PY. Tani a mund t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë dokument.

10 PË. Po. Po. Të gjitha mundesh.

11 PY. Ky është një dokument ku pretendohet se është bërë një
12 takim i juaji në një restorant.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe ndërkohë, të nderuar Gjykatës,
14 versioni i mëtejshëm i redaktuar duhet të plotësohet në qoftë
15 se pranohet si provë gjyqësore.

16 PY. Dhe pretendohet që ky takim i të ketë ndodhur rreth 1
17 kilometër përpara sesa, pra, këtu thuhet që është bërë ky
18 takim, pra, që ka pasur një takim në Bellacërkë në këtë
19 lokal. A e dini ju se ku është se ku është ky restoranti, z.
20 Tara?

21 PË. As nuk e di ku është restoranti. Për të cilin restorant
22 flet. As nuk e di, as nuk di për cilin restorant flet.

23 PY. Në këtë dokument pretendohet që ky takim është zhvilluar
24 më datën 24 janar 2001. Domethënë, kjo ka qenë një periudhë
25 kur ju nuk keni qenë më komandant brigade. Dhe thuhet

1 gjithashtu se në takim kam marrë pjesë tre persona, pra,
2 Rusten Azi - siç e thotë - znj. Vannozzi, që ju e përmendët
3 thuhet gjithashtu që ka marrë pjesë edhe Peçi dhe dikush
4 tjetër. A ju kujtohet që mbase këta persona ju i keni takuar
5 në janar të vitit 2001 në këtë restorant rrugës për në
6 Bellacërkë?

7 PË. Jo, jo, jo.

8 PY. Ju e keni thënë edhe në dëshminë që dhatë dje, që kjo
9 është një deklaratë e cila mbase e ka si origjinë një gazetar,
10 mbase është shkruar nga një gazetar. A ju kujtohet kjo,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po, e kam thënë se edhe dyshoj edhe sot e kësaj dite që
13 ajo ka qenë ndonjë gazetare e cila i ka marrë shënimet,
14 njohuritë, ka shkuar në lagjet serbe dhe ka kërkuar diçka dhe
15 ata i kanë thënë qëto edhe ai i ka përshkruar atje. Ama kurrë
16 takim me mu s'ka pas. Kurrë. As ajo, as kërrkush. Ajo në qoftë
17 se këta e dinë, me siguri që kanë paraqitur dokumentin, le të
18 ma bin personin qetu. Le të dëshmon ajo, le të jep fakte që
19 unë kam qenë aty.

20 PY. Po, kjo është një çështje tjetër. Ne nuk e kemi dëgjuar
21 atë. Por ajo çfarë po të pyes ty unë është që tije nën betim
22 dhe duhet të thuash të vërtetën, por po të pyes që a është e
23 mundur që të jesh takuar me gazetarë në këtë periudhë, gjatë
24 kësaj periudhe pa e ditur që ishin persona të UNMIK-ut dhe ti
25 të kesh menduar që ke folur me gazetarët ndërkohë që ke qenë

1 duke folur me dikë tjetër?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtojmë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Po e pyes.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po çdo gjë
6 është e mundur. Ti po e pyet a është e mundur. Kështu që bëje
7 ndryshe pyetjen.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po e pyes, po i them dëshmitarit
9 që a është takuar me gazetarë dhe a është e mundur që ai të
10 jetë takuar gjatë kësaj periudhe me gazetarët.

11 PY. Z. Tara, e dëgjuat bisedën?

12 PË. Jo, jo, jo.

13 PY. Atëherë prit dhe një herë sa të bëj pyetjen. Ajo çfarë po
14 të them unë është që ju keni folur me gazetarët --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
16 pyetje kjo. Duhet ta pyesësh së pari a je takuar me gazetarë,
17 së pari duhet të bësh këtë pyetje pastaj të vazhdosh më tej.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk mu lejua që të bëja pyetjen?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A jeni takuar
20 me gazetarë gjatë asaj periudhe, Dëshmitar?

21 DËSHMITARI: Jo, z. Gjykatës.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

23 PY. Atëherë në qoftë se më lejoni dua që të vazhdoj më tej që
24 të vazhdojë me atë çfarë ka në dokument, çfarë është e
25 regjistruar këtu në këtë dokument. Sepse pavarësisht në qoftë

1 se ju pëlqen ose jo, z. Tara ka një lloj procesverbali --

2 PË. Nuk është -- nuk është problem.

3 PY. -- të këtij takimi. Këtu thuhet dhe mund të shikojmë të
4 dyja versionet në anglisht dhe në shqip, pra, këtu thuhet që
5 ju keni qenë "komandant i Brigadës 124 të UÇK-së nga fundi i
6 majit të 1998 deri në fund të luftës në qershor të 1999".

7 Kjo është e gabuar, apo jo, sepse ju jeni caktuar si
8 komandant brigade në qershor të 1999, nuk është se jeni
9 larguar në këtë periudhë si komandant brigade, apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Unë po ju tregoj që unë nuk kam dëshirë sepse kjo as me
12 kurrfarë njohurie e përshkruan këtë dokument. Jo, nuk është.
13 Nuk jam takuar. Unë nuk kam qenë në maj. Unë kam qenë pas
14 çlirimit për herë të parë komandant i brigadës, për herë të
15 parë mbas çlirimit të Kosovës.

16 PY. Z. Tara, më duhet të theksoj dhe një herë. Nuk po i
17 kthehem bisedës në qoftë se është zhvilluar takimi apo jo. Se
18 këtë e dëgjua si përgjigje. Por dua që të përqendrohemi tek
19 ajo se çfarë thuhet në këtë dokument dhe të më thoni në qoftë
20 se ky informacion është i saktë apo jo, me aq sa dini ju. Do
21 kalojmë disa pika të këtij dokumenti për të sqaruar në qoftë
22 se informacioni është i saktë ose jo mbështetur në atë çfarë
23 keni ditur ju në atë kohë. Thjesht dëgjoni pyetjen dhe
24 përgjigjuni.

25 Nuk është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që ju keni qenë

1 komandant i brigadës nga maji i 1998 deri në qershor të 1999?

2 Ky si fakt si fakt është i gabuar, apo jo?

3 PË. Jo, i gabuar, po i trilluar, rrenë. Se i gabuar është

4 diçka tjetër por rrenë është. Se nuk kam qenë.

5 PY. Do ju kërkoja që të mos bënit komente lidhur me pyetjet e

6 mia. Thjesht jepni përgjigje lidhur me pyetjen që ju bëj. Së

7 dyti, këtu thuhet që ju keni qenë përgjegjës për 280 ushtarë

8 dhe kjo ka ndodhur deri tek ofensiva e parë të 1998. Edhe ky

9 si informacion është i gabuar, apo jo? Se ti nuk ke qenë

10 përgjegjës për 280 ushtarë, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Rrenë është. Jo i gabuar.

12 PY. Më pas thuhet që ju keni pas kontroll të plotë për

13 ushtarët tuaj. As kjo nuk është e saktë? Se ti nuk ke pas

14 kontroll absolut mbi të gjithë njerëzit në njësitet tuaj?

15 PË. Asnjëherë.

16 PY. Më tej vazhdohet me pretendime të ndryshme duke përfshirë

17 këtu edhe nënshkrimin e një marrëveshjeje me serbët nën

18 mbikëqyrjen e OSBE-së.

19 "Ai tha që sipas marrëveshjes, UÇK-ja kishte disa zona ku

20 mund të lëviznin lirisht. Më vonë situata kishte dalë jashtë

21 kontrollit. Ai tha se Walter Fleisher i OSBE-së u informua për

22 marrëveshjen."

23 A është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

24 PË. Jo, taman i saktë. Walter Fleisher e ka organizuar këtë

25 takim. E ka organizuar këtë takim. Walter Fleisher e ka

1 organizuar këtë takim.

2 PY. Pra, një pjesë e këtij informacioni është e saktë, këtë
3 po thoni, Dëshmitar?

4 PË. Po, që ai e ka organizuar dhe takimi është mbajtur në
5 zyrë të OSBE-së. Dhe ato janë prova që mund të lipen.

6 PY. Diku tjetër, më duhet të gjej faqen ekzakte dhe pjesën
7 ekzakte në shqip. Po në të njëjtin tekst thuhet që juve ju
8 kërkua që të kujtoni disa emra të rasteve ose të incidenteve
9 të personave të vrarë. Më tej në tekst thuhej që juve ju
10 kujtoheshin [REDAKTUAR]
11 [REDAKTUAR].

12 Z. DIXON: [Përkthim] Besoj që duhet të jetë në faqen
13 tjetër të versionit të tekstit në shqip, në mënyrë të tillë që
14 të mund të më ndiqni me tekst.

15 DËSHMITARI: Nuk janë këta emra. Kërrkund nuk i shoh unë.

16 Z. DIXON: [Përkthim]

17 PY. Te paragrafi i dytë, Dëshmitar, duke filluar nga fillimi
18 paragrafi i dytë. A keni pasur dijeni lidhur me këta persona
19 që janë zhdukur?

20 PË. Kurrë, hiç.

21 PY. Këtu përmendët më poshtë edhe ky rasti të cilin e cekëm
22 dhe më herët, që ka të bëjë me z. Dedic. E shihni këtë,
23 Dëshmitar? Drejt fundit të faqes në shqip.

24 PË. Okej. Po. Kjo po.

25 PY. A e shikoni?

1 PË. Po.

2 PY. Se thotë aty që:

3 "Tara kujtoj edhe ditën kur ka ndihmuar familjen Dedic."

4 PË. Po. Po, e shoh. Duhet ta lexoj krejt apo vetëm aq?

5 PY. Jo, nuk është e nevojshme.

6 PË. Okej.

7 PY. Lexoje me vete, lexoje me mend. Dua t'ju pyes që a është
8 ky një përshkrim i saktë i asaj çfarë i ka ndodhur z. Dedic?

9 PË. Nuk është i saktë. Sepse as ai vetë nuk e njeh dhe po
10 shkruan "Gruaja e Dedic -- e Boban" thotë këtu. Nuk e ka
11 përshkruar qartë.

12 PY. Megjithatë një pjesë e këtij informacioni është e saktë,
13 apo jo, Dëshmitar, sepse ju thatë që ju kujtohej dita kur e
14 keni ndihmuar familjen Dedic, apo jo?

15 PË. Po, po. Ngjarja është e saktë, ka ndodhë, ama jo qysh e
16 ka përshkruar këtu, sepse ai nuk ka qenë i informuar vetëm ia
17 ka fut qashtu.

18 PY. Tani që i trajtuam rastet konkrete, këtu thuhet më tej
19 që:

20 "Tara tha që pasi më vonë është futur në Rahovec, situata
21 ishte tërësisht kaotike. Ata që ishin larguar u kthyen në
22 shtëpi, ndërkohë që shumë krime janë kryer për hakmarrje.
23 Ishte gati e pamundur që situata të mbahej nën kontroll
24 sidomos për KFOR-in, i cili nuk kishte njohuri të mjaftueshme
25 për vendin."

1 PË. Nuk është e saktë që e kam thënë unë.

2 PY. A është e saktë kjo?

3 PË. Jo, nuk është e saktë që e kam thënë unë. Janë --

4 PY. Jo, nuk po them që s'e keni thënë apo jo, jua kam shpjegu
5 disa herë këtë gjë. Nuk po them a është e saktë, a e keni
6 thënë ju apo jo. Por po ju pyes në qoftë se kjo që jepet në
7 këtë paragraf është vlerësim real i situatës atëherë?

8 PË. Jo. Sepse nuk ka ndodhur krime të atilla si përshkruhen
9 këtu.

10 PY. Edhe një herë nuk po ju pyes lidhur me krimet. Por po ju
11 pyes në qoftë se është e saktë apo jo që kur njerëzit janë
12 kthyer në shtëpitë e tyre ishin bërë shumë krime për
13 hakmarrje? Nuk po flasim për krime konkrete por po flasim në
14 përgjithësi në qoftë se ka pasur krime të kryera për shkak
15 hakmarrjeje. Kjo në vetvete a është e saktë, Dëshmitar?

16 PË. Jo.

17 PY. Më herët thatë se në zonën tuaj kishte kaos. A është e
18 saktë që sikurse përshkruhet në këtë dokument në këtë pjesë të
19 dokumentit që "situata ka qenë kaotike" në atë periudhë?

20 PË. Kaos do të thotë diçka tjetër. A ardhja e qytetarëve dhe
21 gushve [Fonetikisht] a tjetër, është diçka tjetër. Ardhja e
22 qytetarëve nëpër shtëpitë e veta, ardhja e fshatarëve në
23 Rahovec sepse nuk kanë pas ku të banojnë është diçka tjetër. A
24 kaos, nuk ka pas kaos. Kaos është diçka kur çdo kush vret
25 dikën ose bën diçka për mua. Po jo, kjo nuk është kaos. Kjo

1 është rikthim i popullatës sime në qytetin tim dhe rikthimi i
2 shumë fshatarëve të cilët janë kthyer në qytetin tim se nuk
3 kanë pas ku të banojnë sepse pjesë të mëdhaja të fshatrave
4 kanë qenë të dëmtuara dhe ata kanë qenë dashtë të vijnë në
5 Rahovec të banojnë. Në qoftë se kështu kaos, kaos. Unë nuk di
6 si ta përshkruaj kaosin.

7 Kaos është kur ndodhë diçka e jashtëzakonshme, diçka e
8 rrezikshme, ama ardhja e fshatarëve në Rahovec nuk ka paraqit
9 kaos. Janë pranuar si familjet e veta. Disa kanë shkuar nëpër
10 shtëpitë e serbëve dikan. Disa kanë shkuar i kanë zënë dhe
11 banesat e serbëve nëpër qendër që i kanë liruar që kanë ikur
12 në lagjen serbe. Unë nuk e konsideroj atë kaos.

13 PY. Në rregull. Pak më herët ju u pajtuat me mua, z. Tara, se
14 kur njerëzit u kthyen ishin të zemëruar dhe se çdo gjë mund të
15 ndodhte për shkak të situatës që ishin. Kjo është e saktë, apo
16 jo, z. Tara?

17 PË. Që mund të ndodhte po, ama të ndodhë kaosi nuk ka ndodhë.
18 Mund të ndodhte? Po. Ama që ka ndodhë kaosi atëherë, atëherë
19 KFOR-i ka qenë aty. Atëherë kanë qenë të gjithë aty. Ky qenë
20 UNMIK-u aty. Ka qenë Ismet Tara aty. Atëherë ish parë ajo ish
21 bë alarmante. Ndoshta kishin kërkuar forca shtesë prej KFOR-
22 it, UNMIK-ut që të vijnë ta largojnë këtë problem. Po ajo nuk
23 ka ndodhur. Po ajo është përshkrimi i saj, qysh ka dashtë ajo
24 kush -- i këtij dokumenti qysh ka dashtë ajo. Qysh ka dashtë
25 ai ose ajo. Nuk di unë tash të gjitha që mundohesh ti, unë nuk

1 i kam përgjigjet e sakta. Sepse nuk janë këto.

2 Ti po flet tash "a janë të mundshme". Unë, nuk mund t'i
3 parashikoj a kanë qenë të mundshme. Po këto që si i përshkruan
4 ti nuk kanë ndodhur, z. Avokat. Kaos për mu nuk ka ndodhur.
5 S'di kush. Se të kish ndodhë kaos aty përgjegjës kanë qenë
6 KFOR-i, përgjegjës ka qenë UNMIK-u. Dhe ne ndoshta na kishin
7 ftuar në qoftë se kish ndodhë kaos të ndërhyjmë edhe na t'i
8 ndihmojmë.

9 Po që ka pas shumë popull, jashtëzakonisht, ma shumë sesa
10 qyteti ka përballuar, ajo po. A kaos, unë kuptoj kaos kur
11 ndodhë diçka shumë e rrezikshme aty, jashtë normales. Që kanë
12 ardh nëpër shtëpitë brenda qytetit që kanë qenë të serbëve, që
13 kanë ardh te shqiptarët, që kanë ardh edhe nëpër familjet tona
14 për të gjitha familjet shqiptare ku i kemi pritur sikurse ata
15 që na kanë pritur neve, ajo nuk është kaos për mua.

16 PY. Nuk dua të hyj në debat me përkufizimin e termit kaos. Po
17 unë po ju them këtë, në atë kohë, në një situatë që po
18 ktheheshin shumë njerëz të frustruar, të lodhur, ekzistonte
19 rreziku që do të kishte raste hakmarrjeje, apo jo?

20 PË. A ka ekzistuar rreziku? Ka ekzistue. Mirëpo, të kish
21 ndodhë rreziku, ishim të informuar prej KFOR-it na, ishim të
22 informuar prej UNMIK-ut, prej OSBE-së.

23 PY. Po. KFOR-i dhe UNMIK-u ishin atje, kemi dëgjuar dhe nga
24 dëshmitarë të tjerë, ishin atje për të parandaluar rastet e
25 hakmarrjes, apo jo, që t'i parandalonin raste të tilla, apo

1 jo?

2 PË. Po, kanë qenë për t'i parandaluar, po ato raste nuk janë,
3 nuk janë, nuk kanë ndodhur ashtu. Ata kanë qenë. Unë në
4 bashkëpunim me KFOR-in i kam -- unë vetë i kam treguar ku të
5 vendosen pikat e KFOR-it nëpër lagje ku ndahen lagjet e
6 shqiptarëve prej serbëve. Dhe më kanë dëgjuar dhe i kanë
7 vendosur dhe ato valonin në ato pika ku kanë qenë më të
8 arsyeshme ku kanë mund të depërtojnë prej lagjes shqiptare në
9 lagjen serbe. Po ai kaos nuk ka ndodhur. Sepse të kish ndodhë
10 diçka me siguri që kish ardhë të më njoftoi me siguri. Se kemi
11 pas takime, qindra takime me të. Për çdo problem është
12 diskutuar.

13 A ka ekzistuar mundësia? Ka ekzistuar mundësia.

14 PY. Ka qenë më shumë se mundësi. E diskutuam rastin e z.
15 Dedic dhe Jelic që ka pasur probleme, ka pas probleme në atë
16 kohë. Ti po thua që je përpjekur të ndihmosh. Dhe unë e
17 vlerësoj, e kuptoj këtë. Por ama ka pasur probleme. Nuk mund
18 të thuash tani që ka qenë një mjedis i sigurtë apo i qetë?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj pyetjen.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ia keni bërë
21 pyetjen, e keni marrë përgjigjen. Tani po thjesht po
22 argumentoni me dëshmitarin.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Po jo, po dëshmitari po thotë s'ka
24 pasur probleme. Unë po them që ka pasur probleme në atë kohë.

25 DËSHMITARI: Po unë, unë --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tha që nuk ka
2 pasur kaos.

3 DËSHMITARI: Unë dëshiroj t'i përgjigjem. Në qoftë se më
4 lejoni, unë dëshiroj t'i përgjigjem.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigju.
6 Përgjigju. Përgjigju, jo shumë gjatë.

7 DËSHMITARI: Edhe për këto edhe për këto akcese që ti i
8 përmend, kanë qenë të njoftuar edhe KFOR-i edhe UNMIK-u edhe
9 OSBE-ja, domethënë, edhe ata janë lajmëruar, jo vetëm unë.
10 Kanë ndodhë probleme me mu që kanë ardhë njerëz, po unë i kam
11 njoftuar ata për këto probleme. Edhe ata më kishin njoftue që
12 në qoftë se ka ndodhë ndonjë problem diku, më kishin ardhë më
13 së pari mu me më pyet. Po nuk kanë ardhë ata. As KFOR-i, as
14 OSBE-ja, as UNMIK-u nuk kanë ardhë te unë të kërkojnë sqarim
15 pse kjo ka ndodhë qështu. Sikurse të kish ndodhë, ata do të
16 ishin takuar me mua 100 për qind. Dhe e kishim diskutuar atë
17 problem atëherë. Dhe unë do të kisha qenë i njoftuar. Po ata
18 kurrë nuk më kanë thirrur për këtë. Dhe po të them që edhe
19 probleme shumë më të imta kanë komunikuar me mua. Ama këto
20 kanë ndodhur dhe në këto raste unë i kam informuar edhe UNMIK-
21 un edhe KFOR-in edhe OSBE-në.

22 Sepse kanë ndodhur, këto janë që kanë ndodhur. A të
23 kishin ndodhur tjerë, unë do ta kisha kuptuar sepse do të
24 ishin afruar prapë KFOR-i, OSBE-ja me më kontakuar, me më
25 pyetur mos din diçka lidhur me këtë problem, po unë nuk kam

1 qenë i pyetur asnjëherë në kësi. Tash ti mund të pyesësh sa
2 duash, unë jam në gjendje që t'i kthej përgjigje por po më
3 duket që kjo është humbje kohe. Ku e ke qëllimin nuk e di, po
4 kjo për mua është humbje kohe. Unë do të përgjigjem të gjitha
5 pyetjeve. Ama këto si unë i di.

6 Dhe ato që kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme, ato janë
7 diskutuar mes meje, KFOR-it, UNMIK-ut edhe OSBE-së zyrtarëve.
8 A jo këtë dokument që dikush qysh ka dashtë ta gjuajt aty, unë
9 nuk e di.

10 PY. Po. Z. Tara, unë po përpiqem të flasim për disa gjëra që
11 thuhën në këtë dokument. Ti thua që janë të sakta, kanë
12 ndodhur këto. Jo se je intervistuar, por dokumenti përmban
13 disa pretendime të sakta, apo jo?

14 PË. Jo, jo. pretendimet e sakta janë vetëm ato që m'i ke
15 përmend me emra, Dedic dhe atë Markon. Jo për ato tjerat që
16 kanë qenë të mundshme. Sikurse të kishin qenë ndodhur, unë po
17 të tregoj që unë do të kisha qenë informuar edhe prej UNMIK-
18 ut, edhe prej KFOR-it, edhe prej OSBE-së. Dhe do të ish
19 kërkuar ndihma ime të merrem edhe unë me atë problem, po nuk
20 jam marrë. Edhe unë nuk e di që kanë ndodhur. A ka ndodhur?
21 Prapë nuk e di. Prapë nuk e di. Nuk mund të them që nuk ka
22 ndodhur, po unë nuk kam qenë i informuar. Thjesht. As nga
23 UNMIK-u, as nga KFOR-i, as nga OSBE-ja, sepse unë kam pas
24 bashkëpunim të mirë me ta.

25 PY. Po. Na e shpjegove këtë. Po unë dua, për shembull, të jap

1 një shembull tjetër. Në këtë dokument thuhet, nuk po them që
2 je intervistuar, e lëmë mënjanë këtë, por në dokument thuhet
3 që ti ke thënë që personat që janë përgjegjës për krimet
4 kundër civilëve --
5 PË. Unë nuk kam thënë.
6 PY. -- duhen dënuar --
7 PY. Dhe nuk dëshiroj që --
8 PY. Po ti e beson --
9 PË. -- të përgjigjem më kësaj.
10 PY. Po ti e beson këtë apo jo?
11 PË. A besoj unë a nuk e besoj, unë nuk mund ta vërtetoj
12 saktësinë. Unë mund të flas sa duash më ty. Po unë nuk mund
13 asgjë të saktë të them. A po kupton? A jam i qartë a nuk jam i
14 qartë? Se nuk janë fjalën e mia këto. Është një dokument i
15 krejt dikujt të panjohuri i cili nuk ia don popullit tim të
16 mirën. Është një armik i popullit tim. Është një bashkëpunëtor
17 i Serbisë, i serbëve. Dhe këtë dokument kurrë nuk i kam
18 diskutuar. Po unë po të them a ka mujt? Unë tash, a don tash
19 ta marrë unë përsipër a ka mujt, ta mendësoj unë a ka mujt a
20 s'ka mujt. Nuk jam në gjendje ta mendësoj. Unë mund
21 përfaqësisht ta them përgjigjen çka unë mendoj. Por unë po të
22 tregoj që çdo rast i zhdukjes së njerëzve, unë kisha qenë i
23 informuar me OSBE-në, me KFOR-in edhe me UNMIK-un, më kishin
24 informuar të kishin ndodhë këto. A ka mujt tash? Unë nuk e di,
25 z. Avokat. Unë vetëm jap përgjigje kështu mendimet e mia të

1 lira.

2 PY. Jo, jo, z. Tara. Z. Tara, më dëgjo, të lutem, ma dëgjo
3 pyetjen. A është pikëpamja juaj, mendimi juaj që personat
4 përgjegjës për krimet kundër civilëve duhet të ndëshkohen, a
5 është kjo pikëpamja juaj?

6 PË. Me siguri që po. Çdo krim duhet ndëshkohet. Me siguri që
7 po.

8 PY. Po.

9 PË. Se unë për këta kisha folur shumë çlirët. Unë po flas për
10 ndodhinë që ka ndodhë me mu haptaz, po i tregoj qysh ka
11 ndodhur, jo për ndodhitë që unë nuk kam lidhje. Unë nuk
12 dëshiroj të flasë tash a ka mundur, a ka ndodhur, a s'ka
13 ndodhur. Nuk e di ku e ke qëllimin, nuk e di. Po këto nuk janë
14 shënimet e mia, nuk janë deklaratat e mia. Ju tregova, unë
15 prapë do t'i jap përgjigjet, ama përgjigjet e mia janë vetëm
16 mendimet e mia të lira. A ka mundur? Po prapë janë dyshimet që
17 sikurse të kishin ndodhur unë do të isha informuar me
18 bashkëpunëtorët që kemi bashkëpunuar.

19 PY. Z. Tara, iu përgjigje pyetjes në fakt. Një pyetje e
20 thjeshtë ishte. Po, që dhe ju besoni se duhen ndëshkuar.

21 Do t'ju bëj disa pyetje të tjera të ngjashme dhe të më
22 jepni mendimin tuaj asgjë më shumë. Nuk po ju sugjeroj unë
23 asgjë.

24 PË. Okej. Mendimin tim --

25 PY. Unë thjesht dua të më jepni mendimin tuaj.

1 PË. Mendimet e mia unë do t'i jap, ama nuk janë të sakta në
2 qoftë se janë për raste të caktume që unë nuk i di.

3 PY. Në rregull. Keni ndonjë dijeni lidhur me zhdukjen e pesë
4 serbëve në zonën e Rahovecit?

5 PË. Jo.

6 PY. Përafërsisht në këtë periudhë kohore, qershor, korrik
7 1999? Keni apo s'keni dijeni?

8 PË. Jo. Jo.

9 PY. Në lidhje me personat që vinin për të biseduar me ty për
10 të afërmit që u ishin zhdukur, me përafërsi, sa herë ka
11 ndodhur kjo, sa herë të kujtohet të ketë ndodhur kjo?

12 PË. Unë ju kam thënë dhe prapë po ju them, përveç me familjen
13 Dedic e cila ka kontaktuar pesë, gjashtë herë me mua dhe me
14 këtë të UNMIK-ut i cili në fund e kam detyruar të ma bijnë
15 nënën e tij, Aishen, të ma bijë në prezencë time në komandën
16 time dhe pastaj aty i kemi sqaruar, kemi diskutue gjerë e
17 gjatë. Me të tjerët kërrkush nuk kanë ardh te unë.

18 Mund, z. Avokat, a ndoshta dhe shumica nuk kanë dashtur
19 të vijnë dhe te na, te UÇK-ja. Ndoshta kanë shkuar, ndoshta
20 kanë shkuar të japin deklarata, informata në UNMIK, në KFOR
21 ose në OSBE se nuk ka qenë bash e lehtë të vijnë ata -- okej.

22 PY. Desha të pyesja sa persona kanë ardhur të kanë kontaktuar
23 për këtë gjë?

24 PË. Vetëm qëta që janë rastet e mia që kam cekur. Asnjë
25 tjetër jo. Asnjë tjetër jo.

- 1 PY. Në rregull. Ky emri që përmendët në dokument Tasim
2 Halimi, e sheh, e sheh në krye? Ky Tasim Halimi është një
3 person që e njihje ti?
4 PË. Jo.
5 PY. Tek faqja 1 është kjo në fakt.
6 PË. Jo, jo.
7 PY. Jo tek kjo faqe.
8 PË. Emri vetë, s'ka nevojë me lexu, emri jo, emri po më
9 tregon që unë nuk e kam njoftun kurrë.
10 PY. Në rregull. Shkojmë më poshtë. Këtu ke thënë në faqen 1
11 më duket të shqipes:
12 "Pasi --
13 Nuk e keni thënë ju, po thuhet këtu, që ta sqarojmë.
14 Thuhet në tekst --
15 PË. Atëherë mos më pyet.
16 PY. Se dua ta bëj të qartë.
17 PË. Atëherë mos më pyet, z. Avokat, mos më lodh sepse po
18 humbim kohë pa kurrfarë arritje të qëllimit.
19 PY. Z. Tara --
20 PË. Urdhno.
21 PY. Z. Tara, më duhet t'ju bëj disa pyetje të tjera.
22 PË. Urdhnoni, nuk është problem.
23 PY. Dhe kam nevojë që t'ju përgjigjesh. E kupton?
24 PË. Po. Por në qoftë se di.
25 PY. Këtu thuhet, në tekst thuhet. Mund ta lexosh dhe ti:

1 "Pasi që serbët rifituan pozitat strategjike" --

2 PY. Nuk i keni as -- nuk i keni as pikat. Nuk i keni asgjë
3 tash. Unë nuk di ku të lexoj, z. Avokat.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ta
5 fika mikrofonin se po ndërprisni, po flisni njëkohësisht dhe
6 po ndërprisni avokatin. Lëre avokatin ta bëjë pyetjen pastaj
7 përgjigju.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

9 PY. Paragrafi i fundit, shiko paragrafin e fundit në majtë --

10 PË. Atë që kam bërë me X?

11 PY. Kjo që thotë:

12 "Pasi që serbët rifituan pozita strategjike -- "

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 prisni sa të përfundojë Avokati pyetjen, ju lutem.

15 Z. DIXON: [Përkthim]

16 PY. Kjo pra:

17 "Pasi që serbët rifituan pozita strategjike, UÇK-ja duhet
18 të rekrutonte civilët të cilët ishin larguar më herët. Në çdo
19 fshat kishte pozita të rregullta të UÇK-së por shumë civilë,
20 pa trajnim, filluan të visheshin me uniformën e UÇK-së dhe ju
21 bashkëngjiteshin njësiteve lokalë. Pa një numër të madh të
22 ushtarëve të parregullt, ishte e pamundshme të kontrolloje
23 situatën. UÇK-ja nuk ishte aq e organizuar sa që të gjithë
24 mendojnë. Nuk kishte një hierarki të mirëfilltë si një ushtri
25 e rregullt."

1 E pe këtë paragraf?

2 PË. Po.

3 PY. Që të jemi të qartë, nuk po them që e ke thënë ti këtë,
4 por kjo që është shkruar këtu, a është një përshkrim i saktë i
5 situatës në terren pasi rifituan serbët disa pozita
6 strategjike, a është e saktë kjo që thuhet këtu?

7 PË. Këtu nuk specifikohet ku, z. Avokat, ku, cilat, pozita,
8 në cilën kohë. Veç është përshkruar. Tashti po më pyet për
9 diçka që "Futje Ismet Tara ti diku" dhe unë nuk di për çka.
10 Pyetjen plotësoje në cilën kohë, në cilën vend, për cilën, për
11 cilën njoftim kërkon. Unë nuk mund të përgjigjem kështu. Se
12 këtu nuk përshkruhet, vetëm se "Pas humbjes ë pozitave", ne
13 UÇK-ja të gjitha pozitat tona i kemi humbur gjatë luftës, të
14 gjithë. Të gjitha pozitat dhe të gjitha shtabet i kemi humbur.
15 Asnjë s'kemi mund ta kontrollojmë. Më trego për cilën, për ku
16 bëhet fjalë. Në cilën? Në cilën pozitë ti don përgjigjen time?

17 PY. Unë po ju pyes për gjatë gjithë luftës --

18 PË. Jo, jo, nuk jam për --

19 PY. -- a ka ndodhur --

20 PË. Jo, nuk jam përgjegjës unë për gjë. Unë ju kam treguar që
21 unë jam financier dhe jam i logjistikës. Unë vetëm, vetëm
22 muajt e fundit pesë, gjashtë muaj kam qenë komandant i
23 brigadës dhe unë nuk jam përgjegjës dhe nuk di qaq. A dua unë
24 prej Rahovecit tim t'i di për pikat e përgjithshme? Mos pyet
25 mu. Keni pasur shefin, keni pasur shefin e shtabit këtu Bislim

1 Zyrapin edhe ke mund ta pyetni.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 nuk e vendos ti çfarë pyetjesh do bëjë Avokati. Avokati ka të
4 drejtën t'ju bëj pyetje. Detyra jote është t'u përgjigjesh, jo
5 ta korrigjosh atë bëj apo jo një pyetje.

6 Z. DIXON: [Përkthim]

7 PY. Mirë. Po ju pyes, më dëgjo me vëmendje, të lutem,
8 pyetjen, pas ofensivave serbe - në verë të 1998 - a është e
9 akte ajo që shkruhet këtu, pra, që ka pasur shumë ushtarë të
10 parregullt, ka qenë e vështirë të kontrollohej situata, nuk ka
11 qenë aq e organizuar saç mendonin të gjithë dhe nuk ka pasur
12 hierarki.

13 Dhe unë dua të konfirmoj me ju a është ky një përshkrim i
14 saktë i situatës, apo jo?

15 PË. Ushtarë të rregullt, në përgjithësi, nuk ka pasur kurrë
16 UÇK-ja. Atë e kam thënë unë, ma ke pyetur. Kurrë, kurrë
17 ushtarë të rregullt të kazermuar, të ushtruar, të përgatitur
18 nuk ka pas UÇK-ja. Në UÇK janë futur vullnetarët prej fillimit
19 edhe deri në mbarim. Kurrë nuk është çuar një ftesë një
20 ushtari të UÇK-së që ti të vish në UÇK, se as ka qenë e
21 mundshme, as që kemi pas guxim, as që kemi mujt ta detyrojmë.

22 Sepse forcat serbe kanë qenë 50.000, 55.000 forca kanë
23 qenë në kohën e luftës në Kosovë. 25.000 janë forca serbe të
24 rregullta policore dhe ushtarake që kanë qëndruar në kazerma,
25 z. Avokat. Plus forca shtesë që kanë ardhë për luftë ndoshta

1 përmbi 55.000 forca. Dhe këto, as shefi i shtabit nuk mund ta
2 kish përshkrue qysh ka qenë. A rregulla nuk ka pas. Rregulla
3 ushtarake nuk ka pas dhe nuk është përgjegjës asnjë ushtar për
4 ushtarin tjetër dhe asnjë komandant për ushtarët. Sepse
5 ushtarët kanë mund të largohen, të dezertojnë, të zhduken, të
6 mos kthehen, të shkojnë në perëndim, të largohen në Shqipëri,
7 të largohen nëpër shtëpitë e veta mos të kthehen dhe kurrë nuk
8 mund t'i jipet përgjegjësia as komandantit as më të madhit as
9 më të vogël për ushtarët ça kanë bërë.

10 Tash nuk e di çka, ku e ke ti qëllimin nuk e di.

11 PY. Qëllimi im ishte të merrja përgjigjen e pyetjes që në
12 fakt ma dhe. Faleminderit për këtë. Unë dua t'ju pyes po ashtu
13 kur ke thënë këtu që "nuk ka pasur ushtarë të rregullt në UÇK
14 sa u takon përgjegjësive", ma shpjegon pak çfarë deshe të
15 thoje me këtë?

16 PË. Këtu nuk e kam thënë unë këtu. Këtë dokument unë nuk e
17 kam thënë. Thuhet. Unë nuk e kam thënë këtu.

18 PY. Jo, jo. U keqkuptuam. Kur themi këtu në sallën e gjyqit,
19 jo në dokument e dhënë dëshmi këtu domethënë --

20 PË. Aha. Unë po e këqyri pi këtu.

21 PY. -- në sallë gjyqi.

22 PË. Për këtë që e thashë në fund pak më gjenësisht janë
23 taman.

24 PY. Po të pyes, po të bëj një pyetje tjetër. The:

25 "Nuk ka pasur ushtarë të rregullt në UÇK sa u takon

1 përgjegjësive.”

2 Jo dokumenti e the këtu. Çfarë keni --

3 PË. Hiqma qat dokument prej qatyit, të lutem.

4 PY. Jo në dokumente, e the këtu në sallën e gjyqit.

5 PË. Po, po e thashë. Po qat dokument hiqma se mu ka --

6 PY. Na sqaro të lutem çfarë deshe të thoje me këtë "sa u
7 takon përgjegjësive"? Ju lutem përgjigjuni pyetjes. Çfarë
8 deshe të thoje me këtë "sa u takon përgjegjësive"?

9 PË. Sa desha me thënë për këtë. Për shembull, gjatë shtabit
10 Arti të Rahovecit. Unë nuk jam i njoftuar që shtabi Arti të
11 Rahovecit ka marrë ndonjë urdhër prej dikujt pa marrë parasysht
12 kujt. Prej asnjë shtabi tjetër që ka marrë urdhër të bëhet kjo
13 ose të mos bëhet ajo ose të veprohet kështu ose të mos
14 veprohet kështu. Asnjë urdhër zyrtar nuk ma kanë treguar
15 komandantët të mi që kanë marrë ndonjë urdhër që duhet të
16 bëhet diçka.

17 Kemi bërë çdo kush si kemi ditur ë të mirën për qytetarët
18 e vet. Dhe tash nuk e di çka tjetër shtab të jetë përgjegjës
19 për atë që ka ndodhur në Rahovec ose për atë që ka ndodhur në
20 Krushë, ose për atë që ka ndodhur në Drenovc. Se nuk ka mund
21 të imponohet në atë kohë derisa unë jam kthyer, deri po të
22 them mbas Vitit të Ri, fillimit të organizimit në brigada deri
23 aty nuk ka pasur llogari askujt kërrkujt si ka dhënë. Dhe nuk
24 ka përgjegjësi mbi të tjerët.

25 Përgjegjësi janë në UÇK çdokush përgjigjet për veten e

1 vet çka ka bërë, ose në qoftë se e dëshmon vetëm me një urdhër
2 të dikujt që e ka urdhëruar ose që e dëshmon krejt komplet
3 saktë që ai ka marrë urdhër diçka ose urdhër ose është ndodhë
4 diçka me të. Përndryshe nuk ka përgjegjësi tek UÇK-ja as
5 komandanti për ushtarët, as ushtarët për komandantin.

6 PY. E kuptoj këtë. Faleminderit për dëshminë. Tani dua të
7 pyes për një pjesë tjetër të këtij dokumenti që lidhet me
8 kolaboracionistët, mos e shih dokumentin.

9 A ka pasur ndonjë politikë në njësitin tuaj apo ndonjë
10 praktikë më saktë në njësitin tuaj se çfarë të bënit me
11 kolaboracionistët, nëse ata duheshin arrestuar dhe duheshin
12 vrarë? A është e saktë?

13 PË. Jo. Jo. Nuk ka pasur asnjëherë.

14 PY. Pra, në qoftë se një person dyshohej si kolaboracionist,
15 ky person duhej ndaluar dhe marrë në pyetje, ka qenë kjo një
16 praktikë? Si e keni kuptuar ju?

17 PË. Si e kam kuptuar unë? Flet për shtabin tim, për
18 shembull, ose për përgjithësi?

19 PË. E kam fjalën vetëm për shtabin tënd.

20 PË. Ne nuk kemi guxuar e të kishim dashtë, por edhe të kishim
21 dashtë t'i marrim ata, nuk kishim guxuar me shku ata t'i
22 marrim sepse nuk kemi pas forca të mjaftueshme të hyjmë në
23 qytet t'i marrim njerëzit aty. Sepse qyteti ka qenë shumë ma
24 shumë me forca serbe sesa me forca të UÇK-së. Edhe të kishim
25 dashtë na s'kishim mujt me marrë edhe të kishim dashtë. Edhe

1 pse nuk kemi dashtë, se nuk kemi qenë as të përgatitur, as
2 s'kemi dit as çka të bëjmë me ta dhe në qoftë se edhe në qoftë
3 se do t'i mirrshim çka me bë me ta.

4 PY. A është e vërtetë që asnjëherë nuk të kanë dhënë urdhra
5 më lart, domethënë, kur themi nivele më të larta, flasim nga
6 zona, nga Shtabi i Përgjithshëm, që arrestoje kolaboracionistë
7 dhe t'i vrisje, saktë?

8 PË. Kurrë, asnjëherë. Kurrë, asnjëherë.

9 PY. Është e vërtetë, apo jo --

10 PË. Jo e vërtetë po 100 për qind e vërtetë.

11 PY. Është vërtetë, pra, që asnjëherë nuk i ke thënë UNMIK-ut
12 ti, vetë, konkretisht ti kesh thënë UNMIK-ut ti që UÇK-ja ka
13 rrëmbyer kolaboracionistët, i ka zhveshur dhe i ka vrarë në
14 vend, ndonjëherë ua ka djegur trupat ose i kanë lënë që t'i
15 hanin egërsirat? Asnjëherë s'e ke thënë këtë, apo jo?

16 PË. Kurrë, kurrë, kurrë. As jam pyetur, jo që kam thënë, por
17 as që jam pyetur kështu.

18 PY. Dhe nuk ke thënë që UÇK-ja ka vrarë të gjithë të
19 burgosurit, apo jo, të burgosurit që kishte ndaluar, nuk e ke
20 thënë apo jo?

21 PË. Jo, sepse nuk e di. As s'e ka vrarë të gjithë, as s'e ka
22 vrarë asnjë. Unë nuk e di.

23 PY. Në këtë dokumentin e UNMIK-ut pretendohet që ti ke thënë
24 se UÇK-ja i ka vrarë të gjithë, të gjithë të burgosurit.

25 S'është e vërtetë, apo jo?

1 PË. Unë po ju them ky dokument nuk është i imi. Po them që
2 unë nuk dëshiroj fare të ashtu. Unë nuk e di po lodh. Kurrë.
3 Atëherë duhet të m'i bini përfaqësuesit e UNMIK-ut të
4 dëshmojnë që unë kam dhënë këtë dëshmi. Atëherë po do i të
5 vërtetosh të njëjtën, të njëjtën që ma ka bërë edhe ish-
6 intervistuesit të mi të përshkruajnë diçka në mendje të vet.
7 Unë po tregoj që kurrë as e kam thënë as ka ndodhë. As takimi,
8 se le që e kam thënë. Nuk jam takuar kurrë që të japi kësi
9 dëshmi. Në qoftë se kam dhënë dëshmi unë i kam dhënë dëshmi.
10 Në qoftë se ka pyetur diçka kam dhënë dëshmi sa kam qenë
11 komandant. Ton van Loon dhe Walter Fleisher. Për të gjitha,
12 për të gjitha që kam mujt t'i jap unë që kanë ndodhur ka mujt
13 me i dhënë atynve.

14 PY. Po. Unë po përpiqem të sqarojë këtë me ju, z. Tara, çfarë
15 është e saktë dhe çfarë nuk është e saktë në këtë deklaratë.

16 PË. Asgjë. Asgjë nuk është e saktë.

17 PY. Këtu thuhet -- prit, prit, z. Tara, këtu thuhet që:

18 "UÇK-ja i ka vrarë të gjithë të burgosurit për të njëjtat
19 arsye që ai ka shpjeguar."

20 Kjo nuk është e vërtetë?

21 PË. Po a po kupton? Kjo nuk është e vërtetë. Ismet Tara nuk
22 dinë çka është e vërtetë këtu, çka flet ai. Ismet Tara nuk ka
23 njohuri në lidhje me këtë asgjë. Ismet Tara nuk ka asnjë
24 dëshmi që dikush është vrarë ashtu. Nuk i ka ndodhë Ismet
25 Tarës që dikush të vritet ashtu ose të jep një dëshmi të rrenë

1 atë. A po kupton?

2 Nxima këtë dokument se nuk mund ta shoh më. Nuk mund ta
3 shoh më. Mund të bësh pyetje ti sa duash. Ama kur i dedikohesh
4 këtij dokumenti ai ka dhënë -- unë po të them që as nuk i kam
5 dhënë as nuk i kam takuar, ti prapë a mund të jetë ajo e saktë
6 a s'mund të jetë. Ato duhet ta pyesësh, duhet të vijë ai këtu
7 ta pyesësh atë a ka qenë e saktë a jo, z. Mbrojtës Avokat.

8 PY. Mirë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
10 lutem përgjigjuni pyetjes që ta mbarojmë dëshminë. Sepse po i
11 jep, po mban ligjërata dhe thjesht po zgjat seancën. Ju lutem
12 përgjigjuni pyetjes.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

14 PY. Këtu thuhet që:

15 "UÇK-ja i ka vrarë të gjithë të burgosurit ..."

16 Ti nuk e ke thënë këtë, apo jo?

17 PË. Kurrë, kurrë, kurrë.

18 PY. Keni kërkuar që të hiqet nga ekrani ky dokument. Por dua
19 t'ju bëj disa pyetje të tjera lidhur me të përpara sesa ta
20 heqim.

21 PË. Bane. Bane.

22 PY. Dhe pastaj do e heqim.

23 PË. Bane se nuk mund ta shiqoj më.

24 PY. Faleminderit, z. Tara. Këto deklarata që bëhen në këtë
25 dokument lidhur me rrëmbimin e civilëve dhe zhveshjen e

1 civilëve që lihen aty në vend dhe që ekzekutohen, që digjen e
2 të gjitha këto gjëra të kësaj natyre, kur e keni lexuar këtë
3 dokument, Dëshmitar, është e saktë, apo jo, që ju këtë
4 dokument ose këto pretendime i shikoni si shumë të
5 ekzagjeruara, a është kështu?

6 PË. Jo të ekzagjeruar, po të pavërteta komplet. Rrena
7 komplet. I kam shiquar dhe i kam cilësuar si të tilla.

8 PY. Po ashtu janë bërë përgjithësime shumë të mëdha që kanë
9 të bëjnë, për shembull, me "të gjithë të burgosurit"? Këto
10 janë shumë përgjithësime të mëdha, apo jo? Është e saktë kjo?
11 Që ka përgjithësime të konsiderueshme, është e saktë kjo?

12 PË. Pa përsërite edhe një herë ose ndryshoje pyetjen sepse
13 nuk e kuptoj pyetjen për ngjarjet që ti dhe nuk jam i njoftuar
14 asgjë rreth këtyne? Bëma pyetjen ma të thjeshtë që të jap një
15 përgjigje të saktë çka mendoj unë.

16 PY. Po. Mund ta kem unë fajin për këtë. Të kërkoj falje për
17 këtë, Dëshmitar. Ajo çka po them unë është që të thuash që të
18 gjithë të burgosurit janë vrarë kjo përgjithësim i tmerrshëm.
19 Është e saktë kjo, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Jo e tmerrshme, përtej të tmerrshmes. Po ti po kërkon
21 prej meje që unë nuk kam një ide, një ide asgjë rreth asaj, te
22 unë të jap mendimin tim. A po kupton? Kjo është e përtej
23 tmerrshmes.

24 PY. Po. Faleminderit.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund t'i këto

1 dokumente nga ekrani. Megjithatë dokumenti në të majtë që
2 është shënuar me kryqe nga dëshmitari, që janë bërë këto X, ne
3 dëshirojmë që ta paraqesim si dokument që të pranohet në prova
4 gjyqësore. Nuk e di në qoftë se doni që t'i shënoni një numër
5 provizor prove aktualisht apo sesi doni të vijoni me të.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari, a ka
7 një numër ERN dokumenti?

8 Z. DIXON: [Përkthim] Po, e përmenda në fillim. Megjithatë
9 do ta gjej prapë. Është ERN 083094 deri në 083196. Faqet
10 konkrete kanë këtë numër 083110 deri në 083114.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
12 kundërshtim lidhur me këtë?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky dokument
15 pranohet në provë gjyqësore.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Dua që t'i caktohet një numër
17 provizor prove fillimisht sepse lidhet me dokumentin e UNMIK-
18 ut? Në qoftë se ju pranoni dokumentin e UNMIK-ut, atëherë
19 kërkojmë që këtë dokument ta pranoni në prova gjyqësore. Në
20 qoftë se dokumentin e UNMIK-ut nuk e pranoni, nuk është e
21 nevojshme që ta pranoni këtë dokument si provë gjyqësore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 [Përkthim] Në rregull. Caktoi një numër MFI. Po unë e kam
24 pranuar dokumentin tjetër, Dixon.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Po i janë dhënë numër provash

1 gjyqësore?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretari po
3 i cakton numrin, po këtë gjë ne e bëmë, ishte e para gjë që
4 bën sot paradite, i pranuar të gjithë dokumentet që kërkoi
5 Prokuroria.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Mendova që di i konsideronit, di i
7 shqyrtonit prapë para sesa të përfundonit, por në qoftë se i
8 keni pranuar, sigurisht që duam që ky dokument të pranohet.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë thashë që
10 të gjitha dokumentet janë pranuar, por më vonë do ju jap një
11 shpjegim të detajuar në një vendim sepse nuk e dhashë
12 shpjegimin përkatës tani.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Mirë. Atëherë në këtë rast dua që ky
16 dokument të pranohet në provë gjyqësore.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, e
18 pranova edhe pak më herët.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 dokumenti 083110 deri në 083114, do pranohet dhe do marrë
21 numrin e provës 2D0045. Do klasifikohet si konfidencial për
22 momentin. Ju faleminderit falënderoj.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Thjesht po kontrolloj dhe një herë
24 numrat që janë numrat e duhur.

25 PY. Z. Tara, siç e shikoni e hoqën dokumentin nga ekrani,

1 besoj se kjo do ju gëzoj, do ju kënaq.

2 PË. Jo, nuk e kam --

3 PY. Megjithatë kemi dhe disa pyetje të tjera të lidhura me
4 ju.

5 PË. Nuk e kam problemin unë as që më kënaqin as që -- vetëm
6 se shikoj një dokument që s'di asgjë rreth tij.

7 PY. Po, e kemi dëshminë tuaj. Do ju kërkoja dhe një herë
8 tjetër që të më dëgjonit me vëmendje pyetjet në mënyrë të
9 tillë që të përfundojmë brenda kohës që kam. Se kohën e kam të
10 kufizuar.

11 E kam fjalën më konkretisht për paragrafin 119 të
12 shënimit përgatitor që Prokuroria ka mbajtur me juve. Në këtë
13 paragraf ju thoni se:

14 "Dokumenti" - domethënë, është ky dokumenti që pamë
15 bashkë përpara pak kohe - "më përshkruan mua si tradhtar të
16 kombit, si tradhtar të heronjve', si dhe 'tradhtar të UÇK-së
17 dhe të gjakut të dëshmitarëve, të civilëve të vrarë dhe
18 familjeve të tyre."

19 A ju kujtohet se e keni thënë këtë për ZPS-në? Ju lutem
20 së pari konfirmoni që këtë ia keni thënë ZPS-së, është e saktë
21 që ia keni thënë ZPS-së këtë?

22 PË. Po me Prokuroren që është këtu? Me Prokuroren që është
23 këtu? Po.

24 PY. Ajo ç'a dua që të sqaroj lidhur me këtë paragraf është
25 kjo: A është e saktë që ju keni thënë që ju nuk doni që ky

1 dokument të bëhej publik sepse ishte një dokument që sikurse e
2 thatë edhe tani, ishte një gënjeshtër e madhe, a është kështu?

3 PË. Po këtë dokument që diskutuam apo për atë që kërkoj unë?

4 PY. Po.

5 PË. Për që e kërkoj unë?

6 PY. Jo, për atë që kërkon ti. Dokumenti që diskutuam pak më
7 përpara që ishte në ekran dhe që e hoqëm nga ekрани, për atë
8 dokument e kam fjalën, Dëshmitar.

9 PË. Jo, le të bëhet publik sa herë don se nuk është dokument
10 i imi ky. Nuk përshkruna unë aty. Këto janë rrena. Këto nuk
11 janë takimet e mia.

12 PY. Në rregull. Këtu ju thoni që ky dokument ju përshkruan si
13 tradhtar i kombit dhe në qoftë se bëhet publik, do ishte i
14 rrezikshëm për ju dhe që ju mund të vriteshit nga dikush nga
15 bashkësia juaj.

16 Apo thoni tani që ju nuk e keni problem që ky dokument të
17 jetë publik edhe që ju nuk keni frikë nga askush, këtë po
18 thoni?

19 PË. Unë kërkoj dokumentin që më është hupur, që e kanë
20 mshefur, që e kanë zhdukur të publikohet. Ai dokument më bën
21 mu, sepse është dokumenti i intervistuesve të mi. Jo ky. Këtë
22 e kam parë. Unë flas për dokumentin vetëm se ça kam parë në
23 intervistat e mia në përgatitjen time me Prokurorin tim që
24 është zhdukur. Ai dokument duhet të dalë të sqarohet.

25 Përndryshe për dokumente tjera, nuk intersohem dhe ça bëni

1 ju.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndaloni, ju
3 lutem. Ju lutem, përgjigjuni pyetjes që ju bëri z. Dixon.

4 Dixon, përsëriteni dhe një herë.

5 Z. DIXON: [Përkthim]

6 PY. Ju lutem dëgjoni pyetjen time, Dëshmitar. Ky dokumenti që
7 e hoqëm nga ekrani, dokumentin që e pamë bashkë, me atë
8 dokument ti nuk e ke problem që ai dokument të jetë publik,
9 nuk keni asnjë frikë lidhur me atë dokument, nuk keni frikë se
10 çfarë mund t'ju ndodhë juve në qoftë se ai dokument bëhet
11 publik, a është e saktë kjo?

12 PË. Ai tjetër dokument duhet të qitet në publik. Ky dash le
13 të qitet, dash mos të qitet. Nuk mërzitem për këtë.

14 PY. Më duhet ta sqaroj këtë. E di që ju thoni që ka një
15 dokument tjetër. I kemi Prokurorisë që të na e tregojë këtë
16 dokument. Dhe do ta shikojmë se çka do dalë nga kërkesa jonë.
17 Por tani, z. Tara, po flasim për këtë dokumentin që e kishit
18 pak para ca çastesh në ekran, e kam për atë dokument, atë
19 dokument. Me atë dokument ju nuk është keni problem që ai të
20 bëhet publik, për atë e kam fjalën, apo jo?

21 PË. As fare nuk e kam problem. Çka do le të bëhet. Fare
22 problem për atë dokument sido që të vendosë Gjykata, ju,
23 kushdo, Prokuroria, unë nuk kam fare problem çka bëhet me atë
24 dokument. A qitet në publik, le të lajmërohet tërë bota, nuk e
25 kam problem.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 Dëshmitar.

3 Z. DIXON: [Përkthim]

4 PY. Ju nuk keni frikë se do lëndoheni ose mund t'ju ndodhë
5 diçka në qoftë se ky dokument bëhet publik --

6 PË. Jo, jo.

7 PY. -- apo jo?

8 PË. Sepse ky dokument është si mbas meje është i përshkruar
9 nga armiqtë e mi. A për këtë dokument nuk kam dhënë unë kurrë
10 asnjë dëshmi. Por dokumentin ku unë kam dhënë 32 orë dëshmi
11 tek investiguesit e mi, intervistuesit e mi, prokurorët,
12 hetuesit e mi, në atë dokument të më përshkruhet ajo. Ajo
13 është rrezik për mua se unë kam qenë 32 orë në intervista.
14 Janë 600, 700 faqe që i ke para vetes ose që i ka Prokurorja
15 që kam dhënë intervista.

16 Dhe në bazë të gjitha atyneve të dhënave të mia të
17 përshkruhet Ismet Tara tradhtar i kombit i cili e ka tradhtuar
18 ushtrinë e vet, ka tradhtuar vetveten, ka tradhtuar gjithë
19 dëshmorët, heronjtë e kombit, gjithë bashkëluftëtarët e vetë
20 e gjithë atë gjak të derdhur në Kosovë prej qytetarëve, aty
21 asht Ismet Tara në rrezik në qoftë se nuk paraqitet që këtu të
22 dëshmohet se kush e ka qit. E pastaj Ismet Tara pastrohet. Kur
23 del ai dokumenti dhe të bëhet publik atëherë kur diskutohet,
24 atëherë do të qartësohet se çfarë përshkrimi kanë bërë ata.

25 Për këto dokumente të tjera, hiç fare nuk jam i interesu.

1 Çka doni bëni. Më akuzoni, më mbyllni, më bëni çka doni.

2 PY. Faleminderit, z. Tara. E kemi përgjigjen tuaj tek rreshti
3 i parë.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera për z. Tara.
5 Faleminderit, Gjykatës.

6 PY. Faleminderit, z. Tara.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 z. Dixon.

9 Z. Ellis, fjala është për ju.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

11 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

12 Z. ELLIS: [Përkthim]

13 PY. Mirëdita, z. Tara. Unë quhem Ellis dhe jam përfaqësuesi i
14 Jakup Krasniqit. Kam dy pyetje, kam vetëm dy pyetje për ju.
15 Pyetja e parë është kjo: Është një pyetje që ka të bëjë me
16 dokumentin që e patë përpara pak minutash në ekran që është
17 deklarata e UNMIK-ut. Këtë dokument ua ka treguar Prokuroria
18 në vitin 2019 gjatë intervistës së saj me ju. Dua që të lexoj
19 atë çfarë keni thënë ju në vitin 2019. Dhe për procesverbal
20 kjo jepet në faqen 23 në anglisht, në rreshtin 23, në Pjesën
21 10. Ju thoni si më poshtë:

22 "Nuk jam marrë asnjëherë në intervistë lidhur me këto
23 gjëra. Nuk më ka intervistuar askush lidhur me këto aspekte.
24 Kjo është thjesht imagjinatë e Anna Vannozzi dhe të tjerëve.
25 Nuk kam asgjë tjetër për të thënë lidhur me këtë gjë. Ndoshta

1 e kam takuar Anna Vennozzi pa e ditur se kush është ajo, por
2 këto gjëra nuk i kamë thënë asnjëherë.”

3 Pra, ju keni qenë i qartë që në 2019 për Prokurorinë dhe
4 ia keni thënë troç dhe qartë Prokurorisë që ju nuk i kemi
5 thënë këto gjëra. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Qartë dhe kurrë nuk jam takuar Anna Vannozzi për t’i
7 diskutuar këto gjëra. Në qoftë se ajo dhe më ka takuar, jemi
8 përshëndet, ajo është diçka tjetër. Diskutime rreth këtyre
9 gjërave kurrë nuk i kemi bërë. Në qoftë se ajo më njeh mu
10 mundet të më njoh. A unë kurrë nuk e kam parë dhe nuk kam
11 ditur që kjo është një punëtore e UNMIK-ut ose dikush. Ama
12 kurrë nuk diskutuar për këto probleme jo.

13 PY. Pyetja ime është kjo: Këtë ia keni thënë Prokurorisë kur
14 jeni takuar në 2019 dhe të njëjtën gjë po thoni dhe sot, kjo
15 është e saktë, kështu?

16 PË. Po. Edhe kemi diskutuar me orë të tëra kët dokument, me
17 orë të tëra. Ka përgjigjet e mia aty.

18 PY. Në seancën përgatitore përpara një jave a ju është
19 treguar ndonjë dokument tjetër nga Prokuroria për të
20 konfirmuar që ata kanë kontaktuar me Anna Vannozzi ose ndonjë
21 person tjetër në UNMIK për të verifikuar dokumentin e 2001? A
22 ju është thënë ndonjë gjë lidhur me këtë aspekt, kanë treguar
23 ndonjë gjë lidhur me këtë pyetje?

24 PË. Më është njoftuar i njëjti dokument që flitet, por
25 njëkohësisht edhe Prokurores në fjalë i kam thënë që ky

1 dokument nuk është i njoftur fare për mu. Unë nuk kam bërë
2 kurrfarë takimi me atë Anna Vannozzi. Kjo është një përshkrim
3 i saj si mbas dëshirës së saj. Tash edhe nuk e di a ka qenë e
4 UNMIK-ut. Tash mund të jetë kjo që edhe UNMIK-u na përshkruar
5 të gjithë ushtrinë tonë si ka pas dëshirë ai. Tash do të
6 filloj të dyshoj që këto përshkrimet sikurse që kanë ndodhë në
7 seancën time 32 orëshe që kanë bërë këta intervistuesit
8 përshkrimin tim edhe këtu e paska përshkruar UNMIK-u në atë
9 kohë sipas dëshirës tynve dhe pa na njoftuar neve dhe pa na
10 takuar neve. Sepse në Kosovën time ka ndodhur gjithçka. Sepse
11 në Kosovën time ende nuk vendosë as pushteti jonë, as
12 kërrkush.

13 Ende mund të bëhet me neve edhe KFOR-i mund të na shtijë
14 në burg, mund të na bëj gjithçka, UNMIK-u, EULEX-i mund të na
15 bastis shtëpia, mund të na marrin sikurse Serbia që na ka
16 marrë atëherë edhe kështu po veprohet edhe sot me neve edhe
17 pse shtet i pavarur.

18 Ende jemi në kontrollin e KFOR-it edhe UNMIK-ut sot e
19 kësaj dite, vetëm se që nuk po vritemi, nuk po persekutohemi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mjafton me
21 kaq, Dëshmitar. Nuk ishte pyetja kjo.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Mair, fjala për ju.

25 Z. MAIR: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbështetur në

1 pyetjet që bënë kolegët e mi sot paradite, nuk kam pyetje për
2 këtë dëshmitar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
4 Znj. Tavakoli.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje. Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje
7 plotësuese nga Prokuroria.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.
9 Shkurtimisht.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit për durimin, të
11 nderuar Gjykatës.

12 Pyetje vijuese nga znj. Iodice:

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

14 PY. Z. Tara, kam disa pyetje tjera për ju. Na keni thënë disa
15 herë sot që nuk jeni takuar asnjëherë me Anna Vannozzi.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
17 paraqesë në ekran dokumentin me numër ERN SPOE00144634.
18 Atëherë po ua jap dhe një herë numrin është 144634.

19 PY. Z. Tara, do t'jua lexoj përmbajtjen e këtij dokumenti. Do
20 ju them se çfarë është ky dokument. Është një shënim që është
21 bërë prej një hetuesi lidhur me një takim që ata kanë
22 organizuar me juve më datën 24 janar -- jo, e thashë gabim, më
23 datë 22 janar për të organizuar një takim me juve më datë 24,
24 këtu thuhet që:

25 "Më datë 22 janar 2001, pra, hetuesi raportues së bashku

1 me hetuesin dhe një ndihmës ligjor kanë shkuar në Rahovec dhe
2 kanë pasur një takim të shkurtër me Ismet Tarën, ish-komandant
3 i Brigadës 124 të UÇK-së.”

4 Thuhet më tej që:

5 “U takuam në një restorant me z. Tara dhe ramë dakord me
6 të që të takoheshim më datë 24 janar, në orën 9.30, aty ka
7 pasur të pranishëm dhe persona të tjerë.”

8 Ky është një dokument i cili është nënshkruar nga Anna
9 Vannozzi.

10 PY. A ju kujtohet që është organizuar një takim më datë 22
11 janar për të bërë organizimet e nevojshme për takimin e
12 mëpashtëm të datës 24 janar, Dëshmitar?

13 PË. Pse Prokurore nuk ma dorëzon dokumentin e kërkuar nga ti?
14 Po unë do të përgjigjem.

15 PY. Z. Tara, më herët sot u pajtuat që do i jepni përgjigje
16 pyetjeve të mia.

17 PË. Po, do t'i jap.

18 PY. Pyetja ime --

19 PË. Do t'i jap.

20 PY. -- është kjo: A ju kujtohet që ka ndodhur ky takim më
21 datën 22 janar për të bërë organizimet për takimin e datës 24
22 janar 2001? Ju kujtohet ky takim apo jo?

23 PË. Ky takim nuk ka ndodhur kurrë, znj. Prokurore.

24 PY. Tani dua t'ju tregoj një tjetër dokument.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarit

1 të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00144629 deri në 00144630.
2 PY. Ky është një tjetër shënim që ka datën 31 janar 2001 nga
3 e njëjta hetuese, nga Anna Vannozzi, e cila bën një
4 përmbledhje e asaj çfarë i keni thënë ju asaj në takimin e
5 mbajtur më datë 24 janar.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër dhe
7 të shohim çfarë shkruhet aty, paragrafi i dytë.

8 PY. Këtu thuhet:

9 "Z. Tara, pranoj që UÇK-ja ka rrëmbyer njerëz që
10 dyshoheshin që të ishin bashkëpunëtorë të serbeve, ishte e
11 nevojshme për të realizuar objektivat e tyre. Tara tha që të
12 gjitha ata persona ishin vrarë. Ai gjithashtu tha që ishte
13 thuajse e pamundur që të gjendeshin trupat që ishin djegur ose
14 ishin lënë në vendin e ekzekutimit. Kafshët kanë kontribuar
15 për shkatërrimin e provave."

16 Më pas vazhdon më tej:

17 "Tara është një burim i shkëlqyer për të kontrolluar
18 veprimtarinë e UÇK-së përpara, pas dhe gjatë luftës,
19 pavarësisht pozicionit të vet dhe për çfarë ka qenë
20 përgjegjës, ai ka deklaruar lidhur me krimet e kryera nga UÇK-
21 ja dhe ka pranuar viktimat e kidnapimit që janë vrarë.

22 "Tara duket se është i besueshëm dhe i mbështetshëm."

23 Ky është një tjetër shënim që ka bërë Anna Vannozzi për
24 takimin që ke pas ti me të. Po tani a ju kujtohet që në fakt
25 ai takim ka ndodhur, Dëshmitar?

1 PË. Kurrë. Asnjëherë. Në qoftë se ka ndodhur takimi me ish-
2 investiguesit e mi për dokumentin e humbur atëherë edhe me
3 këtë ka ndodhur. Në qoftë se jam i informuar nga investiguesit
4 e mi për atë dokumentin që kam përshkruar, njësoj edhe kjo
5 atëherë kam mund të ndodhë.

6 PY. Kam edhe një pyetje të fundit për ju, Dëshmitar, lidhur
7 me dokumentin që patëm më përpara. Për procesverbal është
8 dokumenti SPOE00144632. Ky është dokumenti që ua tregoi kolegu
9 im i Mbrojtjes së Veselit, Avokati i z. Veseli.

10 Këtë pjesë ua lexuan dhe juve ju tha që gjatë kësaj
11 interviste --

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në fakt do i kërkoja Sekretarit
13 që të kalojmë tek faqja tjetër në të dyja versionet në
14 anglisht dhe në shqip.

15 PY. E kam fjalën për paragrafin e dytë, duke filluar me "E
16 pyeta Tarën ...". Dua që të përqendrohemi tek kjo, z. Tara.
17 Këtu thuhet që ju keni thënë që mund të kujtonit vetëm dy
18 anëtarë të një familjeje, një nga Brestovaci dhe tjetri nga
19 Bellacërka si viktima.

20 Z. Tara, dëshmia tregon që në kohën e takimit, pra, në
21 vitin 2001, nuk dihej publikisht që anëtarët e këtyre
22 familjeve ishin të vdekur pasi kufomat e tyre janë
23 identifikuar shumë më pas.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe për këtë arsye dua që t'i
25 referohem për Gjykatën provës P1147, faqet 23 deri në 24.

1 PY. Si e shpjegoni që ju i keni treguar UNMIK-ut lidhur me
2 këto viktima në 2001?

3 PË. Unë nuk e shpjegoj se nuk ia kam -- nuk e kam bërë
4 takimin me këta. Unë ua shpjegoj që nuk e kam bërë fare. Ata
5 qysh e kanë përshkruar, le të vijne ata le ta vërtetojnë pranë
6 Gjykatës, le ta vërtetojnë edhe të dëshmojnë që unë kam qenë
7 në takim me ta, njësoj sikurse për dokumentin që ma keni
8 hapur. Le të dëshmojnë ata. Unë jam përgjegjës. Ata duhet të
9 vijne këtu. Ama të dëshmojnë me prova jo me përshkrime prej
10 zyrave atje për komandant Tarën sepse qenka përgatit -- jo,
11 jo.

12 PY. Faleminderit.

13 PË. Qenka përgatit edhe prej UNMIK-ut, domethënë, një akuzë e
14 njëjtë sikurse është përcjellë edhe te investiguesit e mi.

15 PY. Faleminderit, z. Tara. Faleminderit për përgjigjet.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar anëtarë të Trupit
17 Gjykues nuk kam pyetje të tjera, megjithatë dëshiroj që të
18 regjistrohen si prova gjyqësore dy dokumentet të tjera që i
19 përdora për pyetjet. Më konkretisht janë dokumentet SPOE144634
20 dhe SPOE144629 deri në 630. Janë relevante për sa i takon
21 faktit që ka ndodhur takimi dhe jepen fakte të tjera lidhur me
22 të.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
24 kundërshtim?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto dokumente

1 kanë qenë në posedim të Prokurorisë para shumë kohe. Kështu që
2 ne na vendos në disavantazh fakti që i përdor tani dhe i
3 nxjerr tani Prokuroria këto dokumente.

4 Së pari, dua të kërkoj nga Prokuroria, në qoftë se ato
5 pranohen, dua që të mendohet mundësia që të na jepet kohë neve
6 për të bërë pyetje lidhur me të, sepse më duhet ca kohë sa për
7 t'i rishikuar dokumentet. Parashtrimi i parë është që
8 dokumentet nuk duhet të pranohen. Po nga ana tjetër në qoftë
9 se i pranoni këto dokumente, atëherë duhet që të bëjmë ne
10 pyetje lidhur me to.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
12 kundërshtim tjetër? Nuk dëgjoj të ketë kundërshtim tjetër.

13 Do t'i pranojmë të dy dokumentet.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
15 Gjykatës. Dhe në qoftë se më lejoni mund t'ua shtoj këto
16 dokumente listës që po përgatis tani. Në qoftë se është e
17 mundur?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
21 Barthe.

22 [Mikrofoni çaktivizuar]. Ju kërkoj ndjesë, dokumentet
23 janë relevante, përmbushin kriteret *prima facia* sipas
24 rregullës 138 të Rregullores.

25 Mund të vazhdoni.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Dixon, që ta kuptoj
2 drejt, ju po kërkonit që të bëni pyetje plotësuese tani, këtë
3 po thoni?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Këtë kërkoja që të më jepej mundësia
5 një herë që t'i shoh këto dokumente sepse si pikë e parë
6 thashë që nuk duhet që të pranoheshin. Në qoftë se do pranohet
7 atëherë duhet të kemi mundësi që të bëjmë pyetje plotësuese se
8 nuk i kemi marrë këto dokumente.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht që
10 ju janë dhënë këto dokumente.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kanë qenë atje. Nuk janë
12 mbështetur.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kanë qenë
14 pjesë e listës së dokumenteve tuaja?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Janë njoftuar me dosjen
16 njoftuese. Po faktikisht në atë kohë kanë qenë relevant për
17 takimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe
19 dëshmitari e ka mohuar që këto janë dokumentet e veta.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka arsye
22 atëherë për të shkuar përtej kësaj.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë mund të na jepet mundësia të
24 paktën që të bëjmë pyetje sepse duhet që të na jepet mundësia
25 se ky është dokument që është përdorur për herë të parë pasi

1 kemi përfunduar ne pyetjet tona, kështu që duhet të kemi
2 mundësi që të bëjmë pyetje plotësuese.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është si
4 i kemi bërë pyetjet e Gjykatësve, megjithatë për momentin nuk
5 keni të drejtë që t'i bëni pyetje plotësuese dëshmitarit.

6 Pyetje nga Trupi Gjykses:

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Tara. Do t'ju
8 bëj disa pyetje të shkurtra. Juve na treguat pak më herët
9 lidhur me familjen Dedic dhe zhdukjen e Boban Dedic.

10 Sipas paragrafit 110 të Shënimit përgatitor të
11 Prokurorisë ju thoni si më poshtë dhe do lexoj këtu:

12 "Dëshmitari 047745 i ka paralajmëruar familjen Dedic që
13 të mos largoheshin nga lagja serbe dhe më vonë Dzana dhe Pedi
14 ka pranuar që djali i tyre kishte shkuar në qytet. Dëshmitari
15 04745 shpjegoi për KFOR-in që ai ishte personi që i kishte
16 liruar familjen dhe që i kishte paralajmëruar ata që të mos
17 largoheshin nga lagja serbe. Përderisa Boban kishte shkuar në
18 qytet ishte e pamundur që Dëshmitari 04745 të ndihmonte ata
19 sepse ishte e pamundur për të që të kontrolluar gjysmën e
20 popullatës dhe të gjitha fshatrat ishte e pamundur kjo gjë."

21 Z. Tara, ju këtë e konfirmuat edhe në pyetjet që ju bënë
22 ekipet e Mbrojtjes, për procesverbal e keni dhënë këtë në
23 faqet 57, 58 të transkriptit në kohë reale, ku ju thatë që nuk
24 kishit mundësi që të kontrollonit të gjithë popullatën. Dhe ju
25 thoni:

1 "Nuk ishte përgjegjësia ime për ta bërë këtë gjë dhe isha
2 i pamundur për ta bërë këtë gjë."

3 Së pari, z. Tara, dua t'ju pyes, a keni bërë ndonjë gjë
4 për të ndihmuar familjen Dedic dhe në qoftë se keni bërë diçka
5 për ta ndihmuar këtë familje, ju lutem na thoni konkretisht
6 çfarë keni bërë?

7 PË. Për familjen Dedic, në datën e caktuar, unë jam i pari që
8 kam shkuar në vizitë kur janë lajmëruar disa ushtarë se një
9 familje ka armatim në banesë në shtëpi dhe don të iki. Dhe unë
10 i kam marrë pesë, gjashtë ushtarët e mi dhe kam shkuar tek ajo
11 familje që janë shumë afër stacionit të policisë ku kemi
12 qëndruar na atëherë në atë kohë.

13 Kur kam shkuar në vendngjarje aty kanë qenë dy kerre të
14 shqiptarëve të cilët kanë shkuar atje t'i bartin ata familje
15 deri tek lagja serbe.

16 Dhe e kam pyetur ata se kush janë, janë një familje serbe
17 aty --

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Një çast. Një çast t'ju
19 ndërpres, z. Tara. Më vjen keq. Mbase nuk e bëra shumë të
20 qartë, specifike pyetjen në fakt. Do ta riformulojë. Pas
21 zhdukjes së Boban Dedic, a ke folur me ndonjë person, me
22 ndonjë vartës, me ndonjë person tjetër për ta pyetur a e dinte
23 vendndodhjen Boban Dedic?

24 PË. Jo, z. Gjykatës.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po pse nuk e bisedove me

1 askënd?

2 PË. Sepse vetë Dzana dhe Pedi Dedic kanë ardh, kanë
3 kontaktuar edhe tre-katër herë me mua pas asaj ndihmës që unë
4 i kam liruar të shkojnë në lagjen serbe atje dhe të qëndrojnë,
5 sidomos për Boban se është i ri të qëndrojnë nalt në lagjen
6 serbe mos të del në Rahovec sepse në Rahovec është gjendja,
7 kështu siç e kemi përshkruar dhe mund të ndodhë gjithçka dhe
8 pastaj nuk do të ketë mundësi kërrkush të bëjë diçka. Por
9 gjatë takimit, të tre, katër herë unë kam dyshuar se mos ata e
10 kanë larguar në dy, tre herë e kam kuptuar mos ata don ta
11 akuzojnë Ismet Tarën e atë e kanë larguar për Serbi. E kanë
12 mshfur. Se unë i kam paralajmëruar çfarë rreziku është, se çka
13 mund të ndodhë. Mirëpo mbas dy, tre tjera takimeve kam nisur
14 të kuptoj që ajo ngjarje paska ndodhë. Si unë qysh e kam
15 kuptuar.

16 Dhe ata pastaj kanë shkuar kanë lajmëruar në pikën e
17 KFOR-it se Boban e kanë kidnapuar UÇK-ja, jo që është zhdukur.
18 Jo që është zhdukur, po që e ka kidnapuar UÇK-ja. Dhe pastaj
19 përgjegjësit e pikës në ndarje të lagjes serbe edhe shqiptare
20 kanë ardhur te unë dhe kanë njoftuar për rastin. Unë, pak a
21 shumë, i kam njoftuar që qysh i kam shku, qysh i kam lëshuar
22 unë, "Po dëshiroj", i kam thënë, "dëshiroj edhe unë të vij
23 atje të ballafaqohem me këtë familje e ta shpjegoj se çka kam
24 bërë unë për këtë familje". Kam marrë një përkthyes timin në
25 gjermanisht dhe kam shkuar, ushtarin tim që ka ditur

1 gjermanisht dhe kam shkuar në pikën e caktimit. Atje në pikën
2 e kontrollit ku kanë qëndruar pesë, gjashtë ushtarë gjermanë
3 edhe ushtarë holandezë. Dhe ka nisur biseda, kanë njoftuar ata
4 dy kryesorët, kanë thënë që po akuzon kjo se ushtarët e UÇK-së
5 ia kanë kidnapuar Boban. I kam thënë se "Kjo nuk është e
6 vërtetë, sepse asnjëherë nuk më është thënë."

7 Kam treguar rastin qysh ka ndodhë që e kam lëshuar, qysh
8 i kam paralajmëruar dhe i kam treguar edhe për tre, katër
9 raste tjera ende pa u takuar me këta ushtarët në pikën që kanë
10 qenë përgjegjës për lagjen serbe. Dhe i kam treguar që ata mu
11 më kanë njoftuar se Boban ka dalë në qytet dhe është zhdukur.
12 "A kjo akuzë", thashë, "çka paskan bërë nuk e di. Provoni,
13 vërtetoni që a është kjo që unë po e them a është e saktë".
14 Ata kanë pranuar para atynve që është e saktë, sa që një
15 ushtar gjerman ia ka ngjitur gati që për fiti i ka thënë "Pse po
16 rren? Ku e ke çuar?" Edhe ai ka dyshuar se mos e ka dërguar të
17 njëjtin Boban për Serbi e don ta akuzojë UÇK-në. Dhe këtu
18 përfundon. Të gjitha pastaj nuk ka -- është i njoftuar edhe
19 komandanti Van Loon me rastin, është edhe Walter Fleisher. Dhe
20 asnjëherë më nuk është kërkuar prej meje që unë -- dhe nuk kam
21 pas përgjegjësi, nuk kam mundur unë as të bëj hetime, as pyes
22 se nuk më është lejuar as prej KFOR-it, as prej UNMIK-ut, as
23 prej OSBE-së. Nuk ka mundur edhe të kisha dashtë nuk kam
24 mundur. Kjo është e imja me ato që kanë ndodhur.

25 Dhe unë e kam parë në intervista këtu kur ka qenë babai i

1 tij. Edhe pse për këto intervista unë kam dhënë katër, pesë
2 orë më së pakti pyetje-përgjigje me rastin e 2019, po ky rast
3 është ngritur pastaj edhe rast kundër bashkëluftëtarëve këtu
4 të mi të cilët i ka akuzuar, i ka akuzuar prindi pastaj kur ka
5 pa që s'mundet me Ismet Tarën se Ismet Tara i ka njoftuar.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar,
7 faleminderit. Ju përgjigje një pjesë të pyetjeve të mia. Unë
8 nuk po flisja për hetim formal. Më shumë e kisha llafin a ke
9 pyetur ndonjë nga vartësit e tu. A di gjë lidhur me zhdukjen,
10 me fatin edhe ku mund të jetë Boban Dedic. Kjo ishte. Jo hetim
11 formal. Dhe ju përgjigje, jo, në thelb.

12 PË. Jo. Jo.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja ime e fundit - gjatë
14 takimeve apo kontakteve që ke pasur me familjen Dedic, a ju
15 the ti atyre, familjes Dedic, që Boban e kishin marrë
16 paramilitarët dhe ti nuk e dije ku ishte Boban, ia ke thënë
17 këtë?

18 PË. Kurrë jo.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Parashtarakët - më falni.

20 PË. Kurrë jo.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
22 të tjera.

23 DËSHMITARI: Edhe një sqarim në qoftë se duhet lidhur me
24 këtë. Kam një sqarim tjetër. Një sqarim shtesë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ke të fikur

1 mikrofonin.

2 DËSHMITARI: Okej. Okej.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje
4 Prokuroria më?

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk ka asgjë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mair.

10 Z. MAIR: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tavakoli? Jo.

12 Dëshmitar, përfunduat dëshminë tuaj. Mund të largoheni
13 nga salla e gjyqit në shoqërinë e Sekretares së seancës.

14 Faleminderit dhe z. Van Straalen për ndihmën. E
15 vlerësojmë faktin që erdhët dhe e vlerësojmë kohën tuaj.

16 DËSHMITARI: Në përgjithësi ka përfunduar apo ka ditë të
17 tjera?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfundoi
19 fare.

20 DËSHMITARI: Atëherë ato dhjetë minuta, ato dhjetë minutat
21 e mia mi ke premtuar, z. Gjykatës. Atëherë do të dalësh i
22 paarsyeshëm prapë se ke dhënë në publik, dhjetë minutat e
23 fundit lidhen me këtë dokument. Ma ke dhënë fjalën.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pesë minuta.
25 Pesë minuta.

1 DËSHMITARI: Na duhet para se të nis të marrë një fletore
2 shënimi që unë kam bërë shënime takimi për çdo ditë --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo. Pesë
4 minuta duke filluar që tani.

5 DËSHMITARI: A mundet vetëm shënimet që unë t'ju bindi që
6 atë dokument e kam parë. Vetëm shënimet që i kam bërë unë
7 gjatë takimeve për çdo ditshme me --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 DËSHMITARI: Për çka. Për dokumentin që kërkoj unë? Janë
10 te unë në dhomën time. Më fal. [Flet anglisht]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
12 shko vetë. Shko vetë me Sekretaren e seancës.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, pesë
16 minuta. Ke pesë minuta. Pas minutash do të them që e mbarove,
17 kështu që me kujdes kohën, me kursim kohën. Do të paralajmëroj
18 kur t'i afrohem pesëminutëshit.

19 DËSHMITARI: Këtu është përshkrimi i të gjithave ditëve të
20 intervistimit tim ose të përgatitjes time me Prokuroren.
21 Shënimet që marrë mbas çdo takimi.

22 Takime me personelin e sigurimit tim -- ah jo. Paraqitja
23 ime në Gjykatën e Hagës është bërë më datën 14 shkurt 2025,
24 pranë Prokurores time dhe të tjerëve ku më janë bërë të
25 njohura të drejtat e mia gjatë punës në ekipin e Prokurores

1 dhe gjatë daljes në dëshmi të hapura në sallën e Gjykatës.

2 Pastaj e kemi vazhduar leximin e intervistimit të vitit
3 2019 që i kam dhënë në plotni të njëjtën Gjykatë deri diku
4 vonë.

5 Dhe mbas 15 shkurt, ka qenë ditë e shtunë dhe më 16
6 shkurt ka qenë ditë e diel më janë dhënë intervistomë të 2019
7 t'i lexoj në hotelin ku kam fjetur në *Holiday Exspress*.

8 Ditën e nesërme, më 17 shkurt 2025, kemi vazhduar me
9 ekipin e Prokurores përgatitjen për daljen në dëshmi time të
10 hapur për Gjykatë. Procedura është zhvilluar pa farë problemi.

11 Dhe të njëjtën procedurë kemi bërë edhe të martën më
12 datën 18 shkurt 2025 deri vonë, pa asnjë problem.

13 Por më datën 19 shkurt 2025, të mërkurën, e kemi vazhduar
14 prapë deri diku në mesditë pa problem deri afër orës 12.00. Në
15 mesditë kur Prokuroria ime ma paraqiti një dokument të vitit
16 2019 të intervistimit tim nga ekipi im intervistues të
17 atëhershëm. Kur fillova ta lexoj, më kaploi një dridhje e
18 trupit dhe frika se çfarë lexoja, e mendoja të bërtas aty para
19 të pranishmëve, "Çfarë janë këta njerëz? Çfarë na përgatitini
20 neve? Kush janë këta kriminelat? Derisa më qetësoi Prokurorja e
21 më tha se "Këto janë fjalë të tyre e jo të tua".

22 Dhe këtu më nuk mund të lexoja kur pashë se dokumenti ish
23 nënshkruar nga ekipi i intervistuesve të mi e s'munda të
24 lexoja më dhe leximin e fletës tjetër në shqip e bëri
25 përkthyesja ime. Unë duke qarë e ndëgjoja dhe ndryshova

1 komplet mendimin tim për intervistuesit e mi, gjykatës, hetues
2 e prokurorë se janë armiqtë e mi, të UÇK-së, të pavarësisë së
3 Kosovës e të popullit tim.

4 Pastaj një kohë të gjatë kërkoja sqarime të Prokurores
5 duke kërkuar e sharë intervistuesit e mi si kanë guxuar të më
6 rrezikojnë mua familjen time, të më bëjnë tradhtar të luftës
7 time, të heronjve e dëshmorëve të kombit të UÇK-së e të
8 martirëve të vrarë e të gjithë luftëtarëve të UÇK-së. Pastaj
9 një kohë të gjatë më dhanë pushim. Ndoshta mbi tre, katër orë,
10 e mbas këtij pushimi më kujtohet se më kanë ftuar edhe një
11 herë e kemi vazhduar dhe pak dhe pas se kishte punë ende
12 shumë, por seanca u ndërpre.

13 Dhe më njoftuan se do të vazhdon nesër prapë me mua. Më
14 hyri frika se çfarë do ndodhë me mua e familjen time nëse këto
15 shënime janë të dhënë ose do të ipen para se të njoftohet i
16 tërë populli im se këto shënime janë të armiqve të mi,
17 popullit të UÇK-së e luftës së shenjtë të heronjve, dëshmorëve
18 të kombit, martirëve e popullit tim. Si kanë guxuar ta bëjnë
19 këtë?

20 Por të njëjtën më datën 19 shkurt 2025 kemi nisur punën
21 prapë me një shqyrtim timin, me një shqetësim timin të madh
22 përpara ratë dokument të cilin unë kërkoja të më jipet një
23 kopje ose të më ipet i plotë numri i regjistrit të dokumentit,
24 po nuk mu dha informacioni, duke më thënë se dokumentin do ta
25 ketë Prokuroria në sallë. Mua mu shtua frika dhe më tej, shumë

1 pse nuk mu dha dokumenti, as numër i shënuar i dokumentit.

2 Prej dokumentit më kujtohet vetëm të zezat që janë
3 përshkruar për mua si tradhtar i kombit tim dhe si armik në të
4 njëjtën kohë dhe si armik i Serbisë. Dhe kisha dhe kështu
5 përfundoi përgatitja ime me Prokurorin, me Prokuroren duke u
6 shkurtuar sipas meje pa u shqyrtuar dhe shumë faqe të tjera të
7 intervistave të mia të vitit 2019.

8 Pastaj njoftova oficerin tim të sigurimit mbi shqetësimin
9 tim dhe kërkova një kërkim, një takim me këta oficerë. Takimi
10 u bë me personelin e sigurimit tim rreth një dokumenti të
11 përshkruar nga marrja në pyetje të intervistuesve të mi të
12 2019, më datën 21 shkurt 2025, prej orës 10.25, nga Dhomat e
13 Specializuara të Hagës, nga hetuesit e mi, dokumentin të cilin
14 ata e kanë përpiluar në prezencën time dhe kurrë nuk më kanë
15 prezantuar mua. As që e kanë nënshkrimin tim. Dokument e kanë
16 parë tash dy ditë para këtij takimit, kam njoftuar personelin
17 e sigurisë edhe ky dokument kish qenë fat sikurse të më
18 dorëzohet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 DËSHMITARI: Do të kisha pranuar 100 vjet burg do të kisha
21 pranuar që ky dokument të bëhej zyrtar, në qoftë se është i
22 mundshëm.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
24 z. Tara. Tani mund të largoheni. Për ju përfundoi dëshmia.

25 [Dëshmitari largohet]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi për
2 dy javë atëherë.

3 Seanca ndërpritet këtu.

4 --- Seanca mbyllet në orën 13.19

5 .

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25